Lurimi Shpk

Bashkia Prrenjas – Ekonomia Pyjore Sopot

Plani I Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 2024 - 2033



Klient: Bashkia Prrenjas

Bashkia Prrenjas – Ekonomia Sopot

Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 2024- 2033

Klient:	Bashkia Prrenjas
Burimi i financimit:	Fondet e Bashkise Prrenjas
Tipi i dokumentit:	Plani i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Sopot
Konsulent:	Lurimi shpk
Data e pergatitjes se draftit	Gusht 2024

Ekipi i konsulencës		
Ekspert kyç	Emër Mbiemër	Pozicioni
K-1	Elvin Toromani	Statisticien pyjesh, Lurimi shpk
K-2	Endri Bala,	Ekspert GIS, Lurimi shpk
K-3	Jarosllav Alla	Zooteknik Specialist,vleresimkap.kullosore, Lurimi shpk
K-4	Bibe Dodaj	Specialist terreni, Lurimi shpk
K-5	Lutfi Miftari	Ekspert per vegjetacionin, punimet e terrenit, Konsulenti Lurimi shpk

Kodi ALFIS: EL60 00

Data e miratimit:

SHKURTESA

PMPK	Plan i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave
EP	Ekonomi Pyjore
PM	Plan Mbarështrimi
NjA	Njësi Administrative
SHPPK	Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Contents/Përmbajtja

I. Hyrje 8

I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave 8

I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë 8

I.1 Metodologjia e punës 8

I.2 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK 9

II. Përshkrim i përgjithshëm i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Sopot 10

II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore 10

II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi 10

II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative 11

II.4 Konteksti i Bashkisë dhe EkonomisëPyjore 12

II.5 Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore 13

II.6 Situata demografike dhe socio-ekonomike 14

II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore 15

II.8 Gjuetia dhe peshkimi 15

II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike 16

II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje 16

III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave 16

III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave 16

III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet) 16

III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet) 17

III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela 18

IV. Përshkrimi i stacionit 18

IV.1 Klima 18

IV.2 Topografia dhe morfologjia 21

IV.3 Gjeologjia 27

IV.4 Tokat 29

IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë 30

IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore 31

IV.7 Rrëshqitjet e tokës....32
V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti....32
V.1 Brezat bio-klimatikë....32
V.2 Pyjet dhe kullotat....33
V.3 Tipet pyjore....33
V.4 Tipet e kullotave....35
V.5 Tipet e vegjetacionit potencial....35
V.6 Prania e vlerave të larta mbrojtëse....36
V.7 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin....37
V.8 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore....37
VI. Rrugët dhe infrastruktura....37
VI.1 Rrugët pyjore....37
VI.2 Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës....38
VII. Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat....38
VII.1 Analizimi i të dhënave për pyjet....38
VII.1.1 Analizimi i tipeve pyjore....38
VII.1.2 Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes....42
VII.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit 45
VII.2 Analizimi i të dhënave për kullotat....48
VII.2.1 Gjendja e kullotave....48
VII.2.2 Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore....50
VII.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike....51
VII.2.4 Mbërritshmëria....52
VII.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota....52
VIII. Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave....52
VIII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje....52
VIII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve....52
Saktësia e lartë që rezulton nga rezultatet e llogaritura, lidhet me volumin e përqendruar vetëm në formën e qeverimit “Trungishte dhe Cungishte”, pasi shkurret nuk kanë volum, për shkak të parametrave të vegjël dendrometrikë....55
VIII.1.2 Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë....55

VIII.1.3 Struktura vertikale 57
VIII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë 58
VIII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF) 60
VIII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit 60
VIII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare 61
VIII.2.1 Drurët e tharë 61
VIII.2.2 Dëmtime të tjera 61
VIII.3 Prerjet e paligjshme 61
VIII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave 62
VIII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave 62
VIII.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit 62
VIII.4.3 Numri aktual i blegtorisë 62
VIII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve 63
VIII.4.5 Infrastruktura aktuale 63
VIII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë 63
IX. Objektivat e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave 64
IX.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë 64
IX.2 Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave 65
IX.3 Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal 65
IX.4 Objektivat kryesore të PMPK 66
IX.5 Objektivat specifikë për ekonominë pyjore 67
IX.5.1 Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës 67
IX.5.2 Objektivat specifikë për tipet pyjore 69
IX.5.3 Objektivat specifikë silvikulturorë 72
IX.5.4 Objektivat specifikë për kullotat 72
IX.5.5 Objektivat specifikë për biodiversitetin 73
IX.5.6 Objektivat specifikë për gjendjen shëndetësore 73
IX.5.7 Objektivat specifikë për faunën e egër 74
IX.5.8 Objektivat specifikë për pyjet me funksion prodhues 74
IX.5.9 Objektivat specifikë për pyjet me funksion mbrojtës 75
IX.5.10 Objektivat specifikë për pyjet me funksion rekreativ 75

IX.5.11 Objektivat specifikë për pyjet me status mbrojtës 75
X. Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK 75
X.1 Mundësia vjetore e shfrytëzimit 75
X.2 Prerjet silvikulturore vjetore 77
X.3 Planifikimi vjetor i masave 80
X.3.1 Masat në pyje 80
X.3.2 Masat në kullota 80
X.3.3 Masat në infrastrukturë dhe në sipërfaqet e degraduara, rekreative dhe didaktike 80
X.4 Masat afatgjata 81
X.4.1 Masat silvikulturore në pyjet trungishte 81
X.4.2 Pyllëzimet dhe ripyllëzimet 83
X.4.3 Masat e aplikuara në kullota 83
X.4.4 Gjendja dhe masat në infrastrukturë 83
X.4.5 Masat specifike për aktivitetet rekreative dhe didaktike 83
XI. Vlerësimi ekonomik 84
XI.1 Vlerësimi i ndikimeve të masave të planifikuara mbi pyjet dhe kullotat 84
XI.2 Planifikimi i të ardhurave / përfitimeve 84
XI.3 Planifikimi i shpenzimeve 85
XI.4 Analiza shpenzime – përfitim 86
Shtojca 4: Planifikimi vjetor i masave me ndërhyrje silvokulturale në EP Sopot në TOTAL 100

I. Hyrje

I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor i këtij Plani Mbarështrimi të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK) është të zhvillojë mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumë funksional të pyjeve dhe kullotave Bashkiake brenda kufijve të **Ekonomisë Pyjore (EP) Sopot** për periudhën 2024–2033, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike. Në këtë drejtim, ai synon të përcaktojë, përmes një qasjeje të integruar, pajtueshmërinë e ngushtë midis kufizimeve dhe mundësive për të vlerësuar burimet pyjore e kullosore dhe nevojat Bashkiake dhe palëve të interesuara lokale për të maksimizuar përfitimet e tyre. Ndërkohë, qëllimi i ndjekur është krijimi i kushteve të përshtatshme për të rritur kapacitetin e stafit lokal dhe bashkiak për të zbatuar masat përmes një mirëkuptimi të ndërsjellë dhe duke rritur bashkërendimin dhe ndërveprimin. Për të garantuar zbatim dhe interpretim efikas, plani aktual i mbarështrimit është shkruar në një mënyrë të qartë dhe konçize dhe konkluzionet kryesore theksohen me shkronja të zeza.

I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Pas firmosjes se kontrates puna filloi me grumbullimin e dokumentave të nevojshem për hartimin e planit të mbarështimit si: planin e vjeter te inventarizimit, hartat e ekonomise pyjore, studimet e mëparshme si: Plani i zhvillimit Vendor i Bashkise Përrenjas dhe dokumentat që lidhen me aspektin ligjor në fushen e pyjeve si:
- Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”;
- Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

Përgjegjësia për kryerjen e punimeve të terrenit dhe hartimin e planit të mbareshtimit ka qënë e kompanisë **Lurimi shpk**. Eksperti GIS pasi ndertoi harten pyjore të ngastrave dhe nëngastrave pyjore ndërtoi rrjetin e siperfaqeve prove i cili u pasqyrua në harte dhe në ortofoto dhe me pas pikat e ketij rrjeti u hodhën ne GPS ku me pas filloi puna e terrenit e cila zgjati për nje periudhe 5 mujore deri në muajit Nëntor-Prill. Pas përfundimit të matjeve në terren puna vazhdoi me përpunimin e te dhenave dhe me shkrimin e raportit të planit te mbareshtimit.

I.1 Metodologjia e punës

U zbatua një metodologji nëpërputhje të plotë me përshkrimet në ***Udhëzuesin e Planeve te mbareshtrimit te pyjeve dhe kullotave te vitit 2019***. **Në fakt është thelbësore që të lidhet analiza e burimeve pyjore dhe kullosore me vizionin lokal të shprehur përmes takimeve me palët e interesuara. Qëllimi është gjetja e ekuilibrit të duhur midis kapaciteteve të burimeve pyjore-kullosore dhe pritshmërive të përdoruesve, në përputhje me rregulloret për një mbarështim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional.**

Analiza e palëve të ndryshme të interesit per hartimin e planit te mbareshtimit jepet më poshtë:

Palët e interesit	Interesi	Aktivitetet
Banorët (me qëndrim të përhershëm, emigrantët dhe përdoruesit e pyjeve)	-Mbrojtja dhe zhvillimi i pyjeve -Sigurimi i të drejtave ligjore për përdorimin e pyjeve dhe kullotave	-Prodhimii druve të zjarrit, lëndës drusore për ndërtimin e shtëpive, mbledhja e frutave të pyllit & bimëve mjekësore dhe kullotja e bagëtive.
Vjelësit e produkteve pyjore jodrusore	-Rritja e të ardhurave familjare	- Vjelja e frutave të pyllit dhe bimëve mjekësore.
Bashkia	-Mbarështrim i qëndrueshëm dhe shumëfunksional i pyjeve në nivel lokal. -Zhvillimi, ruajtja dhe administrimi i fondit pyjor nëpronësi të Bashkisë.	-Hartimi, zbatimi dhe kontrolli i mbarëvajtjes së PM. -Përgatitja e projekteve për investimepër fondin pyjor të Bashkisë. -Ofrimi i mbështetjes teknike dhe këshillimore për pronarët, përdoruesit dhe shoqatat e pyjeve. -Bashkëpunimi me Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe organizata të tjera të shoqërisë civile. -Garantimi i përfshirjes së komuniteteve lokale në administrimin dhe mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave.
Bizneset e bazuara në prodhimet pyjore jodrusore	-Fuqizimi i zinxhirit të vlerës së prodhimeve pyjore jodrusore	-Kultivimi dhe grumbullimi i bimëve të ndryshme dhe bimëve mjekësore. -Eksportimi i bimëve.

Gjatë kryerje se punimeve te terrenit, ekipi i kompanisë Lurimi Shpk ka patur kontakte të vazhdueshme me stafin e pyjeve te bashkisë Përrenjas ku kanë shkëmbyer mendime dhe janë informuar për punën e kryer në vijimesi.

I.2 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK

Krahas informacionit të mbledhur gjatë inventarizimit në terren dhe procesit pjesmarrës, informacioni specifik që ishte i domosdoshëm të sigurohej në nivelin e Bashkisë Përrenjas në fillim të aktiviteteve ishte:

- Ndarjet parcelare dhe n/parcelare për EP Sopot sipas kadastrës dhe AlFIS;
- Plani i mëparshëm i Inventarizimit te EP Sopot, i vitit 2001.
- Të dhena demografike sipas fshatrave brenda territorit të ekonomisë pyjore
- Plani i Zhvillimit Vendor i Bashkise Përrenjas
- Aktivitete të lidhura me prodhimet drusore dhe jodrusore nga pyjet dhe kullotat;
- Rrugët dhe infrastruktura pyjore;
- Të dhëna historike mbi zjarret në pyje dhe rreziqet natyrore (rrëshqitjet e tokës, përmbytjet, stuhitë, tharjet e drurëve);
- Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë;
- Prania e aktiviteteve edukative dhe didaktike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e aktiviteteve turistike lidhur me pyjet dhe kullotat;

- Prania e siteve me vlera të larta mbrojtjeje. Kjo përfshin rezervatet farore, habitatet e veçanta (liqene, pyje të brigjeve të lumenjve), site të njohura për vlerat kulturore, peizazhe të mbrojtura.
- Prania e aktiviteteve kërkimore në pyje dhe kullota.

II. Përshkrim i përgjithshëm i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Sopot

II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore

- Bashkia Përrenjas;
- Ekonomia Pyjore Sopot;
- Sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore Sopot, bazuar në VKM nr. 684, 2.09.2020, është 1680.95 ha.
- Vlefshmëria e PMPK: 2024 – 2033 (10 vjet);
- Planet e mëparshme që u ka mbaruar afati:
  - ✓ Plani Inventarizimit viti 2001

II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi

Pronësia dhe situata e përdoruesve në të shkuarën

Gjatë periudhës 1900 – 1944, pyjet dhe kullotat ishin kryesisht pronë e pronarëve të mëdhenj dhe pjesa e mbetur, e banorëve të fshatrave. Pyjet dhe kullotat e fshatrave përdoreshin individualisht, duke respektuar kufijtë dhe traditat e vjetra, ndërkohë fshatarët mund të hynin në pyjet privatë për kullotje të bagëtive ose për lëndë drusore në këmbim të taksës ose punës që do duhet të kryenin. Për periudhën 1945-1990 pyjet dhe kullotat ekesaj ekonomie pyjore administroheshin nga shteti dhe përdorimi i tyre ishte i përbashkët dhe i kushtohej interesave të shtetit. Planet e mbarështrimit dhe te inventarizimit të pyjeve dhe kullotave hartoheshin nga stafet e Drejtorive të Shërbimit Pyjor Shtetëror dhe miratoheshin nga Këshilli Teknik i kesaj drejtorie. Keto plane hartoheshin pa u këshilluar paraprakisht me komunitetet lokale. Pas kësaj periudhe, politikat pyjore dhe kullosore filluan të nxisin përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje dhe zbatimin e PMPK-ve. **Kjo rezultoi në një proces decentralizimi, ku Qeveria e transferoi pronësinë mbi pyjet dhe kullotat dhe përgjegjësitë lidhur me to tek Njësitë e Qeverisjes Vendore.**

Në lidhje me kuadrin ligjor, Ligji nr. 57/2020 "Per Pyjet", Kreu IV, neni 16

- Bashkia zhvillon strukturën e saj menaxhuese, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorial administrativë (neni 16, pika 3)
- Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve lokalë ndërmerret nga Bashkia
- Përgatitja e planit të mbarështrimit për pyjet dhe kullotat i ngarkohet stafit të Bashkisë

Por, **Bashkia Përrenjas duhet të ketë fuqi dhe të sigurojë mjete të nevojshme mbi kontrollin e territorit te ekonomise Sopot. Përdorimi i pyjeve dhe kullotave (shfrytëzimi i druve të zjarrit, kullotja,** prodhimi i gjethit dhe bimëve mjekësore/frutave pyjore) duhet të planifikohet në lidhje me mbarështrimin, si edhe kontrollin e tyre brenda EP Sopot.

II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative

Ekonomia pyjore Sopot, shtrihet në Perëndim të Bashkisë Përrenjas, në një distancë prej 39 km nga qendra e qytetit. Në konturin territorial gjeografik të ekonomisë bën pjesë Njësia Administrative Stravaj, Në territorin e ekonomisë brenda konturit të saj nuk ka fshatra por në afërsi ndodhen fshatrat, Shiponjë, Gaferr, Sopot të cilët janë pjesë e Njësisë Administrative Stravaj.

Në figurën 1 më poshtë jepen konturet e Njësive Administartive dhe të bashkisë në lidhje me ekonominë pyjore Sopot.



Figura 1. Ekonomia pyjore në lidhje me Njësitë Administrative të Bashkisë Përrenjas

II.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Bashkia Përrenjas kufizohet në veri me Bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqëndra e Bashkisë është qyteti i Përrenjasit. Kjo Bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Përrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 25 fshatra.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2023, Përrenjasi ka një popullsi prej 18.768 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km2. Sipas censusit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km2.

Bashkia Përrenjas, Njësitë administrative, qytetet dhe fshatrat

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative sipas RAT	Qytetet dhe fshatrat nën juridiksion të bashkisë	Popullsia sipas Census 2023	Popullsiasipas RegjistritCivil	SipërfaqjaKM²
Elbasan	**Qyteti Prrenjas**	**Prrenjas**	Qyteti Prrenjas, Fshatrat; Prrenjas-Fshat, Rrashtan	18.768	33,031	322.95
		Qukës	Fshatrat; Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzeshtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash,Pishkash Veri			
		Rrajcë	Fshatrat; Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh,Urakë			
		Stravaj	Fshatrat; Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë, Sopot			

Të dhëna të tjera: Bashkia e re e Prrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re. Zonat e Rrajcës, Qukësit dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Bashkia e re e Prrenjasit ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë.

Bashkia e Prrenjasit ka potenciale të pashfrytëzuara për turizëm natyror. Me historinë e pasur të zonës së Rrajcës, ku ndodhet shkëmbi i Skënderbeut dhe legjenda për Sofrën e tij si dhe me bukuritë natyrore të Sopotit, zona mund të kthehej në një destinacion për vizitorë vendas dhe të huaj.

Për të krijuar një ide më të qartë në lidhje me pozicionin e ekonomisë në lidhje me bashkinë dhe Njësitë Administrative, shiko Figura nr. 1 më lart dhe Figura nr. 2, më poshtë.





Figura nr 2. Harta e Bashkisë Përrenjas

II.5 Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore

Ekonomia Pyjore Sopot për herë të fundit është inventarizuar në vitin 2001, dhe më pas në vitin 2008, me kalimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të ish komunave, kjo ekonomi ka njohur një plan pjesor mbarështimi, mikrobaseni Fshati Gaferr për pyjet me bazë komuniteti përdorues, pjesë territorit administratve për ish Komunën Stravaj.
Ashtu si më sipër theksuam, plani i mbarështimit të kësaj komune ka riazhurnuar rreth 50% të totalit të sipërfaqes së kësaj ekonomie. Informacione të tjera rreth mbarështimit të sipërfaqes së kësaj ekonomie, nuk ka.

Sa i takon përdorimit të tokës, në përputhje me inventarin e vitit 2001 dhe VKM Nr. 684, datë 2.09.2020, të dhënat jepen në tabelëm nr. 1 më poshtë.

Forma e përdorimit të tokës	Sipërfaqja(ha)
Tokë pyjore	1546.51
Tokë kullosore	72.21
Inproduktive	62.23
Gjithsej	**1680.95**



Përdorimi i tokës në EP Sopot sipas VKM Nr. 684, datë 2.09.2020, ilustrohet me hartën më poshtë

II.6 Situata demografike dhe socio-ekonomike

Tëdhënat që vijnë nga censusi, të konfirmuara në terren gjatë procesit pjesëmarrës dhe anketimit në terren, tregojnë që numri i banorëve të të gjithë fshatrave që gjenden në afërsi të kufijve të EP Sopot është i ulët shfifra 2910 banorë e Njësisë Administrative Stravaj është një tregues jo i mirë.

Karakteristika kryesore që duhet theksuar është tendenca e qartë për rënien e shpejtë demografike, e cila ka nisur që në vitin 1991 për secilën grup moshë, gjini dhe klasë shoqërore nëpërmjet migrimit nga fshatrat në zonat urbane kryesisht në Përrenjas apo edhe emigracionit jashtë vendit ku renditen shtete të tillla si Italia dhe Greqia kryesisht, por vitet e fundit ka emigrantë edhe në shtete të tjera të evropës, USA, etj. Në disa zona të thella,

kjo rënie shkon deri në pesë herë më pak banorë. **Prandaj, ky fenomen ka një ndikim madhor duke zvogëluar në mënyrë të ndjeshme presionin nga fshatrat mbi burimet pyjore dhe kullosore, ndonëse janë vërejtur shenja të presionit të lartë në disa zona në afërsi të fshatrave.**

Situata social ekonomie e zonës ka një ndikim shumë të madh nga remitancat të cilat vijnë nga emigracioni, por jo vetëm, pasi zhvillimi ekonomik multidimensional (agroturizëm, blegtori, vreshtari) etj ka një shfaqje interesi në rritje.

Në përfundim theksojmë se gjendja social ekonomike e zonës nuk është e mirë, duke luajtur një rol thelbësor në rënien e presionit mbi burimet natyrore të EP Sopot, dhe zhvillimin e tyre natyror. Kjo sic do të shikohet edhe me poshtë vërehet në shtimin e sipërfaqes pyjore dhe rënien e ndjeshme të sipërfaqes jo-produktive në konturin e këaj ekonomie, duke shfaqur fenomenin e suksesionit ekologjik natyror pozitive.

II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore

Ashtu si më sipër theksuam, mënyrat e tjera të jetesës që favorizojnë popullsinë që jeton në afërsi të ekonomisë pyjore Sopot, ka bërë të mundur që shfrytëzimi i resurseve natyrore të jetë larg vëmendjes për momentin.

Ndërsa prania e prodhimeve jo-pyjore në zonë, megjithëse konsiderohet e larmishme, nuk paraqet interes dhe as përbën ndonjë alternativë (me përjashtime të pakta) për banorët e zonës që të garantojnë të ardhura nga ky aktivitet. Prodhimet jodrusore gjithashtu përdoren më së shumti për nevojat lokale, me nivel të ulët tregtimi. Ne zone ka mjaft specie pyjore dhe bime mjeksore qe mund te grumbullohen dhe tregtohen pasi ka kerkesa ne terg per to, por per shkak te mungeses se fuqise punetore ato nuk vilen dhe nuk perdoren si burim te ardhurash nga banoret.

Nga sa më sipër theksojmë se, tregëtimi i produkteve pyjore dhe jo-pyjore me origjinë nga EP Sopot, si në zonë apo edhe jashtë saj, është në limitet minimale të saj dhe nuk përbën dhe as ka ndonjë impakt në ekonominë e zonës.

II.8 Gjuetia dhe peshkimi

Për shkak të moratoriumit aktual të gjuetisë së faunës së egër, gjuetia është një aktivitet i munguar dhe nuk gjeneron të ardhura. Kafshët karakteristike të kompleksit të faunës janë ujku, dhelpra, derri i egër, lepuri, bufi i malit, qukapiku, bilbili, Thëllëza e malit, Dhia e egër Rrëqebulli etj.
Zona e EP Sopot nuk ofron ndonjë mundësi për peshkim, kjo për shkak të karakteristikave gjeologjiko-hidrike.

II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike

Zonat për-rreth dhe në brendësi të EP Sopot ka një potencial të mirë për të zhvilluar aktivitete rekreative dhe turistike, veçanërisht lidhur me bukuritë natyrore tësaj të cilat duhet te reklamohen dhe vizitohen nga turistet, veçanarisht turizmi malor. Cilësia e peizazheve të ndryshme ofron mundësinë për të zhvilluar infrasktrukturën dhe objektet turistike, bazuar në ato ekzistuese të pakta (shtigje, zona pikniku, ski, sipline etj) dhe me qëllim zhvillimin e turizmit malor.

Zhvillimi i këtij sektori me peshë të jashtëzakonshme në ekonominë e zonës për-rreth ekonomisë, duhet të shkojë paralelisht me zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të saj, të cilat gërshetohen më së miri në funksion të zhvillimit të turizmit rural.

Si konkluzion vlen të theksojmë se bazat për zhvilimin e turizmit në zonë tashmë janë hedhur. Mbetet vetëm zhvillimi i qëndrueshëm mbështetur në traditën e zonës dhe gërshetimi me bukuritë natyrore të saj dhe larmishmërinë kulturore dhe të besimit.

II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje

Në territorin e ekonomisë pyjore Sopot nuk ka site dhe specie me vlera të larta të mbrojtjes. Për këtë qëllim të gjitha njësitë dhe nën-njësitë e ekonomisë (parcelat dhe nënparcelat) kanë patur të shumtat funksione prodhuese. Por sigurisht, që mbrojtja e habitateve të veçanta në këtë ekonomi pyjore do të jetë në qendër të vëmendjes gjatë hartimit të detyrave dhe objektivave të zhvillimit të saj në vijim.

III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave

III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave

III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Sipas VKM nr. 684, dt. 2.09.2020, përdorimi i territorit në EP Sopot jepet në tabelën më poshtë.

Përdorimi i tokës (ha)	Përdorimi i tokës (bazuar në VKM)	Sipas Planit të Mbarështimit 2024	Pyje Private (fisi Dashi dhe Vreto)
Pyll	1546.51	1439.9	
Kullotë	72.2	78.9	
Sipërfaqe me bimësi pyjore	0	15.1	
Djerr	0	0	
Sipërfaqe inproduktive	62.2	37.2	
Gjithsej	**1680.9**	**1571.1**	**131.09**

Ashtu sikurse vërehet, ka një shtesë prej 22 ha në total të sipërfaqes së ekonomisë pyjore, krahasuar me sipërfaqen e dhënë në VKM. Kjo shtesë vjen për arsyet e mëposhtme:

1. **Po ashtu, përdorimi i programeve kompjuterike në hartografim nëpërmjet programit GIS, gjeoreferencimit të konturit të parcelave, nënparcelave dhe atij të jashtëm të ekonomisë pyjore Sopot, ka rritur saktësinë e matjes, duke rritur kësisoj sipërfaqen e përgjithshme të ekonomisë.**
2. **Sipërfaqja prej 131.09 ha referuar Çertifikatave të pronësisë i përket fiseve Dashi dhe Vreto duke përfshirë kategoritë e përdorimit Pyll dhe Kullotë, dhe shuma totale krahësuar me vkm 1702.19 ha, nga të cilat 1571.1 ha janë pjesë e Bashkisë Përrenjas.**

Në pikat në vijim të këtij relacioni, do të shpjegojmë edhe arsyet e ndryshimeve që vërehen nga njëra kategori e përdorimit të tokës në tjetrën, mbështetur në fakte dhe rezultate të matjeve në terren.

Në tabelën më sipër, kanë dhënë rezultatet vetëm për fondin pyjor dhe kullosor bashkiak, pa përmendur zonat të cilat në fakt kanë pronësi private dhe nuk do të trajtohen nga ky plan mbarështimi.

Për analogji theksojmë se në total janë 131.09 ha me formë përdorimi pyje private të cilat bëjnë pjesë në konturin e kësaj ekonomie pyjore.

Për të ilustruar formën e përdorimit të tokës dhe formës së qeverimit, sipas inventarit të vitit 2001, ose atë të pasqyruar në VKM nr.684 e sipërcituar, më poshtë gjendet figura nr. 3, nëpërmjet të së cilës, paraqiten format e përdorimit të tokës.

III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Ne tabelen e meposhtme jepet sipërfaqja pyjore sipas regjimit te qeverisjes referuar planit te inventarizimit te vitit 2001 dhe atij aktual. Nga krahasimi konstatohet se ka mjaft ndryshime dhe keto kane ardhur per shkak se nje pjese e pyjeve kane kaluar nga një formë qeverimi në një formë tjetër. Nga analiza vihet re se, kemi shtim të sipërfaqes në formën e përdorimit “Pyje”

Regjimi i qeverisjes së pyjeve në EP Sopot	Plani i mëparshëm Inventarizimit_2001		PMPK aktual	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Trungishte	1880.6	93.3	1439.9	92.7
Cungishte	20.8	1.03	34.1	2.2
Shkurre	0	0	0	0
Kullota ,livadhe	113.7	5.67	78.9	5.1
Gjithsej	**2015.1**	**100**	**1552.9**	**100.0**

Nga analiza vihet re se, kemi pakësim të sipërfaqes në formën e përdorimit “Pyje” me rreth 440.7 ha më pak dhe në kullotë 34.8 ha, si dhe një shtesë në formën e qeverisjes Cungishte me 13.3 ha. Por kemi referuar Vkm nr.102 datë 15.01.1996 e shpallur si “rezerve Natyrore e Menaxhuar: kategoria e IV zonë e mbrojtur, e cila ka marr sipërfaqe nga territori brenda konturit të ekonomisë pyjore Sopot, si dhe certifikatat e pronësisë të fisit vreto dhe dashi, kjo është dhe arsyeja e pakësimit në sipërfaqe në raport me administrimin.

Ndërkohë që nga analiza rezulton sipas VKM nr.684/2020 kemi shtim në formën e përdorimit Pyll ngastra 25a e cila nga 15.38 ha sipas vkm është 28.22 ha pra një shtesë si rezultat i rilevimit dhe kostatimit në terren pasi ngastra 25b e cila ishte joproduktive, kishte sipërfaqe pyll dhe i kaloj ngastrës 25a.
Përsa më sipër është pasqyryar në tabelë, të dhënat në kolonën "**PMPK aktual**", gjithmonë duke theksuar heqja e sipërfqes së zonës së mbrojtur, pronës private, dhe Vkm korespondojnë me atë çfarë është gjetur aktualisht në terren dhe nuk ka të bëjë me objektivat ose propozimet e këtij plani mbarështimi për 10 vitet në vijim.
Nëpërmjet masave dhe objektivave të këtij plani mbarështimi, synohet që të kemi rritje të formave të qëverimit "trungishte, cungishte dhe kullotë", si dhe pakësim në kategorinë joproduktive.
Më shumë rreth këtyre ambicieve do të flasim në pikat në vijim, ku do të sqarohet çdo lloj objektivi që synon përmirësime në grumbujt pyjor të kësaj ekonomie.

III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela

Mbështetur në konfiguracionin e terrenit të ekonomisë pyjore Sopot, janë krijuar njësitë homogjene të cilat në respekt të konfiguracionit të terrenit formojnë ngastrat dhe nën/ngastrat. Ngastra ka në nocionin e saj konfiguracionin e terrenit i cili ka konture lehtësisht të dallueshme dhe të pa-shlyeshme me njësinë e kohës, të tilla si përrenj, kurrize, trupa ujore, rrugë auto, etj. Ndërsa n/ngastra përfaqëson njësinë më të vogël homogjene (forma e qeverimit, lloji, mosha, lartësia mesatare, diametri mesatar, etj).
Ngastrat pyjore nuk kanë asnjë ndryshim në konturet e tyre të jashtme, ndërsa nën-ngastrat kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme thuajse në masën mbi 80%, dhe kjo në sajë të ndryshimeve të theksuara që janë gjetur gjatë punës në terren.
Në total ekonomia ka 54 ngastra, numërtimi i tyre është ruajtur i njëjtë me atë të planit të mbarështrimit të mëparshëm. Ndërsa njësitë homogjene të krijuara brenda ngastrave të cilat janë nën-ngastrat janë 83. Në krahasim me planin e mëparshëm vihet re një ulje e ndjeshme e numrit të nën-ngastrave dhe kjo për shkak të ndryshimeve unike të vërejtura gjatë hartimit të këtij plani mbarështimi. Lista e të gjitha parcelave dhe n/parcelave me sipërfaqet përkatëse dhe përdorimin e tokës jepet në shtojcën 1.

IV. Përshkrimi i stacionit

IV.1 Klima

EP Sopot bën pjesë në zonën klimatike ne zonen klimaterike "mesdhetare malore", nenzona malore Juge-Lindje e cila karakterizohet nga dimra te ftohte por jo shume te ashper, ben pjese ne zonen fitoklimatike fagetum:

Ne pjesen malore mbizotëron një klime mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore arrin deri në 12.3 °C. Muaji më i ftohtë është janari dhe muaji më i nxehtë është gushti. Muaji më i lagësht është nëntori me reshje shiu mesatarisht 108 milimetra ndërsa sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin në 730-1000 milimetra.

-Temperaturat

Temperatura mesatare e ajrit lekundet nga kufijte 7-12 grade C, dhe ajo e muajve me te ftohte 2-4.5 grade C. Minimumet absolute zakonisht arrijne ne – 10 deri ne 13 gradec C.


Periudha me 7 grade C fillon mesatarisht nga mesi i muajit prill dhe mbaron nga fundi i tetorit ndersa ajo me temperature mesatare10 grade C fillon nga data 10-13 maj dhe mbaron nga dy javet e para te muajit tetor.

Ditet me akull variojne nga 60 -80 dite ne vit, megjidhese ditet me akull duke pasur parasysh ndryshimet klimatike global jane ne ulje.


Temperatura mesatare e muajit me te nxehte lekundet ndermjet 22-25 gradec C.

Ne tabelat e meposhteme jepen te dhenat per temperaturat me karakteristike per sejcilin muaj dhe stine, per stacionin e Pogradecit, keto te dhena jane te peraferta me ato te objektit ne fjale tabelen e meposhteme:


Temperaturat mesatare e maximumeve mujore



Maksimalet absolute te temperatures se ajrit



Maximumet absolute te temperature se ajrit



-Reshjet

Sasia vjetore e reshjeve lekundet rreth 700-800 mm ne vit, sasira keto te cilat jane me te paktat qe bihen ne vendin tone.


Kjo zone karakterizohet për sasira të pakta reshjesh, jo vetem në periudhen e vjeshtes (90 mm) por dhe ne periudhen e pranveres (prill-maj) ku bihen mesatarisht 100-150 mm. Pra sasite e reshjeve qe bihen gjatë periudhes se vegjetacionit jane te pakta.

Reshjet qe bihen ne kete zone ne pergjidhesi nuk kane karakter torrencial sic karakterizohen ne zonat e tjera te vendit tone.

Pamvarsisht nga reshjet mesatare vjetore ne pergjidhesi mjaft te ulta, edhe ne kete zone vihet re periudha te thata dhe te lageta. Periudha te thata ndodhin dhe ne muajt e dimrit me lageshti.

Sasite e reshjeve vjetore dhe siguria ne perqindje e reshjeve gjate gjysmes se ngrohte si dhe maksimalet e minimalet dhe raporti ndermjet tyre jepen ne tabela e meposhteme.

<u>Mesataret mujore dhe vjetore te reshjeve ne mmm</u>



Shtresa e pare e debores fillon zakonisht ne dekaden e pare te muajit dhjetor dhe vazhdon ne mesin e pare te muajit mars. Numuri i diteve sillet nga 50-60 dite, lartesia e shtreses se debores varion nga 30-40 cm.

Lageshtia relative mesatare per rreth eshte e larte ne dimer per shkak te aktivitetit ciklonear qe mbizoteron ne vendin tone si dhe per shkak te liqenit te Pogradecit qe sjell ajer te laget.

Por dhe gjate periudhes se veres lageshtia relative e ajrit sidomos ajo e ores 14 ne krahasim me zonat e tjera te vendit tone eshte me e madhe.

<u>-Ererat</u>

Persa i perket drejtimeve ne rethin predominojne ererat qe vijne nga veriu e nga jugu te cilat kane shpejtesi mesatare vjetore 3-3.8m/sek. Me pak te vrulleshme jane ererat qe fryjne nga VL e L (0.9-1.7 m/sek), të dhënat për klimën në zonë janë marrë nga Climate Explorer (http://climexp.knmi.nl/data/icru4_pre_20.33E_40.05N_n.dat).

IV.2 Topografia dhe morfologjia

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e ngastrave te EP Sopot varion nga 1000 - 1800 m. Lartësia mesatare e përgjithshme e ekonomisë konsiderohet 1400 m mbi nivelin e detit.

Nëpërmjet programit të përpunimit të të dhënave Access database, rezultojnë këto lartësi sipas funksioneve të dhëna:

Tab. Nr.6

Siperfaqja sipas lartesise mbi nivelin e detit dhe funksioneve kryesore

(perqindjet ne lidhje me totalin e siperfaqes sipas funksionit kryesor)

Ekonomia Pyjore : Sopot

Funksioni	0-200m			201-400m			401-600			601-800m			801-1000m			1001-1200m			1201-1400m			1401-1600m			1601-1800m			1801-2000m			>2000m			Total
	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha l %
Prodhues	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	39.9		3.0	309.98		23.6	665.08		50.6	298.23		22.7	0		0.0	0		0.0	1313.19
Mbrojtes	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	65.71		51.9	60.96		48.1	0		0.0	0		0.0	0		0.0	126.67
TOTAL:	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	39.9		2.8	375.69		26.1	726.04		50.4	298.23		20.7	0		0.0	0		0.0	1439.86

Ashtu sikurse mund të shihet edhe nga tabela, në katergorinë e lartësisë në lidhje me sipërfaqen dhe funksionin jepen si vijon:

- Nga 1001-1200 m, përfshihen 39.9 ha ose 2.8% e totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot.
- Nga 1200-1400 m, përfshihen 375.6 ha ose 26.1 % e totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot.
- Nga 1400-1600 m, përfshihen 726.04 ha ose 50.4% e totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot
- Ndërsa në kategorinë 1600-1800, përfshihen vetëm 298.2 ha ose 20.7 % e totalit të sipërfaqes pyjore në këtë ekonomi.

Morfologjia e terrenit, karakterizohet nga shpate të thyera, të gërryera nga rrjeti hidrik i cili aktivizohet gjatë periudhës me reshje. Drejtimi i shpatit mbi të cilën është vensur ekonomia ka një shtrirje thuajse uniforme në gjatësinë Veri – Jug dhe me kundrejtim kryesor atë dhe Jug Perëndimor, dhe perëndim.

Hartografisht, shpërndarja e lartësive në të gjithë ekonominë paraqitet në figurën nr. 4 më poshtë




Figura 4. Harta e lartësive mbi nivelin e detit të EP Sopot


Nëse i referohemi kundrejtimit kryesor të shpateve të EP Sopot, të dhëna të detajuara vijnë nga tabela në vijim:

Siperfaqja sipas funksioneve kryesore dhe kundrejtimeve

Kundrejtimi	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te funksionit	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : Sopot			
Prodhues			
Veri-Lindje	106.42	8.1	7.4
Lindje	252.84	19.3	17.6
Jug-Lindje	183.49	14.0	12.7
Jug	121.54	9.3	8.4
Jug-Peren	195.17	14.9	13.6
Perendim	171.63	13.1	11.9
Veri-Peren	242.81	18.5	16.9
Veri	39.29	3.0	2.7
Totali i funksionit :	1313.19	100.0	91.2
Mbrojtes			
Lindje	28.22	22.3	2.0
Perendim	22.22	17.5	1.5
Veri-Peren	76.23	60.2	5.3
Totali i funksionit :	126.67	100.0	8.8
TOTALI I EKONOMISE:	**1439.86**		**100.0**

Ashtu si më sipër theksuam, kundrejtimi kryesor i shpateve të ekonomisë është ai Jug-Perëndimor i ndjekur nga ai Perëndimor dhe veri-perëndimor të cilët dominojnë përkatësisht me afro 42.5 % të totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot.

Më pas vjen kundfrejtimi Lindje me 252 Ha, ose me 19.3 % të totalit të sipërfaqes pyjore të ekonomisë. Më poshtë po ju paraqesim hartën e kundrejtimeve.


Harta e Kundërdrejtimit
EP Sopot, Bashkia Prrenjas
N
20°20'E
20°22'E
20°24'E
41°4'N
41°2'N
41°N
Legjendë
Ngastrat
Nenngastrat
Kufiri i Ekonomisë
Kundërdrejtimi
Verilindje
Lindje
Juglindje
Jug
Jugperendim
Perendim
Veriperendim
Veri
Scale: 1:15 000
0
0,42
0,85
1,7 Kilometers

Pjerësia e shpateve varion nga 0 deri 70%, por zotëron kategoria e pjerrësisë nga 11-40%, duke i konsideruar pyjet e EP Sopot si të vendosua në shpate relativisht të pjerrëta. Të dhëna më të detajuara mbi pjerrësinë dhe shpërndarja e saj në ekonomi jepet më poshtë:

Siperfaqja sipas pjerresise dhe funksioneve kryesore

Funksioni	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te pjerresise	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : Sopot			
0 - 10%			
Prodhues	26.4	100.0	1.8
Total :	26.4		1.8
11 - 40%			
Prodhues	950.34	100.0	66.0
Total :	950.34		66.0
41 - 70%			
Prodhues	336.45	72.6	23.4
Mbrojtes	126.67	27.4	8.8
Total :	463.12		32.2
TOTALI I EKONOMISE :	**1439.86**		

Ashtu si më sipër theksuam, pyjet e kësaj ekonomie janë vendosur në shpatet në kategorinë e pjerrësisë nga 11-40%, të cilët dominojnë në krahasim me kategoritë e tjera, përkatësisht me 66% të totalit të ekonomisë, ose e thënë ndryshe, 950.34 ha me pyje të kësaj ekonomie janë të vendosura në shpate më 41-70% pjerrësi ose 463.1 ha ose 32.2 % të sipërfaqes totale të ekonomisë pyjore, dhe 26.4 ha ose 1.8 % në pjerrësinë 0.-10%.

Hartografiksht, konceptimi i pjerrësisë në ekonomi jepët në figurën nr. 5, më poshtë.




Figura nr. 5 Harta e pjerrësive të EP Sopot

IV.3 Gjeologjia

Formacionet gjeologjike te EP Sopot i përkasin formacioneve Gëlqeror në 42.2% të territorit dhe Flyshe 41.7 % ose 1208.78 ha ndaj sipërfaqes së përgjithshme të ekonomisë dhe pjesa tjetër prej 16 % karakterizohet nga shkëmbinjë ultrabazike ose 231.08 ha ndaj sipërfaqes së përgjithshme të ekonomisë Sopot. Për të parë një shpërndarje më të detajuar të tipeve të litologjisë në EP Sopot, harta më poshtë si dhe treguesit nga rezultat e acces database.

Siperfaqja sipas gjeologjise dhe funksioneve kryesore

Funksioni	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te gjeologjise	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia Sopot			
Flyshe			
Prodhues	578.41	96.3	40.2
Mbrojtes	22.22	3.7	1.5
Total :	600.63		41.7
Gelqeror			
Prodhues	579.93	95.4	40.3
Mbrojtes	28.22	4.6	2.0
Total :	608.15		42.2
Ultrabazik			
Prodhues	154.85	67.0	10.8
Mbrojtes	76.23	33.0	5.3
Total :	231.08		16.0
TOTALI I EKONOMISE :	**1439.86**		




Figura Nr. 6. Harta litologjike e EP Sopot

IV.4 Tokat

Shtresa tokësore (dheu) është shumë e ndryshme në drejtim të cilësive morfologjike, kimike, fizike dhe vetitë mineralogjike, si edhe përmbajtjes së gurëve. Kombinimi i relievit, klimës, bimësisë dhe përbërjes së shkëmbit amnor krijon toka të veçanta me cilësi të veçanta, ku mikroorganizmat e gjalla luajnë një rol kryesor në proceset pedogjenetike, veçanërisht në qarkullimin e lëndës organike dhe energjisë. Në kontekstin e EP Sopot, **relievi është një faktor kyç për të kuptuar diversitetin**, pasi ndikon direkt tek klima dhe proceset fiziko-kimike dhe biologjike të tokë formimit, në zhvendosjen e elementëve ushqyes dhe produkteve dhe në lëvizjen e ujrave dhe regjimet ujore. Në këto kushte, **relievi është themelor për të vlerësuar kapacitetin e rritjes dhe ekuilibrin ujor të tokës**. Për shembull, në shpatet e pjerrëta infiltrohet më pak ujë se sa në tokat e sheshta. Në rastin e parë uji kalon në sipërfaqe duke shkaktuar erozion dhe varfërimin e elementëve ushqyes të tokës. Kjo është veçanërisht e dukshme kur toka është e zhveshur nga bimësia, e shqetësuar nga faktorë të ndryshëm siç janë mbishfrytëzimi në grumbujt pyjorë, si edhe shkelja nga kafshët në toka të pastrukturuara. **Prandaj**, **aktivitetet njerëzore në ekonominë pyjore kanë një ndikim aktiv në cilësinë dhe funksionalitetin e tokës.**

Duke iu referuar hartës pedologjike të Shqipërisë, dhe klasifikimit të FAO-ËB të tipeve të tokave, tokat dominues në EP Sopot jane: tokat e murrme pyjore dhe livadhore malore.

Tokat e murrme pyjore zënë pjesën kryesore të ekonomisë pyjore. Ato zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes dhe jane te vendosur kryesisht mbi shkembinj magmatikë dhe metamorfike (ultrabazikë, gëlqeror, flyshe), tokat e murrme shtrihen në 1439.86 Ha pyje te ekonomisë Sopot ose në 96 % të sipërfaqes totale të tyre. Ndërsa tokat livadhore malore kafe shtrihen në 78.9 Ha kullota të EP Sopot ose në 5 % të totalit të territorit me mbulesë pyjore. Tabela më poshtë jep të dhëna nga programi Access DB.

Siperfaqja sipas tipit te tokes dhe funksioneve kryesore

Funksioni	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te tipit te tokes	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : Sopot			
murr.pyjore			
Prodhues	1313.19	91.2	91.2
Mbrojtes	126.67	8.8	8.8
Total :	1439.86		100.0
TOTALI I EKONOMISE :	**1439.86**		

IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

EP Sopot, ka një rrjet të dendur hidroligjik me burime dhe përrnjë, por aktiv vetëm në pjesën e vitit me reshje. Megjithatë burimet në brendësi të territorit të ekonomisë jo vetëm nuk mungojnë por janë të larmishme, rrjeti hidrik nuk shkakton probleme me erozionin. Shpatet e përrenjve janë tashmë të veshura me bimësi, presioni i kullotjes ka rënë dhe erozioni në të gjithë ekonominë pyjore Sopot konsiderohet jo i pranishëm. Burimet qe ndodhen te shperndara ne ekonomi perdoren per shuarjen e zjarreve ne pyje. Gjate 10 vjecarit te fundit nuk ka patur permbytje nga reshjet, për të krijuar një ide mbi rrjetin hidrologjik që rrethon zonën, po paraqesim hatren e mëposhtme.




Figura nr. 6 Rrjeti hidrik i zones së studimit

IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore

Sikurse përshkruhet në pjesët e mësipërme, erozioni nuk perben problem per ekonominë pyjore, por mbrojtja e tokës duhet te përfaqësoje një interes thelbësor. Dihet se erozioni pakëson sasinë e humusit organik dhe kufizon vetitë fizike dhe mekanike te tokes, duke çuar në një rënie të përgjithshme të pjellorisë sësajdhe duke ndikuar ne rritjen vjetore te pyjeve dhe kullotave. Faktikisht, reshjet e befta të shiut, shpesh në sasi të mëdha dhe me intensitet të lartë, shtrirja e formacioneve të buta sedimentare lehtësisht të gërryeshme dhe mbikullotja dhe degradimi i pyjeve gjenerojnë erozion aktiv dhe të thellë. Nuk ka te dhena ne lidhje me sasine e elementëve ushqyes qe largohen nga erozioni në këtë ekonomi pyjore.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rolit vendimtar tëpjerrësisë në këtë fenomen. Shpatet me pjerrësi më pak se 5% janë më pak të rrezikuara nga erozioni, megjithatë për shpatet me pjerrësi 1-10% rreziku është i vogël për shfaqjen e dukurisë së erozionit por bëhet më i lartë kur pjerrësia është mbi 25%, EP Sopot nuk mund të konsiderohet me rrezik të lartë erozioni.

Megjithatë për sa më sipër theksuam rreziku erozionit në EP Sopot është momentalisht zero. Kjo për faktin nga përbërja gjeologjike si dhe mbulesa me vegjetacion pyjor luajnë një rol vendimtar në uljen e shpejtësisë së rrjedhës dhe si rrjedhojë dobësimin e forcave gërryese nga uji.

.

Erozioni

Funksioni	0% ha	0% I	0% %	1-10% ha	1-10% I	1-10% %	11-25% ha	11-25% I	11-25% %	26-50% ha	26-50% I	26-50% %	51-75% ha	51-75% I	51-75% %	76-100% ha	76-100% I	76-100% %	Total ha
Siperfaqesor																			
Prodhues	0	0.0		1032.49	89.1		0	0.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		1032.49
Mbrojtes	0	0.0		126.67	10.9		0	0.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		126.67
TOTAL:	0	0.0		1159.16	100.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		1159.16
Ne thellesi																			
Prodhues	0	0.0		113.11	53.5		0	0.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		113.11
Mbrojtes	0	0.0		98.45	46.5		0	0.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		98.45
TOTAL:	0	0.0		211.56	100.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		0	0.0		211.56

	Total
Total	
Prodhues	1313.19
Mbrojtes	126.67
TOTAL:	1439.86

IV.7 Rrëshqitjet e tokës

Formacionet pyjore si dhe konfiguracioni i terrenit shoqëruar edhe me litologjinë dhe shkëmbin amnor, bëjnë që në ekonominë pyjore Sopot, rrëshqitjet e tokës të mos eksistojnë ose të jenë në shkallën më të vogël të mundshme.

V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti

V.1 Brezat bio-klimatikë

Ekonomi pyjore Sopot bën pjesë ne zonen fitoklimatike te ahut (fagetum) nenzona e ftohte dhe ne brezin bioklimatik, brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare.

Ky brez shtrihet mbi brezin e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare deri në lartësinë 850-2000m, Zona në studim mbizotërohet nga vegjetacioni i ahut, një grupim bimor i cili përfaqëson pyje gjethegjëra të përhapura përgjithësisht në brezin para malor dhe malor. Ky shoqërim bimor gjendet më shpesh në toka të murrme pyjore. Speciet më karakteristike të këtij shoqërimi janë shparthi ahu, bredhi, panja e malit të cilët janë edifikatorë të fitocenozës dhe lloje dominante njëkohësisht, të cilët dallohen për shkallën e lartë të sasi-mbulesës e dominancës, kështu që edhe flora e tyre është më pak e pasur. Përbërja floristike ndryshon sipas tipit të pyllit, përbërjes së tokës, lartësisë, kundërdrejtimit, shkallës së ndriçimit etj. Por një numër i konsiderueshem speciesh janë të përbashkëta. Sipërfaqja në studim mbulohet në 1439.9 ha të saj nga llojet ahu, bredhi i bardhë, Pisha e zezë, shoqëruar ne pjesen e poshteme ne nen/zonen e ngrohte te ahut, me dëllinjën se kuqe Juniperus oxycedrus dhe me përfaqësim më të rrallë ato të shkozës Carpinus orientalis Mill, frashërit Fraxinus ornus L, panjës Acer campestre, dhe drizës Paliurus aculeatus etj. Shoqërimi shfaqet përgjithësisht i dëmtuar me pjesë të caktuara në stadin e filizërise. Llojet e tjera që takohen në hapësirat e hapura të zonës së studimit janë manaferra Rubus ulmifolius Schott, fiku i egër Ficus carica, trëndafili i egër Rosa canina L, driza Paliurus spina-christi Mil, murrizi Crataegus monogyna. Për nga përbërja floristike e katit të florës barishtore përfaqësohet nga llojet: Potentilla erecta, Lychnis coronaria L, Buglossoides purpurocaerulea (L.) I.M.Jhons., Clinopodium vulgare L, Brachypodium pinnatum (L.)P.B., Lathyrus niger (L.)Berhn L. Stachys germanica L, Dactylis glomerata L, të cilat janë specie karakteristike të aleancës se ahut me Quercion frainettocerris por të përhapura janë edhe llojet e Achillea millefolium L., Bellis perennis L, Ajuga reptans, Geranium robertianum.

Ekorajoni i pyjeve gjethe rënëse i lire është përcaktuar nga ËËF dhe Harta Dixhitale e Rajoneve Ekologjike Evropiane nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

V.2 Pyjet dhe kullotat

Si më sipër theksuam, EP Sopot aktualisht përfaqësohet vetëm nga fondi pyjor dhe në të gjithë sipërfaqen e saj por ka sipërfaqe kullosore prej 78.9 ha kullota alpine Ballkanike, kullotë në brëndësi të pyllit. Periudha e kullotjes eshte vetem gjate veres. Per shkak te numurit te krereve te blegtorisë dhe perdorimit kolektiv te saj ka nje rendim te kullotes. Shfytezimi behet duke u dhene liri kopeve te dheneve te gjejne ushqim sipas deshires se tyre ne te gjithe siperfaqen dhe per gjithe sezionin kullosor.

Gjithsesi, në tabelën më poshtë do paraqesim format e përdorimit të tokës që ndeshen në EP Sopot.

Sip. totale (ha)	Pyje (ha)	Pyje (%)	Kullota (ha)	Kullota (%)	Sip.Bimësi Pyjore (ha)	Sip.Bimësi Pyjore (%)	Tjetër (ha)	Tjetër (%)
1571.1	1439.9	91.6	78.9	5.02	15.1	1	37.2	2.36

Tek kategoria "Tjetër" në tabelën më sipër, përfshihen kategoritë e përdorimit "Sipërfaqet joproduktive".

V.3 Tipet pyjore

Tipet e pyjeve në EP Sopot, të diferencuara sipas funksioneve përkatëse të tyre, jepen në tabelën më poshtë:

Tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes

Tipi i Grumbullit	Total		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore : Sopot										
Pyje bredhi te bardhe me ah	31.73	2.2	31.73	2.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me ah	1054.8	73.3	1004.4	69.8	50.44	3.5	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me bredh te bardhe	187.41	13.0	174.52	12.1	12.89	0.9	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me pishe te zeze	43.42	3.0	43.42	3.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me ah	88.44	6.1	25.1	1.7	63.34	4.4	0	0.0	0	0.0
Pyje me shpardh	34.05	2.4	34.05	2.4	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE:	**1439.86**	100.0	1313.2	91.2	126.67	8.8	0	0.0	0	0.0

"Pyje me ah" - Ashtu sikurse shikohet edhe nga tabela, tipi i pyllit "Pyje me ah" diferencohet nga tipet e tjera, duke u renditur i pari për nga sipërfaqja që zë, duke lënë të kuptohet se EP Sopot është e influencuar dhe bën pjesë në zonën ahut. Si tip bën pjesë në"Zonën fitoklimatike të ahut

Fagetum". Ai zë 1054.8 ha nga fondi i përgjithshëm i kësaj ekonomie ose 73.3 % të totalit të sipërfaqes pyjore të saj. Eshte dru me vlera mjaft te mira, shkon deri ne 30-40 m lartesi dhe diameter 1-1.5 m. Eshte bime monoike. Ne moshe te re ka nje rritje te ngadalte deri ne 10 cm ne vit nga mosha 30-40 vjecare ka nje rritje deri ne 80cm lartesi. Frutifikon ne moshet 70-80 vjecare me periodicitet te bollshem 4-6 vjecar. Druri ka ngjyre te bardhe te kuqerremte, me rreze palcore te dallueshme, i forte, i rende, i cashem, mesatarisht elastic. Ne vendin tone eshte lloji me i perhapur dhe me i rendesishem ne fondin pyjor te shqiperise. Ze nje vend te rendesishem ne industrine e perpunimit te drurit per vlerat e tija te padiskutushme.
Ne ekonomi ne pergjithësiesi takohet ne pjesen veri-perendimore me bimesi grathatelin kurse ne pjesen e poshteme me Fragaria vescen, Vacinum Mytifillus, Laburnum Alpinum.

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë. Ne grumbujt pyjore te kesaj ekonomie **nuk ka shenja të ndikimeve masive të patogjenëve, të cilët zvogëlojnë rritjen apo çojnë deri në zhdukjen në nivel të grumbujve pyjorë.**

Gjithashtu theksohet që **nuk ka raste të vëzhgimeve të tharjes së drurëve për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përsëritjes së thatësirave, megjithëse grumbujt pyjorë do të ekspozohen veçanërisht në të ardhmen**, duke marrë në konsideratë kushtet specifike të EP Sopot, të karakterizuara nga njëndryshueshmëri e altitudës, kundrejtimit dhe klimës. Prandaj mund të thuhet që dëmet kryesore janë shkaktuar nga burime të tjera: mbikullotja dhe veprimet me natyrë humane.

VIII.2.1 Drurët e tharë

Nuk janë konstatuar drurë të tharë dhe as probleme me tharje drurësh në EP Sopot.

VIII.2.2 Dëmtime të tjera

Gjatë inventarizimit në terren të vetmet dëmtime që janë vërejtur janë ato të rëniës së gurëve nga shpatet e ekonomisë të nxitur kryesisht nga punimet në infrastrukturën rrugore që kalojnë nëpër ekonomi. Të tjera dëmtime nuk ka.

VIII.3 Prerjet e paligjshme

Prerjet e paligjshme jane prezente ne disa ngastra. **Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje per te plotesuar nevojat e saj per dru zjarri ose per gardhe, hunj etj presin nje pjese te materialit drusor ne keto ngastrat pyjore. Në këtë mënyrë ata synojnë të presin drurët me dimensionet më të mëdha.

Në këto rrethana, ndërhyrjet e bashkërenduara më mirë ndërmjet stafit te shërbimit pyjor bashkiak dhe banorëve janë një faktor kyç për të zvogëluar shkatërrimin e shkaktuar nga këto prerje informale. Si përparësi, fshatarët duhet të instruktohen të rrallojnë pyllin në formën e një ndërhyrje silvikulturore të përshtatshme, duke hequr drurët e thatë, të nënshtruarit dhe të shtrembërit. Presioni mbi burimet pyjore duhet, gjithashtu, të përqëndrohet në përdorimin e materialit drusor që rezulton nga prerjet silvikulturore.

Prandaj është thelbësore që zbatimi i këtij plani mbarështrimi të pasohet nga një bashkërendim më i mirë ndërmjet aktorëve në bashki dhe nga një strategji specifike e zhvilluar për kontrollin e aktiviteteve të prerjeve në pyjeve.

VIII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave

VIII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Kullotat zënë një sipërfaqe prej 78.9 ha në EP Sopot. Ato shtrihen në vazhdimësi të sipërfaqeve pyjore dhe kanë të njëjtat kushte gjeomorfologjike si pyjet. Të gjitha kullotat janë verore, për shkak të lartësisë së madhe mbi nivelin e detit. Terreni i këtyre sipërfaqeve ka një pjerrësi nga e ulet, mesatare deri të madhe.

Në drejtim të prodhimtarisë, kullotat janërelativisht të pasura, për shkak të pranisë së ulët të gurëve dhe një përbërje të mirë të specieve graminore dhe leguminoze.

Mungesa e rregullimit dhe racionalizimit në lidhje me blegtorinë çon në dëmtime serioze: mbikullotje; kullotje të pakontrolluar në tokat pyjore ku konsumohet gjethi dhe pengohet ripërtëritja. Uji për bagëtitë është një problem domethënës për territorin e EP Sopot, pasi ka një rrjet hidrografik relativisht jo të dendur përroskash dhe përrenjsh. Megjithatë, infrastruktura dhe pajisjet për furnizimin me ujë janë të rralla dhe në gjendje relativisht të degraduar mirëmbajtjeje.

VIII.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit

Pavarësisht ndryshimeve midis kullotave verore dhe dimërore, k**ullotat përdoren kryesisht gjatë periudhës së verës dhe vjeshtës, duke qenë se altituda e tyre zakonisht është mbi 1000 m**.

Pothuajse të gjithë përdoruesit janë banorë të fshatrave në afërsi të tokave kullosore në referencë të të drejtave të tyre të njohura zyrtarisht. Përdorimi i kullotave bëhet kryesisht në mënyrë të përbashkët, nga grup familjesh që ndodhen në afërsi të sipërfaqeve kullosore.

VIII.4.3 Numri aktual i blegtorisë

Zonat rurale për-rreth ekonomisë pyjore Sopot, mbarështojnë të imta kryesisht të dhirta, kjo në përputhje edhe me tipologjinë e terrenit që karakterizon këtë zonë. Në të shkuarën, para 8-10 vitesh numri i të imtave arrinte deri në 5600 krerë në të gjithë konturin e ekonomisë, por aktualisht janë vetëm 460 krerë të imta, të cilat edhe këto janë të vendosura jshtë konturit të ekonomisë.
Krahasuar me 10 vite me parë mund të themi që presioni i kullotjes në këtë ekonomi ka rënë ndjeshëm dhe kjo përbën një arsye të fortë për të planifikuar masa të cilat synojnë rivitalizimin e kësaj ekonomie.

VIII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve

Parimi i përdorur për ndarjen e kullotave midis përdoruesve është "çdo fshat brenda kufijve të tij", duke qenë se përdorimi dhe ndarja e tokave kullosore në EP Sopot bëhet nga fshatrat në afërsi të kësaj ekonomie, pjesë e Njësisë administrative stravaj. Së fundmi, periudha e saktë e vitit dhe mënyra e përdorimit të kullotave përcaktohen përmes vendimeve të marra nga komisionet e secilit fshat.

Duke qenë se cilësia e sipërfaqeve kullosore është mesatarisht e mirë, nga studimet e mëparshme supozohet që **kapaciteti mbajtës mesatar për 1 ha llogaritet të jetë 0.5 gjedhë, 3 dhi dhe 5 dele që mund të kullotin pa i shkaktuar dëme serioze pyllit apo ekosistemit.**

VIII.4.5 Infrastruktura aktuale

Infrastruktura kullosore është e pakët. Prania e koritave prej druri apo çezmave të ndërtuara afër burimeve që shërbejnë si rezerva ditore për pirjen normale, përveç përrenjve sezonalë, nuk duhen neglizhuar. Infrastruktura tjetër si zyrat, rrjeti rrugor, gardhimet, sinjalistika, shenjat treguese të ndryshme për informim gjatë sezonit të kullotjes mungojnë pothuajse plotësisht. Ekzistojnë disa leraku bagëtitë mund të pinë ujë, si edhe përrenjtë sezonalë, të parashikohen lerat jashtë funksionit duke bërë merimetimin e tyre, për të përmirsuar kullotën.

VIII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë

Si rezultat i seksioneve të mëparshme, edhe pse rezerva ushqimore është më e madhe se sa kapaciteti kullosor, që do të thotë një mbikullotje e përgjithshme domethënëse në pyjet dhe kullotat e EP Sopot. Ky është një shpjegim i qënësishëm i rritjes së presionit blegtoral mbi burimet pyjore dhe mbi ripërtëritjen e tyre, pasi çobenjtë kërkojnë për furnizimme bazë ushqimore shtesë për bagëtitë që e sigurojnë nga gjethi nëpërmjet krasitjes së degëve në mënyrë të pa kontrolluar. Në zonat më të ndjeshme, masa parësore që duhet marrë është ndalimi i kullotjes nëpërmjet një kontrolli më të mirë të bagëtive ose edhe duke i rrethuar me gardhe, në mënyrë që vegjetacioni i degraduar dhe mbulesa pyjore të mund të ripërtërihet brenda 5 viteve.

Në territorin e ekonomisë pyjore ka shenja të mbikullotjes, madje edhe të degradimit të tokës në kullota, gjithashtu dhe në sipërfaqet e pyllëzuara, të cilat së bashku me prerjet dhe tokat e varfëra janë baza e degradimit të pyjeve. Zhveshja e tokës (heqja e mbulesës barishtore dhe pyjore) ka çuar në erodimin e sipërfaqes së saj. Për këto zona rekomandohet ndërtimi i pritave malore me mur guri të thatë në përroska ose në pjesët fundore të sipërfaqeve të eroduara, pasi do te këtë efekt pozitiv në ndalimin e erozionit, ruajtjen e substancave organike dhe përmirësimin e pjellorisë së tokës.

IX. Objektivat e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave

IX.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë

Konkluzionet kryesore të analizuara në seksionin e mëparshëm II.4 duhet të risillen edhe njëherë:

- Mbarështrimi i mëparshëm i pyjeve dhe kullotave, mbi të gjitha që prej vitit 2001, ka rezultuar **në një pakësim serioz të burimeve pyjore. Struktura edhe madhesia e kesaj ekonomie ka ndryshuar shume** prandaj nevojitet nje rivleresim i gjendjes se burimeve pyjore dhe kullosore ekzistuese.
- **Kullotja e pakontrolluar dhe e pabashkërenduar** ka pasur një ndikim negativ në rritjen e pyjeve dhe në disa pjesë, të ripërtëritjes sëtyre.
- **Mungesa e investimeve ne trajtimin silvikulturor** te burimeve pyjore dhe kullosore ka bere qe rritja e tyre te jete e vogel dhe ato te jene te kercenuara nga zjarret.

Si rrjedhim i drejtpërdrejtë, objektivi i përgjithshëm për planifikimin afatgjatë për EP Sopot **përqëndrohet në tre përparësi madhore, të cilat janë parakushte vendimtare për të arritur një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional:**

1. **Rritja e fondit pyjor, në drejtim të sasisë (volumi mesatar për hektar) dhe cilësisë (lënda drusore e prodhuar në pyjet trungishte). Ky PMPK duhet të shënojë një pikë kthese dhe një ndarje të qartë nga tendencat e mbishfrytëzimit të së kaluarës.** Qëllimi i ndjekur është gjithashtu përmirësimi i prodhimtarisë së pyjeve, si edhe i vlerës së përgjithshme të burimeve pyjore (produkteve drusore, sekuestrimit të karbonit, shtimit të biodiversitetit, mbrojtjes së tokës dhe pjellorisë së saj, përmirësimi i shëndetit dhe vitalitetit të ekosistemit).
2. **Konsiderimi i funksionit mbrojtës ndaj tokës si faktor kryesor që duhet të zbatohet para çdo lloj ndërhyrje në pyje.**
3. **Zbatimi i praktikave të kullotjes rracionale në përputhje me nevojën e grumbujve pyjorë për t'u ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme.**

Si një kusht përfundimtar për sukses, arritja e këtyre objektivave kërkon domosdoshmërisht një kontroll dhe një bashkërendim më të mirëmidis stafit të pyjeve të bashkisë dhe palëve të interesuara lokale. Prandaj do të jetë e një rëndësie shumë të madhe t'i kushtohet vëmendja kryesore që, **procesi i zbatimit do të përfshijë të gjitha palët e interesuara, nga komunitetet lokale tek drejtuesit e pyjeve të bashkisë dhe përfaqësuesit e bashkisë, duke ndërvepruar ngushtësisht dhe respektuar rolet e ndërsjella. Kjo qartësisht përfshin një kontroll të rreptë mbi prerjet e paligjshme.**

IX.2 Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave

Sikurse është shtjelluar në seksionet I.2 dhe II.2, ky PMPK u punua duke iu përmbajtur ngushtësisht rregullores dhe kuadrit politik kombëtar për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, ndër të cilët: Reforma administrative dhe Ligji Nr. 115/2014; Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet"; Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

IX.3 Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal

Ky PMPK u hartua në përputhshmëri të plotë me planet rajonale dhe bashkiake dhe qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional. Ky plan mbarështrimi u zhvillua sipas parimit të

transferimit të kompetencave dhe rritjessë ndërgjegjësimit midis aktorëve, pas një sërë takimesh me banore, barinj, perfaqësues te stafit te pyjeve te Bashkise Përrenjas.
Si rrjedhim te dhenat e grumbulluara u integruanper te siguruar nje mbareshtrim te qendrueshem ne perputhje me kerkesat e popullsise lokale dhe pritshmerite e tyre. **Qëllimi i përgjithshëm ishte përcaktimi i masave dhe ndërhyrjeve, duke ekuilibruar burimet pyjore dhe kullosore me pritshmëritë e komunitetit lokal.** Raporti i procesit të pjesëmarrjes ofron më shumë hollësi rreth metodologjisë dhe rezultateve.
Në këtë kuadër, mundësitë dhe sfidat e identifikuara gjatë takimeve me palët e interesuara lokale përmblidhen si më poshtë:

Mundësitë	Sfidat
Agro-turizmi *(orientimi i bizneseve lokale, prodhimi i një harte eko-pyjore, përdorimi i tokave djerrë)*	**Prerje jo të rregullta dhe mbishfrytëzim** *(mbrojtja e pyjeve pa kufizuar nevojat e banorëve; pyjet e mbetur të pazhvilluar – shkurre – pas mbishfrytëzimit të tyre; mbrojtja veçanërisht e pyjeve brigjeve të liqeneve dhe lumenjve)*
Bimët mjekësore *(Kultivimi dhe mbledhja e BM si një mundësi për rritjen e të ardhurave të familjeve rurale)*	**Menaxhimi i kullotave***(kërkohet një planifikim më i mirë dhe ndërtimi i lerave)*
Ripërtëritja e pyjeve trungishte dhe llojet halor *(Përmes pastrimeve, rrallimeve, etj.)*	**Zjarret***(rekomandohet marrja e masave parandaluese ndaj zjarreve dhe ngritja e grupeve të shuarjes së zjarrit)*
E drejta e përdorimit bazuar tek tradita*(ligji i ri për pyjet pritet të rregullojë me një VKM të drejtën e përdorimit të pyjeve për banorët me qëndrim të përhershëm në fshat)*	**Njohja dhe sigurimi i të drejtës së përdorimit***(në varësi të fshatrave, pyjet zakonisht përdoren në bazë lagje ose familje)*
Mbrojtja e pyjeve nga komunitetet/ Promovimi i praktikave të mira*(të mbrojtjes së pyjeve nga vet komunitetet lokale)*	**Vëmendja ndaj pyjeve dhe kullotave***(pyjet dhe kullotat nuk janë përparësi për pushtetin vendor)*
	Lëvizjet demografike *(migrimi dhe emigrimi i moshave të reja)* **Gjenerimi i të ardhurave nga pyjet**(*pyjet përdoren vetëm për mbijetesë)* **Mbështetja financiare***(investimet në pyje mungojnë prej vitesh)*

Pritshmëritë më specifike të popullsisë lokale jepen ne tabelen e meposhtme. Këto kanë një rëndësi parësore dhe duhet të merren me konsideratë në mënyrë të kujdesshme gjatë periudhës së zbatimit të këtij PMPK, me një qëllim të qartë për përmirësimin e bashkërendimit dhe ndërveprimeve midis të gjitha palëve të interesuara.

IX.4 Objektivat kryesore të PMPK

Qëllimi kryesor i këtij PMPK është të sigurojë një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Sopot, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike, duke promovuar bashkërendimin e ngushtë ndërmjet stafit të pyjeve, popullsisë lokale dhe përfaqësuesve lokalë. Kjo përfundimisht do të lejojë **optimizimin e**

përfitimeve socio-ekonomike të burimeve për palët e interesuara lokale sot dhe në të ardhmen.

Në përputhje të plotë me objektivat e përgjithshme të përmendura në pjesën IX.1, qëllimet kryesore janë:

- Arritja e qëndrueshmërisë dhe shumëfunksionalitetit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e lëndës drusore të prodhuar, të mirëmbahet mbrojtja ndaj erozionit dhe rreziqeve natyrore, të ruhet biodiversiteti, të sigurohen të ardhura dhe burime sipas nevojave lokale, tëmbahet ekosistemi vital dhe në gjendje tëmirë shëndetësore.
- Përmirësimi i rritjes natyrore të grumbujve pyjorë përmes ndërhyrjeve silvikulturore, duke synuar njëkohësisht balancim më të mirë midis klasave të moshës dhe rritje të volumit te materialit drusor dhe sekuestrimit të karbonit.
- Lejimi i ripërtëritjes së pyjeve me praktika të përshtatura me ato të kullotjes.
- Rimëkëmbja e mbulesës së degraduar të vegjetacionit nëpërmjet pyllëzimeve.
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i funksionalitetit të rrjetit rrugor.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i kapaciteteve të banorëve për ndërhyrje të përshtatshme në pyje në përputhje me nevojat e tyre.
- Zbatimi i masave aktuale nëpërmjet veprimeve interaktive dhe të bashkërenduara që lidhen me palët e interesuara lokale dhe zhvillojnëndjenjën e përgjegjshmërisë dhe kontrollit ndaj mbikullotjes dhe prerjeve të paligjshme.

IX.5 Objektivat specifikë për ekonominë pyjore

Objektivi kryesor i hartimit tëkëtij plani mbarështimi, ishte njohja me gjendjen aktuale të grumbujve pyjore dhe te siperfaqeve te tjera ne ekonomine pyjore Sopot, dhe propozimi i masave për të rregulluar apo përmirësuar situatë n e vërejtur.
Njohja e situatës reale të grumbujve pyjorë dhe planifikimi i masave për të siguruar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre konsiderohet si një tjetër detyrë.
Në kuadër të përgatitjes së planit të mbarështrimit, përparësitë e planifikimit u harmonizuan dhe u ndërthurën me ato të prodhimit të lëndës drusore dhe krijimit të rezervave të larmishme të biodiversitetit dhe rimëkëmbjes së sipërfaqeve të degraduara në mënyrë sa më natyrale.
Ky plan do të sigurojë një ekuilibër midis vlerave natyrore – si biodiversiteti – dhe aspekteve ekonomike në mënyrë që të plotësojë nevojat e komuniteteve dhe të përmirësojë jetesën e tyre.
Procesi pjesëmarrës dhe të drejtat gjinore kanë qenë shtyllat kryesore gjatë hartimit të këtij PMPK.

IX.5.1 Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës

Lidhur me përdorimin e tokës ne parashikojmë që në periudhën 10 vjeçare të zbatimit të këtij PMPK, sipërfaqet me bimësi pyjore, tëruhen dhe te permirsohet gjendja e tyre ne menyre qe te kryejne funksionin mbrojtes te tokes. Ne zone nuk ka siperfaqe te djegura apo te demtuara rende prandaj propozojme vetem kryerjen e trajtimeve silvikulturore per permirësimin e gjendjes se grumbujve pyjore ne territorin e kesaj ekonomie pyjore.

Më poshtë paraqiten të dhënat në rang ekonomie për objektivat e planifikuar gjatë periudhës 10 vjeçare në të cilën ky plan do jetë në fuqi.

Funksionet kryesore dhe specifike te propozuar

Funksioni	ha	%
Ekonomia pyjore : Sopot		
Mbrojt+Prodhues	35.11	2.4
Pr.drusore-Dru zjarri	12.89	36.7
Pr.drusore-Lende punimi	12.89	36.7
Mbrojtje-Toka	22.22	63.3
Prodhues	1391.56	93.6
Pr.drusore-Dru zjarri	287.25	20.6
Pr.drusore-Lende punimi	592.13	42.6
Pr.drusore-Lende ndertimi	215.15	15.5
Pr.te dyta-Bar	2.07	0.1
Mbrojtes	94.06	6.3
Mbrojtje-Toka	71.71	76.2
Totali i ekonomise:	**1487.37**	

Sikurse shikohet nga tabla e rezultateve për ketë qëllim, **fuknksioni prodhues** është ai që do të dominojë grumbujt e kësaj ekonomie pyjore dhe në krahasim me funksionet e tjera dhe në korelacion me sipërfaqen ky funksion do të jetë i aplikueshëm në 1391.56 ha ose në 93.6% të sipërafqes se përgjithshme me pyje. Ky funksion do të bartë ne vetvete nënfuksionet e veçanta të cilat do të synojnë :

a. Prodhime drusore – dru zjarri, të aplikueshme në 287.25 ha ose në 20.6 % të sipërfaqes me funksionin kryesor atë prodhues
b. Prodhime drusore-Lëndë punimi, i aplikueshëm për 592.13 ha ose në 42.6% të sipërfaqes së përgjithshme të shpallur me funksion prodhues.
c. Prodhime drusore – Lëndë ndërtimi është një funksion tjetër specifik i propuzuar për t'u aplikuar në 215.15 ha ose ne 15.5% të totalit të sipërfaqes të shpallur me funksion prodhues.

Pas funksionit prodhues, në vend të dytë për nga sipërfaqaj që ai është propozuar për t'u aplikuar është funksioni **Mbrojtje + Prodhues,** i cili do të aplikohet në 35.11 Ha ose në 2.4% të

sipërfaqes së përgjithshme pyjore në këtë ekonomi. Ky tip funksioni gërsheton prodhmin dhe mbrojtjen në të njëjtën kohë, duke shfrytëzuar racionalisht, por njëkohësisht edhe duke mbrojtur sipërfaqen racionalisht. Funksione të veçanta në këtë tip listohen:

a. Prodhime drusore - dru zjarri, i cili do të jetë funksion i veçantë për funksionin Mbrojtës + Prodhues dhe do të aplikohet në 12.89 ha, ose në 36.7% të sipërfaqes të shpallur me këtë funksion.
b. Prodhme drusore - lëndë punimi, i cili do të jetë i aplikueshëm në 12.89 ha ose 36.7% të sipërfaqes së shpallur me funksionin Mbr+Prodh.
c. Mrojtje e tokës – është propozuar që të kryejë këtë funksion në 22.2 ha ose në 63.3% të siperfaqes së shpallur me funksionin Mbr+Prodh.

Me funksion strikt **Mbrojtës**, janë propozuar për t'u shpallur 94.06 Ha, ose 6.2 % e sipërfaqes së përgjithshme pyjore : një eshte funksioni i veçante kryesor për këtë funksion:

a. Mbrojtja e tokës, e cila është propozuar të aplikohet në 71.7 ha ose në 76.2% të siperfaqes me funksionin mbrojtës.

Si konkluzion, ashtu sikurse më sipër cituam, bie në sy që në funksionin prodhues ka më shumë funksione të vecanta të propozuara për prodhime drusore dhe dru zjarri sesa ne kategorinë Lendë punimi apo lëndë ndërtimi, cka dëshmon për cilësinë e grumbujve në këtë ekonomi pyjore.

IX.5.2 Objektivat specifikë për tipet pyjore

Objektivi specifik lidhur me tipet pyjore është ruajtja e përbërjes ekzistuese të specieve dhe përmes ndërhyrjeve të përmirësohet gjendja e grumbujve pyjorë. Le të vështrojmë më poshtë fillimisht tipet e pyjeve që kemi propozuar për t'iu nënshtruar objektivave dhe masave për 10 vitet në vazhdim.

Për analogji, po paraqesim më poshtë tipet e pyjeve aktuale (ato që këmi gjetur gjatë inventarizmit të terrenit), me synimin për të parë ndryshimet që kemi propozuar me anë të masave dhe objektivëve specifikë për 10 vitet në vijim.

SI ËSHTË

Tipet e grumbullit te propozuar sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqe

Tipi i Grumbullit	Total		Funksioni									
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim		Mbr+Prodh	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore : Sopot												
Pyje bredhi te bardhe me ah	31.73	2.2	31.73	2.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me ah	1054.8	73.3	1047.8	72.8	28.22	2.0	0	0.0	0	0.0	22.22	1.5
Pyje ahu me bredh te bardhe	187.41	13.0	174.52	12.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0	12.89	0.9
Pyje ahu me pishe te zeze	43.42	3.0	43.42	3.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me ah	88.44	6.1	25.1	1.7	65.84	4.6	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me shpardh	34.05	2.4	35.65	2.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I Ekonomise :	**1439.86**	100.0	1358.2	94.3	94.06	6.5	0	0.0	0	0.0	35.11	2.4

Ashtu sikurse mund të shikohet nga tabelat krahasuese më sipër, më poshtë po japim disa nga transfromimet e tipeve të grumbullit aktuale në grumbuj të së ardhmes në sajë të objektivave të ndërhyrjes të planifikuara për t'u aplikuar gjatë 10 viteve në vijim.

SI ËSHTË PROPOZUAR

ISHTE			**BËHET**			
Tipet e pyjeve ekzistues	**Sip(ha)**	**Forma qeverimit**	**Sip (ha)**	**Masa e propozuar**	**Tipi I propozuar**	**Forma qev.prop**
Pyje Bredh të Bardh me ah	31.73	Trung.	31.73	Nuk ka	AAAF	Trung.
Pyje me Ah	1054.8	Trung.	1054.8	Pr. San, rrallim	AFS	Trung.
Pyje ahu me bredh të bardh	187.41	Trung.	187.41	Pr. San,rrall	AFA	Trung.
Pyje ahu me Pishë të zeze	43.42	Trung.	43.42	Rrallim	AFSP	Trung.
Pyje pishe të zeze me ah	88.44	Trung.	88.44	Rrallim	APNF	Trung.
Pyje me shparth	34.05	Cungishte	34.05	Pr.sanitare	GQF	cungishte
Totali	**1439.86**		**1439.86**			

Shpjegues: Në tabelën më poshtë jepen kodet e tipit të grumbullit me synimin për të kursyer vend në kolonën e tabelës.

AFS	Pyje me Ah
AAAF	Pyje Bredh të Bardh me ah
AFA	Pyje ahu me bredh të bardh
AFSP	Pyje ahu me Pishë të zeze
APNF	Pyje pishe të zeze me ah
GQF	Pyje me shparth

Ashtu sikurse mund të shihet, në sajë të masave dhe objektivave të propozuara për 10 vitet në vijim tipet e grumbujve aktualë do të transformohen në rritjen e cilësisë së grumbullit pyjor dhe

lëndës drusore, përmes aplikimeve me trajtime silvikulturore, duke synuar dhe përshpejtuar stadet më të larta të tyre, me synimin për të përfituar nga potenciali i stacionit.


Forma e qeverisjes aktuale nuk ndryshon rrënjësisht në sajë të objektivave të këtij plani në 10 vitet në vijim. Kështu p.sh, trungishtet nga 105.8 ha mbeten po 1405.8 ha


Ilustrimet e ndryshimeve të ndodhura në sajë të objektivave të mbarështrimit të planifikuara për 10 vitet në vijim jaepen në tabelën më poshtë:

FORMA E QEVERISJES

Forma e qeverisjes	Aktuale		E propozuar	
	Siperfaqja ha	%	Siperfaqja ha	%
Ekonomia : Sopot				
Trungishte	1405.8	97.6	1405.8	97.6
Cungishte	34.1	2.4	34.1	2.4
Trung. e parregullt	0.0	0.0	0.0	0.0
Cung. e perbere	0.0	0.0	0.0	0.0
Shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Livadh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me drure	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Total:	**1439.9**		**1439.9**	

Ne Total:





Respektimi dhe ndjekja e rekomandimeve dhe objektivave të përcaktuara në këtë plan, do të çojë në integrimin e grumbujve pyjorë në një stad më të lartë klimaks, dhe do të mundësojë që vegjetacioni aktual të mund të drejtohet drejt atij potencial, me synimin për të arritur një prodhimtari më të lartë.

IX.5.3 Objektivat specifikë silvikulturorë

Në lidhje me objektivat silvikulturore për EP Sopot, synimi ynë është të ruajmë sipërfaqen pyjore dhe aplikimi i ndërhyrjeve silvikulturore, si pastrimet, rrallimet, prerjet e njepasnjeshme/ perfundimtare etj.

Në të njëjtën kohë në grumbujt trungishte janë planifikuar pastrime, rrallime dhe prerje sanitare, prerje përgatitore me synimin për të intensifikuar rritjen e grumbullit dhe për të mbrojtur pyjet nga zjarri.

Po ashtu në cungishte janë planifikuar prerje sanitare me synimin e vetëm për të intensifikuar rritjen e grumbullit dhe për të shkuar drejt grumbullit të së ardhmes me një prodhimtari sa me të lartë. Të dhëna më të detajuara për ndërhyrjet silvokulturale do të jepen në tabelat në vijim.

IX.5.4 Objektivat specifikë për kullotat

Sipërfaqja e kullotave në EP Sopot është 78.9 ha. Ne propozojmë disa masa për përmirësimin e gjendjes së kullotave dhe prodhimtarinë e tyre. Prandaj, në mënyrë që të rritet prodhimtaria e tyre propozojmë disa masa, të tilla si: pastrimi i gurëve ndërtim lere Heqje barërash etj. Disa nga ndërhyrjet e propozuara për përmirësimin e gjendjes së kullotave dhe parcelat përkatëse paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Ekonomia Pyjore	Sip_ha	Ngastra	Ndërhyrjet	Urgjenca	Viti
EP Sopot	6.12	016b	Heqje barërash të këqija, helmuese	III-të	2032
EP Sopot	22.53	023b	Grumbullim gurësh	II-të	2029
EP Sopot	9.74	026b	Grumbullim gurësh	III-të	2032
EP Sopot	0.68	031b	Riparim Lere Uji	I-rë	2026
EP Sopot	1.80	049b	Heqje barërash të këqija, helmuese	II-të	2031

Zbatimi i praktikave të kullotjes në përputhje me nevojën e grumbujve pyjorë për t’u ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme çon në strategjinë e mëposhtme:

Tipi i përdorimit	Objektivat e mbarështrimit	Llojet e aktiviteteve	Masat parandaluese dhe mbrojtëse
Kullotë	- Mbrojtja mjedisore - Ruajtja e zonave të ndjeshme specifike. - Mirëmbajtja e kapacitetit kullosor	- Punime përmirësuese të kullotave: pastrim gurësh. - Mbjellja e drurëve foragjerë në formë brezash përreth fshatrave.	- Organizimi i kullotjes racionale - Përjashtimi i kullotjes ne zona më të ndjeshme (tokat e eroduara, sip. që kanë nevojë për ripërtëritje) Lidhja e kontratave me përdoruesit.

IX.5.5 Objektivat specifikë për biodiversitetin

Ruajtja e biodiversitetit aktual dhe përmirësimi i gjendjes së habitateve dhe biotopeve janë objektivat kryesore të këtij plani mbarështrimi. Mbarështrimi i pyjeve dhe teknikat silvikulturore do i kushtojnë një vëmendje të veçantë arritjes së objektivave të mëposhtme:

- Mbrojtjes në mënyrë strikte të specieve në librin e kuq, gjatë ndërhyrjeve të propozuara në objektivat e këtij plani mbarështimi.
- Ruajtjes së një rrjeti drurësh me vlera të larta biologjike (drurë të tharë, të moçëm, me zgavra). Disa individë me diametër të madh nuk do të shfrytëzohen për të përmirësuar zhvillimin e dendro-mikro-habitateve specifikisht lidhur me drurët e tharë;
- Mbrojtjes së drurëve të tharë e të rrëzuar dhe disa cungjeve të lartë për zhvillimin e myshqeve saprofite të drurit;
- Promovimit, sa më shumë të jetë e mundur, të grumbujve pyjorë të përzier dhe ripërtëritjes natyrore të specieve të adaptuara;
- Evolucionit natyral tëçeltirave midis grumbujve (më pak se 0.5 ha) të ripërtërira nga shqetësimet e rreziqeve;
- Ruajtjes së skajeve të pyjeve;
- Afatevetë ndërhyrjeve duke shmangur periudhat kritike për ciklet jetësore të specieve të rralla ose të mbrojtura.

IX.5.6 Objektivat specifikë për gjendjen shëndetësore

Ashtu si më sipër kemi theksuar, EP Sopot nuk paraqet shqetësime të shëndetit të grumbujve në kufirin e saj, por del detyrë e stafit përgjegjës pranë bashkisë Përrenjas për të ndjekur në vijimësi ecurinë e grumbujve të kësaj ekonomie me një theks të veçantë tek shëndeti i tyre.

Një vëmendje e veçantë do i kushtohet vëzhgimit të efekteve nga thatësira apo ngrohja globale në kontekstin e ndryshimeve klimatike në vazhdimesi. Kështu, një monitorim specifik i shëndetit të grumbujve do të jetë i domosdoshëm përgjatë kohëzgjatjes së këtij PMPK. Drurët e rrëzuar nga shkaqe natyrore (rrëzimet për shkak të moshës, erës, borës, akullit dhe faktorëve të tjerë atmosferikë) do të mbeten në gjendjen e tyre natyrale, duke i lënë në procesin e dekompozimit natyral.

IX.5.7 Objektivat specifikë për faunën e egër

Fauna e egër është një përbërës i rëndësishëm i biodiversitetit të EP Sopot. Duke qënë se tashmë është në fuqi moratoriumi i gjuetisë, mbrojtja e faunës së egër do të jetë më e lehtë dhe më e mirë përgjatë kohëzgjatjes së këtij plani mbarështrimi.

IX.5.8 Objektivat specifikë për pyjet me funksion prodhues

Në ekonominë pyjore Sopot pyjet me funksion prodhues zënë 1487.37 ha të sipërfaqes së përgjithshme me pyje të kësaj ekonomie. Me gjithë gjendjes aktuale që shfaqet grumbujt e kësaj ekonomie aktualisht, prespektiva e tyre duket premtuese sa kohë që do të ndiqen me rigorozitet objektivat 10 vjecare te planifikuar për të çuar grumbujt e kësaj ekonomie drejt një stadi klimaks më të avancuar ku mund të përfitojnë nga ato që ofron potencialisht stacioni.
Për këtë qëllim, objektiva dhe masa të veçanta janë planifikuar për t'u zbatuar gjatë 10 viteve në vijim të këtij plani.
Në mënrë të përmbledhur do të diferemcojmë në vijim, objektivat specifikë për pyjet prodhues.

Funksionet kryesore dhe specifike te propozuar

Funksioni	ha	%
Ekonomia pyjore : Sopot		
Mbrojt+Prodhues	35.11	2.4
Pr.drusore-Dru zjarri	12.89	36.7
Pr.drusore-Lende punimi	12.89	36.7
Mbrojtje-Toka	22.22	63.3
Prodhues	1391.56	93.6
Pr.drusore-Dru zjarri	287.25	20.6
Pr.drusore-Lende punimi	592.13	42.6
Pr.drusore-Lende ndertimi	215.15	15.5
Pr.te dyta-Bar	2.07	0.1
Mbrojtes	94.06	6.3
Mbrojtje-Toka	71.71	76.2
Totali i ekonomise:	**1487.37**	

Sikurse mund të shikohet nga rezultatet e përpunimit të të dhenave, për pyjet me funksion prodhues do të ketë 3 funksione specifike të propozuara:

a. Funksioni i prodhimeve drusore – Druve të zjarit
b. Funksioni i prodhimeve drusore dhe lëndës së punimit
c. Prodhime drusore-lendë ndërtimi

Funksioni specifik "a, b, c" është propozuar kryesisht për pyjet në formën e qeverimit trungishte.

IX.5.9 Objektivat specifikë për pyjet me funksion mbrojtës

Parcelat pyjore me funksion mbrojtëskanësi funksion specifik mbrojtjen e tokës dhe të veprave nga rrëshqitja, erozioni dhe dëmtime të tjera. Në objektivat mbrojtës në EP Sopot përfshihen 3 objektiva secifikë dhe konkretisht:

a. Funksioni specifik për Mbrojtjen e tokës
b. Funksioni specifik për mbrojtjen e ujërave
c. Funksioni specifik për infrastrukturën

IX.5.10 Objektivat specifikë për pyjet me funksion rekreativ

Nuk janë përcaktuar objektiva të tillë në EP Sopot.

IX.5.11 Objektivat specifikë për pyjet me status mbrojtës

Nuk ka pyje me status të tillë në EP Sopot

X. Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK

X.1 Mundësia vjetore e shfrytëzimit

Munesia vjetore e shfrytezimit e lejuara ne 1 vit eshte llogaritet bazuar ne rritjen vijuese vjetore te njesise se mbareshtrimit duke synuar nje ekulibirim te klasave te moshe si dhe prerja e lejuar vjetore eshte percaktuar bazuar ne llogaritjen e mundesise vjetore te shfrytezimit

Mundesia vjetor e shfrytezimit eshte percaktuar duke llogaritur bazuar ne mundesine teknike te shfrytezimit per parcelat pyjore me funksion prodhues. Lidhur me moshen e shfrytzueshmerise teknike eshte mare ne konsiderate mosha qe rritja mesatare e asortimeneteve drusore nga inventarizimi ne terren dhe llogaritjet ne programe jane maksimale. Llogaritja eshte bere per

secilen klase prodhimi si nje mesatare e ponderuar e volumit dhe siperfaqes per secilen klase prodhimi duke e pjestuar me shumen e siperfaqes pyjore sipas klasave te prodhimit.Prerja e lejuar vjetore jan llogaritur bazuar ne siperfaqen pyjore dhe volumin.

Për të qenë sa më afër realitetit, në lidhje me përcaktimin e sasisë së lëndës drusore që duhet të shfrytëzohet në një vit, po trajtojmë metoden me te pershtatshme për të pëcaktuar mundësinë vjetore të shfrutëzimit per tu parefersuar realitetit kryesisht mbi bazen e rritjes vijuese.

Metoda : Vlerësimi i mundësisë vjetore të shfrytëzimit bazuar tek volumi (metoda Von Mantel)

Ekonomi pyjore Sopot do te menaxhohet nen nje sistem silvikulturor monociklik dhe metoda me e thjeshte per llogaritje e prerjes se lejuar vjetore eshte duke pjestuar 2 here volumin e grumbullit ne kembe me periudhen e rrotacionit ose ciklin e prerjes.

Duke marrë në konsideratë që rritja normale për shkurret nuk pasqyrohet në tabelat e prodhimit, për llogaritjen e mundësisë vjetore të shfrytëzimit është përdorur metoda Von Mantel. Kjo metodë bazohet në volumin në këmbë dhe ciklin/rotacionin e prerjes për çdo formë regjimi qeverisës. Ekuacioni i përdorur është si më poshtë:

$$AAC = \frac{2 \cdot V}{R}$$

Ku:
R – periudha e rotacionit (ciklit të prerjes) për speciet kryesore të ekonomisë pyjore;
V – volumi mesatar për speciet kryesore.

Në llogaritje, periudha e rotacionit për pyjet trungishte konsiderohet 85 vjet, për cungishtet 40 vjet dhe për shkurret 15 vjet.

Regjimi i	**Volumi (m3)**	Rotacioni	**AAC (m^3/vit)**
Trungishte	**132567.6**	85	**3119.2**
Cungishte	**1323.6**	40	**66.18**
Gjithsej	**133891.2**		**3185.3**

Sipas kësaj metode (Van Mantel), mundësia vjetore e shfrytëzimit për EP Sopot është **3185.3 m^3/vit**.

Për sa më sipër parashtruam, mundësia e llogaritur vjetore e pranuar për pyjet e EP Sopot do të konsiderohet ajo e llogaritur nga metoda Van Mantel e cila ka përcaktuar një sasi prerjesh vjetore në masën **3185.3 m^3/vit**.

Rritja vijuese vjetore e cila eshte e pasqyruar ne relacionin e planit te mbareshtimit dhe jan bashkelidhur eshte me e madhe se sa eshte percaktuar mundesia vjetore e shfrytezimit (Van Mantel).

Kjo sasi vjetore konsiderohet si garanci për sigurimin e vijueshmërisë së prodhimit e krahasuar kjo dhe me rritjen vijuese vjetore duke mos e kaluar 80% te volumit te rritjes vjetore me synimin per te ruajtur nje ekuiliber te klasave te moshes dhe të mbarështimit të qëndrueshëm të EP Sopot.

X.2 Prerjet silvikulturore vjetore

Prerjet silvikulturore vjetore përfaqësojnë sasinë e lëndës drusore që rrjedh nga ndërhyrjet silvikulturore në 1 vit. Këto ndërhyrje përfshijnë lëndën drusore që rrjedh nga rrallimet dhe prerjet përfundimtare.

Më poshtë do të paraqesim të dhënat e marra nga programi i përpunimit të të dhënave MS Access DB, për të gjitha format e qeverimit:

Për pyjet me formë qeverimi trungishte rezulton:

Prerjet e lejuara - total (trungishte)

Tipi i nderhyrjes	Urgjenca	N/ng	Sip (ha)	Vol (m3)
Ekonomia Pyjore : Sopot				
Rrallim tipi I	*total*		*262.61*	*5211.78*
		1	155.16	3290.88
		60 052a	21.19	542.42
		60 023a	51.92	1080.98
		60 016a	18.50	297.04
		60 045a	16.34	436.76
		60 027a	30.94	561.29
		60 055a	16.27	372.40
		2	107.46	1920.90
		60 017a	2.34	45.78
		60 043a	19.44	318.94
		60 053a	49.65	943.23
		60 046a	20.68	342.52
		60 022a	15.35	270.44
Rrallim tipi II	*total*		*39.79*	*553.65*
		1	17.20	341.85
		60 014a	17.20	341.85
		2	22.59	211.80
		60 015a	22.59	211.80
pergatitore	*total*		*20.97*	*924.46*
		2	20.97	924.46
		60 039a	20.97	924.46
perfundimtare	*total*		*50.30*	*3176.70*
		1	50.30	3176.70
		60 042a	34.18	1887.43
		60 041a	16.12	1289.26
Shfrytezime-prerje sa	*total*		*392.83*	*6042.07*
		1	262.20	4103.76
		60 054a	29.49	348.98
		60 029a	56.95	1199.15
		60 035a	13.34	123.11
		60 058a	26.62	360.02
		60 034a	28.08	92.41
		60 049a	16.25	332.07
		60 047a	40.93	675.49
		60 056a	42.81	501.08
		60 09a	7.73	471.45
		2	130.63	1938.30
		60 062a	11.61	144.16
		60 021a	20.00	342.13

Tipi i nderhyrjes	Urgjenca	N/ng	Sip (ha)	Vol (m3)
		60 036a	11.47	48.84
		60 037a	25.96	165.87
		60 044a	32.81	578.93
		60 020a	18.52	190.30
		60 019a	10.26	468.07
Totali i ekonomise :			**766.50**	**15908.65**

Permiresimi i cungishteve

Men e trajtimit	N/Ng	%sip.	Sip (ha)	Intensit.	Vol (m3/ha)	Vol (m3)	Urg
Ekonomia Pyjore : Sopot							
Prerje sanitare							
	60 013a	100	34.1	20	8	265	3
TOTAL			**34.1**		**8**	**265**	

Ashtu si më sipër shikohet, nga zbatimi i masave të planifikuara në objektivat e këtij plani mbarështimi për 10 vitet në vijim, për të gjitha format e qeverimit, do të sigurohet një sasi materiali drsor prej **16173.6 m^3.** Kjo sasi rezulton nga prerjet e lejuara vjetore në pyjet trungishte të EP Sopot, në një sasi prej **15908.6 m^3**, dhe nga punimet prerje sanitare në cungishte, me një volum prej **265 m^3**, të cilët në total realizojnë një sasi prej **16173.6 m^3**.

Kjo sasi, së bashku me shtesën vjetore natyrale (rritja vijuese) në të dy format e qeverimit rezulton të jetë në **19749.1 m^3** në total ekonomie.

Më poshtë po paraqesim të dhënat nga programi i përpunimit të të dhënave MS Access DB, në nivel ekonomie për rritjen vijuese (shtesën natyrore vjetore) dhe mesatare, për të dy format e qeverimit.

Rritja vijuese dhe mesatare (Trungishte)

(Analize per llojet kryesore)

K1 moshes	Siperfaqja		Lloji	Rritja vijuese(m3)	Rritja mesatare(m3)
Ekonomia Pyjore : Sopot					
Pyje Prodhues					
	0.00	1141.25	AH	3315.18	2707.72
	0.00	89.58	BRB	277.62	232.57
	0.00	1.24	BUN	3.49	3.31
	0.00	0.73	Mll	5.73	3.02
	0.00	33.44	PIZ	93.60	78.71
Total Pyje Prodhues	***0.00***	***1266.24***		***3695.62***	***3025.33***
Pyje Mbrojtes					
	0.00	79.57	AH	138.30	168.73
	0.00	8.32	BRB	0.00	33.28
	0.00	1.77	BUN	8.15	9.27
	0.00	1.57	Mll	13.57	10.31
	0.00	31.88	PIZ	0.00	110.31
	0.00	3.57	RO	12.85	25.31
Total Pyje Mbrojtes	***0.00***	***126.67***		***172.87***	***357.21***
Totali i Ekonomise :	**0.00**	**1392.91**		**3868.49**	**3382.55**

Rritja vijuese dhe mesatare (Cungishte)

(Analize per llojet kryesore)

K1 moshes	Siperfaqja		Lloji	Rritja vijuese(m3)	Rritja mesatare(m3)
Ekonomia Pyjore : Sopot					
Pyje Prodhues					
	0.00	2.47	FRZ	12.59	6.68
	0.00	2.46	Mll	22.24	12.22
	0.00	0.95	PAM	2.97	1.65
	0.00	9.07	PIZ	18.21	12.74
	0.00	19.10	SHP	32.19	28.97
Total Pyje Prodhues	***0.00***	***34.05***		***88.20***	***62.25***
Pyje Mbrojtes					
	0.00	16.73	AH	9.36	30.59
	0.00	4.44	BRB	0.00	10.98
	0.00	1.77	BUN	8.15	9.27
	0.00	0.66	Mll	13.57	7.31
	0.00	19.55	PIZ	0.00	71.78
	0.00	0.34	RO	0.46	0.90
Total Pyje Mbrojtes	***0.00***	***43.49***		***31.54***	***130.82***
Totali i Ekonomise :	**0.00**	**77.54**		**119.74**	**193.07**

Nga sa më sipër parashtruam, mbështetur në të dhënat e siguruara nga përpunimi i të dhënave, në mënyrë të përmbledhur po paraqesim tabelën në vijim.

Nr.	Forma. Qev	Ndërhyrja	Volumi (m^3)
1	TRUNGISHTE	Rrallim Tip I	5211.7
2		Rrallim Tip II	553.6
3		Shfrytëzim-Prerje sanitare	6042
5		Përgatitore	924.4
6		Përfundimtare	3176.7
A	**Total shtresa (1+2+3+4+5+6)**		**15908.6**
7	CUNGISHTE	Prerje sanitare	265
B	**Total shtresa (7)**		**16173.6**
8	**ShtesanatyroreTrungishte**		**3382.5**
9	**ShtesanatyroreCungishte**		**193**
Gjithsej (m^3) (A+B+8+9)			**19749.1**

X.3 Planifikimi vjetor i masave

X.3.1 Masat në pyje

Këto ndërhyrje përfshijnë përmirsimet pyjore dhe prerjet përfundimtare. **Në shtojcën 4 përshkruhen ndërhyrjet kryesore të planifikuara për t'u kryer gjatë viteve në vijim në parcelat pyjore të EP Sopot.**

X.3.2 Masat në kullota

Ne EP Sopot siperfaqja e kullotave eshte 78.9 ha. Nder masat e propozuara eshte heqja e gureve, pastrimi barerave te keqia, ndertim lerash uji.

X.3.3 Masat në infrastrukturë dhe në sipërfaqet e degraduara, rekreative dhe didaktike

Sikurse është përmendur, kufizimi parësor dhe mbizotërues është gjendja mesatarisht e degraduar e infrastrukturës rrugore dhe i duhet kushtuar një vemendje e veçantë përmirësimit të rrjetit rrugor, si një parakusht për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë lidhur me mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave. Masat përkatëse do të ndërmerren nga Bashkia në përputhje me politikat e saj për rrugët. Gjithashtu për rastin e zhvillimit të aktiviteteve rekreative, masat do të ndërmerren në përputhje me politikat e saj mbi turizmin.

X.4 Masat afatgjata

X.4.1 Masat silvikulturore në pyjet trungishte

Masat silvikulturore në trungishte përfshijë, rralime Tip I, Tip II dhe Shfrytëzime-Prerje sanitare, përgatitore, përfundimtare.

Te detajuara këto të dhëna paraqiten si në tabelën më poshtë:

Prerjet e lejuara

Tipi i grumbullit	Funksioni	Kl moshes	Men e trajtimit	N/Ng	%sip.	Intensit.	Sip (ha)	Vol (m3/ha)	Vol (m3)	Urg
Ekonomia Pyjore : Sopot										
Pyje me ah										
	Mbrojt+Prodhues									
		5								
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 021a	90	15	20.0	17.1	342.1	2
	Prodhues									
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 062a	90	15	11.6	12.4	144.2	2
		2								
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 034a	80	10	28.1	3.3	92.4	1
				60 035a	85	15	13.3	9.2	123.1	1
		3								
			Rrallim tipi I							
				60 023a	90	25	51.9	20.8	1081.0	1
				60 027a	90	25	30.9	18.1	561.3	1
		4								
			Rrallim tipi I							
				60 043a	100	20	19.4	16.4	318.9	2
				60 045a	80	25	16.3	26.7	436.8	1
				60 055a	90	25	16.3	22.9	372.4	1
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 020a	85	15	18.5	10.3	190.3	2
				60 044a	90	15	32.8	17.6	578.9	2
				60 047a	85	15	40.9	16.5	675.5	1

Tipi i grumbullit	Funksioni	Kl moshes	Men e trajtimit	N/Ng	%sip.	Intensit.	Sip (ha)	Vol (m3/ha)	Vol (m3)	Urg
				60 056a	90	15	42.8	11.7	501.1	1
				60 058a	90	15	26.6	13.5	360.0	1
		9								
			pergatitore							
				60 039a	90	30	21.0	44.1	924.5	2
			perfundimtare							
				60 041a	80	30	16.1	80.0	1289.3	1
				60 042a	90	30	34.2	55.2	1887.4	1
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 029a	100	15	57.0	21.1	1199.2	1
				60 036a	55	5	11.5	4.3	48.8	2
				60 037a	80	10	26.0	6.4	165.9	2
Pyje ahu me bredh te bardhe										
	Mbrojt+Prodhues									
		8								
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 09a	60	10	7.7	61.0	471.5	1
	Prodhues									
		3								
			Rrallim tipi I							
				60 022a	90	20	15.3	17.6	270.4	2
		4								
			Rrallim tipi I							
				60 046a	90	15	20.7	16.6	342.5	2
				60 052a	100	25	21.2	25.6	542.4	1
				60 053a	100	20	49.7	19.0	943.2	2
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 049a	90	15	16.2	20.4	332.1	1
				60 054a	90	15	29.5	11.8	349.0	1
		9								
			Shfrytezime-prerje sanitare							
				60 019a	80	15	10.3	45.6	468.1	2
Pyje ahu me pishe te zeze										
	Prodhues									

Tipi i grumbullit	Funksion	Kl moshes	Men e trajtimit	N/Ng	%sip.	Intensit.	Sip (ha)	Vol (m3/ha)	Vol (m3)	Urg
		4								
			Rrallim tipi I							
				60_016a	95	20	18.5	16.1	297.0	1
				60_017a	40	20	2.3	19.6	45.8	2
			Rrallim tipi II							
				60_014a	95	15	17.2	19.9	341.8	1
Pyje pishe te zeze me ah										
	Prodhues									
		4								
			Rrallim tipi II							
				60_015a	90	15	22.6	9.4	211.8	2
	766.5	22.2							15908.6	

Për të krijuar nja ide mbi volumet respektive që dalin nga masat silvokulturore, më poshtë po paraqesim tabelen e radhes e cila do të përdoret për analizë në këtë material.

Në total ekonomie, për formën e qeverimit trungishte, do të përshkohen me ndërhyrje silvikulturale 766.5 ha, nga ku do të rezultojnë 15908.6 m^3 lëndë drusore.

Do të kryhen tre tipe të ndërhyrjeve silvikulturale:

a. **Rrallime tip I,** të cilat do të aplikohen në 262.6 ha, nga ku do përfitohen 5211.7 m^3 lëndë drusore. Ndërhyrjet në këtë tip janë planifikuar të shtrira në 10 vite sipas urgjencave 1 (1-3 vjet, ose 2024,2025, 2026), 2 (4- 7 vjet ose 2027, 2028, 2029).
b. **Rralime tip II,** do të aplikohen në një sipërfaqe prej 39.8 ha, nga ku do përfitohen 553.6 m^3 lëndë drusore, këto të planifikuara për t'u aplikuar përgjatë viteve 2026, 2028, ose në urgjencën e dytë sikurse njihet kodi i programit.
c. **Shfrytëzime-Prerje sanitare,** ku gjatë kësaj ndërhyrje do të hiqen drurët e nënshtruar të shtrembët e që paraqesin probleme, duke krijuar hapësirat e nevojshme për intensifikimin e rritjes së grumbullit. Kjo lloj ndërhyrjeje do të aplikohet në 392.8 ha dhe nga ku do të përfitohën 6042.07 m^3 lëndë drusore. Sikurse cituam edhe më lart, punimet janë të shpërndara përgjatë 10 viteve në të cilën ky plan do të ketë fuqi ligjore dhe përfshin urgjencën 1, 2.
d. **Përgatitore,** do të aplikohen në nje sipërfqe prej 20.9 ha në një volum prej 924.4 m^3, ku gjatë kësaj ndërhyrje do të favorizohen zhvillimin e kurorave të drurve në këmbe, depërtimi i nxehtësisë në tokë, faktori dritë, si dhe do të nxirren nga grumbulli ekzemplarët më pak të vlefshme.
e. **Përfundimtare**, do të aplikohet në një sipërfaqe prej 50.3 ha dhe një volum prej 3176.7 m^3, gjatë vlersimit dhe gjëndjes aktuale, çmohet se filizëria ka arritur të formojë në të gjithë sipërfaqen gjëndjen e masivit, në këtë rast do të vilen drurët e fundit në këmbë nga grumbulli i moçem, për ti dhënë liri dhe prioritet zhvillimit të grumbullit të ri.

Të gjitha tipet e ndërhyrjeve që përshkuam më sipër do të realizohen në grumbujt pyjor me pisha mesdhetare, me lloje përbërëse pishe e egër dhe pisha te buta.

X.4.2 Pyllëzimet dhe ripyllëzimet

Nga inventarizimi i kryer EP Sopot nuk ka sipërfaqe të djegura, apo të degraduar që mund të ripyllëzohen, ripërtëritja natyrore si në grumbujt trungishte dhe cungishte është relativisht e konsiderueshme.

X.4.3 Masat e aplikuara në kullota

Ne kete ekonomi pyjore ne kullote propozojme riparimin e lere uji per bagetite dhe permirsimin e siperfaqes duke pastruar barërat e këqija duke synuar largimin e gureve dhe grumbullimin e tyre.

Kodi ID	Ekonomia Pyjore	Ngastra	Sip_ha	Ndërhyrjet	Urgjenca	Viti
EL60 00 016b	EP Sopot	16b	6.12	Heqje barërash të këqija	II-të	2030
EL60 00 023b	EP Sopot	23b	22.53	Grumbullim gurësh	III-të	2032
EL60 00 026b	EP Sopot	26b	9.74	Grumbullim gurësh	III-të	2032
EL60 00 031b	EP Sopot	31b	0.68	Merimetim Lere Uji	I-rë	2026
EL60 00 049b	EP Sopot	49b	1.80	Heqje barërash të këqija	II-të	2031

X.4.4 Gjendja dhe masat në infrastrukturë

Infrastruktura është pjesë e zhvillimit shumëdimensional të një ekonomie pyjore. Siç përmendet edhe më sipër, objektivat parësore lidhur me këtë aspekt mbeten mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese, aktualisht e rrjeti rrugor ka nevoje per permirsim. Investimet financiare që i takojnë mirëmbajtjes dhe zhvillimit të infrastrukturës rrugore lidhen jo vetëm me përfitimet në pyje dhe kullota, por gjithashtu edhe me të ardhurat indirekte të mundësuara nga një atraksion më i mirë i ekonomisë pyjore, gjithashtu edhe në rastet e rënies së zjarreve në pyje shërbejnë si koridore për parandalimin e tyre.

Si rezultat nuk do të propozojmë masa për këtë qëllim.

X.4.5 Masat specifike për aktivitetet rekreative dhe didaktike

Nuk ka.

XI. Vlerësimi ekonomik

XI.1 Vlerësimi i ndikimeve të masave të planifikuara mbi pyjet dhe kullotat

Të gjitha masat e propozuara për t'u kryer në pyje, synojnë në përmirësimin e prodhimtarisë së tyre dhe rritjen e përfitimeve për bashkinë dhe komunitetin lokal. Ndërhyrjet silvikulturore, të tilla si: pastrime, rrallimet, prerjet sanitare në grumbujt e moçëm, prerjet përfundimtare, përgatitore apo përmirësimet pyjore në pyjet cungishte synojnë të përmbushin kërkesat e popullsisë për dru zjarri dhe të përshpejtojnë rritjen e drurëve të mbetur.

XI.2 Planifikimi i të ardhurave / përfitimeve

Në këtë seksion kemi vlerësuar sasinë e përfitimeve të pritshme në terma financiarë nga prodhimet pyjore drusore. Krahas këtyre përfitimeve, ne do të marrim parasysh gjithashtu edhe ndikimin e tyre në sekuestrimin e karbonit dhe erozionin e tokës që janë valorizuar bazuar në studimet më të fundit. Për tarifat e prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore i jemi referuar VKM Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve, tarifave për dhënien në shfrytëzim/ përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore".

Më poshtë në formë tabelare do të përcaktojmë të gjithë të mirat që do të vilen nga fondi pyjor i EP Sopot, dhe do ti përkthejmë në vlera financiare, për arsye logjike do të punojmë në tabela të ndryshme me synim llogaritjen e saktë të përfitimeve që vijnë nga aktivitetet ne fondin pyjor të EP Sopot.

A. Tabela me të dhëna për shitjen e lëndës drusore

Sipas të dhënave të siguruara nga tabela e diferencimit të lëndës drusore për të gjykuar mbi cilësinë e lëndës në këmbë kemi paraqitjen e mëposhtme.

Duke iu përshtatur formatit të VKM 559, e cila e kategorizon lëndën në dy kategori "Lëndë e trashë dhe e mesme (>22 cm) " dhe "Lëndë e hollë (≤ 22 cm)", është diferencuar volumi përkatës për pishën e zeze, bredhi i bardhe, ahun dhe fletorë të tjere, dhe është bashkuar lënda e hollë dhe ajo e mesme.

Referenca e çmimeve është marrë nga pika 3.1 e Shtjcës 3, e VKM 559.

Nr	Emërtimi	Grupi	Njësia	Sasia ne 10 vjet	Çmimi për njësi (lekë)	Vlera gjithsej në lek
1	Lëndë e trashë	fletorë	m^3	45864	4000	183,456,000
2	Lëndë e hollë		m^3	51099	2500	127,747,500

3	Dru zjarri		m ³	17043	600	10,225,800
4	Lëndë e trashë	Halorë P.zeze, Robull	-	6752	3500	23,632,000
5	Lëndë e hollë		m ³	3409	3000	10,227,000
6	Dru zjarri		m ³	891	250	222,750
7	Lëndë e trashë	Halorë Bredhi i Bardhe	m ³	4048	4500	18,216,000
9	Lëndë e hollë		m ³	3993	3500	13,975,500
8	Dru zjarri		m ³	792	250	198,000
	Gjithsej					**387,900,550**

Shënim: kemi llogaritur stokun e karbonit për EP Sopot, i cili kap një vlerë relativisht të konsiderueshme, llogaritja nga përfitimi i këtij komponenti nuk do të llogaritet, për shkak të mungesës së eksperiencës në treguin tonë si dhe për shkak të mungesës së komponentit të çertifikimit të pyjeve në vendin tonë. Në çdo rast që lind nevoja dhe krijohen kushte të tilla, bashkia mund të negociojë mbi **sasinë 137244 ton, e cila është llogaritur në tabelat e meparshme.**

Nga sa më sipër llogaritëm, rezulton se përfitimi nga aktivitetet e ndyshme dhe stoku i lëndës drusore në EP Sopot të jetë: **387'900'550 lekë,** nëse planifikimet e kryera dhe rekomandimet e këtij plani mbarështimi zbatohen për 10 vitet në vijim.

XI.3 Planifikimi i shpenzimeve

Karakteristika kryesore që duhet theksuar është tendenca e qartë për rënien e shpejtë demografike, e cila ka nisur që në vitin 1991 për secilën grup moshë, gjini dhe klasë shoqërore nëpërmjet migrimit nga fshatrat në zonat urbane kryesisht në Përrenjas apo edhe emigracionit jashtë vendit ku renditen shtete të tillla si Italia dhe Greqia kryesisht, por vitet e fundit ka emigrantë edhe në shtete të tjera të evropës, USA, etj. Në disa zona të thella,

kjo rënie shkon deri në pesë herë më pak banorë. **Prandaj, ky fenomen ka një ndikim madhor duke zvogëluar në mënyrë të ndjeshme presionin nga fshatrat mbi burimet pyjore dhe kullosore, ndonëse janë vërejtur shenja të presionit të lartë në disa zona në afërsi të fshatrave.**

Situata social ekonomie e zonës ka një ndikim shumë të madh nga remitancat të cilat vijnë nga emigracioni, por jo vetëm, pasi zhvillimi ekonomik multidimensional (agroturizëm, blegtori, vreshtari) etj ka një shfaqje interesi në rritje.

Në përfundim theksojmë se gjendja social ekonomike e zonës nuk është e mirë, duke luajtur një rol thelbësor në rënien e presionit mbi burimet natyrore të EP Sopot, dhe zhvillimin e tyre natyror. Kjo sic do të shikohet edhe me poshtë vërehet në shtimin e sipërfaqes pyjore dhe rënien e ndjeshme të sipërfaqes jo-produktive në konturin e këaj ekonomie, duke shfaqur fenomenin e suksesionit ekologjik natyror pozitive.

II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore

Ashtu si më sipër theksuam, mënyrat e tjera të jetesës që favorizojnë popullsinë që jeton në afërsi të ekonomisë pyjore Sopot, ka bërë të mundur që shfrytëzimi i resurseve natyrore të jetë larg vëmendjes për momentin.

Ndërsa prania e prodhimeve jo-pyjore në zonë, megjithëse konsiderohet e larmishme, nuk paraqet interes dhe as përbën ndonjë alternativë (me përjashtime të pakta) për banorët e zonës që të garantojnë të ardhura nga ky aktivitet. Prodhimet jodrusore gjithashtu përdoren më së shumti për nevojat lokale, me nivel të ulët tregtimi. Ne zone ka mjaft specie pyjore dhe bime mjeksore qe mund te grumbullohen dhe tregtohen pasi ka kerkesa ne terg per to, por per shkak te mungeses se fuqise punetore ato nuk vilen dhe nuk perdoren si burim te ardhurash nga banoret.

Nga sa më sipër theksojmë se, tregëtimi i produkteve pyjore dhe jo-pyjore me origjinë nga EP Sopot, si në zonë apo edhe jashtë saj, është në limitet minimale të saj dhe nuk përbën dhe as ka ndonjë impakt në ekonominë e zonës.

II.8 Gjuetia dhe peshkimi

Për shkak të moratoriumit aktual të gjuetisë së faunës së egër, gjuetia është një aktivitet i munguar dhe nuk gjeneron të ardhura. Kafshët karakteristike të kompleksit të faunës janë ujku, dhelpra, derri i egër, lepuri, bufi i malit, qukapiku, bilbili, Thëllëza e malit, Dhia e egër Rrëqebulli etj.
Zona e EP Sopot nuk ofron ndonjë mundësi për peshkim, kjo për shkak të karakteristikave gjeologjiko-hidrike.

II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike

Zonat për-rreth dhe në brendësi të EP Sopot ka një potencial të mirë për të zhvilluar aktivitete rekreative dhe turistike, veçanërisht lidhur me bukuritë natyrore tësaj të cilat duhet te reklamohen dhe vizitohen nga turistet, veçanarisht turizmi malor. Cilësia e peizazheve të ndryshme ofron mundësinë për të zhvilluar infrasktrukturën dhe objektet turistike, bazuar në ato ekzistuese të pakta (shtigje, zona pikniku, ski, sipline etj) dhe me qëllim zhvillimin e turizmit malor.

Zhvillimi i këtij sektori me peshë të jashtëzakonshme në ekonominë e zonës për-rreth ekonomisë, duhet të shkojë paralelisht me zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të saj, të cilat gërshetohen më së miri në funksion të zhvillimit të turizmit rural

Si konkluzion vlen të theksojmë se bazat për zhvilimin e turizmit në zonë tashmë janë hedhur. Mbetet vetëm zhvillimi i qëndrueshëm mbështetur në traditën e zonës dhe gërshetimi me bukuritë natyrore të saj dhe larmishmërinë kulturore dhe të besimit.

II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje

Në territorin e ekonomisë pyjore Sopot nuk ka site dhe specie me vlera të larta të mbrojtjes. Për këtë qëllim të gjitha njësitë dhe nën-njësitë e ekonomisë (parcelat dhe nënparcelat) kanë patur të shumtat funksione prodhuese. Por sigurisht, që mbrojtja e habitateve të veçanta në këtë ekonomi pyjore do të jetë në qendër të vëmendjes gjatë hartimit të detyrave dhe objektivave të zhvillimit të saj në vijim.

III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave

III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave

III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Sipas VKM nr. 684, dt. 2.09.2020, përdorimi i territorit në EP Sopot jepet në tabelën më poshtë.

Përdorimi i tokës (ha)	Përdorimi i tokës (bazuar në VKM)	Sipas Planit të Mbarështimit 2024	Pyje Private (fisi Dashi dhe Vreto)
Pyll	1546.51	1439.9	
Kullotë	72.2	78.9	
Sipërfaqe me bimësi pyjore	0	15.1	
Djerr	0	0	
Sipërfaqe inproduktive	62.2	37.2	
Gjithsej	**1680.9**	**1571.1**	**131.09**

Ashtu sikurse vërehet, ka një shtesë prej 22 ha në total të sipërfaqes së ekonomisë pyjore, krahasuar me sipërfaqen e dhënë në VKM. Kjo shtesë vjen për arsyet e mëposhtme:

1. **Po ashtu, përdorimi i programeve kompjuterike në hartografim nëpërmjet programit GIS, gjeoreferencimit të konturit të parcelave, nënparcelave dhe atij të jashtëm të ekonomisë pyjore Sopot, ka rritur saktësinë e matjes, duke rritur kësisoj sipërfaqen e përgjithshme të ekonomisë.**
2. **Sipërfaqja prej 131.09 ha referuar Çertifikatave të pronësisë i përket fiseve Dashi dhe Vreto duke përfshirë kategoritë e përdorimit Pyll dhe Kullotë, dhe shuma totale krahësuar me vkm 1702.19 ha, nga të cilat 1571.1 ha janë pjesë e Bashkisë Përrenjas.**

Në pikat në vijim të këtij relacioni, do të shpjegojmë edhe arsyet e ndryshimeve që vërehen nga njëra kategori e përdorimit të tokës në tjetrën, mbështetur në fakte dhe rezultate të matjeve në terren.

Në tabelën më sipër, kanë dhënë rezultatet vetëm për fondin pyjor dhe kullosor bashkiak, pa përmendur zonat të cilat në fakt kanë pronësi private dhe nuk do të trajtohen nga ky plan mbarështimi.

Për analogji theksojmë se në total janë 131.09 ha me formë përdorimi pyje private të cilat bëjnë pjesë në konturin e kësaj ekonomie pyjore.

Për të ilustruar formën e përdorimit të tokës dhe formës së qeverimit, sipas inventarit të vitit 2001, ose atë të pasqyruar në VKM nr.684 e sipërcituar, më poshtë gjendet figura nr. 3, nëpërmjet të së cilës, paraqiten format e përdorimit të tokës.

III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Ne tabelen e meposhtme jepet sipërfaqja pyjore sipas regjimit te qeverisjes referuar planit te inventarizimit te vitit 2001 dhe atij aktual. Nga krahasimi konstatohet se ka mjaft ndryshime dhe keto kane ardhur per shkak se nje pjese e pyjeve kane kaluar nga një formë qeverimi në një formë tjetër. Nga analiza vihet re se, kemi shtim të sipërfaqes në formën e përdorimit "Pyje"

Regjimi i qeverisjes së pyjeve në EP Sopot	Plani i mëparshëm Inventarizimit_2001		PMPK aktual	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Trungishte	1880.6	93.3	1439.9	92.7
Cungishte	20.8	1.03	34.1	2.2
Shkurre	0	0	0	0
Kullota ,livadhe	113.7	5.67	78.9	5.1
Gjithsej	**2015.1**	**100**	**1552.9**	**100.0**

Nga analiza vihet re se, kemi pakësim të sipërfaqes në formën e përdorimit "Pyje" me rreth 440.7 ha më pak dhe në kullotë 34.8 ha, si dhe një shtesë në formën e qeverisjes Cungishte me 13.3 ha. Por kemi referuar Vkm nr.102 datë 15.01.1996 e shpallur si "rezerve Natyrore e Menaxhuar: kategoria e IV zonë e mbrojtur, e cila ka marr sipërfaqe nga territori brenda konturit të ekonomisë pyjore Sopot, si dhe certifikatat e pronësisë të fisit vreto dhe dashi, kjo është dhe arsyeja e pakësimit në sipërfaqe në raport me administrimin.

Ndërkohë që nga analiza rezulton sipas VKM nr.684/2020 kemi shtim në formën e përdorimit Pyll ngastra 25a e cila nga 15.38 ha sipas vkm është 28.22 ha pra një shtesë si rezultat i rilevimit dhe kostatimit në terren pasi ngastra 25b e cila ishte joproduktive, kishte sipërfaqe pyll dhe i kaloj ngastrës 25a.
Përsa më sipër është pasqyryar në tabelë, të dhënat në kolonën "**PMPK aktual**", gjithmonë duke theksuar heqja e sipërfqes së zonës së mbrojtur, pronës private, dhe Vkm korespondojnë me atë çfarë është gjetur aktualisht në terren dhe nuk ka të bëjë me objektivat ose propozimet e këtij plani mbarështimi për 10 vitet në vijim.
Nëpërmjet masave dhe objektivave të këtij plani mbarështimi, synohet që të kemi rritje të formave të qëverimit "trungishte, cungishte dhe kullotë", si dhe pakësim në kategorinë joproduktive.
Më shumë rreth këtyre ambicieve do të flasim në pikat në vijim, ku do të sqarohet çdo lloj objektivi që synon përmirësime në grumbujt pyjor të kësaj ekonomie.

III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela

Mbështetur në konfiguracionin e terrenit të ekonomisë pyjore Sopot, janë krijuar njësitë homogjene të cilat në respekt të konfiguracionit të terrenit formojnë ngastrat dhe nën/ngastrat. Ngastra ka në nocionin e saj konfiguracionin e terrenit i cili ka konture lehtësisht të dallueshme dhe të pa-shlyeshme me njësinë e kohës, të tilla si përrenj, kurrize, trupa ujore, rrugë auto, etj. Ndërsa n/ngastra përfaqëson njësinë më të vogël homogjene (forma e qeverimit, lloji, mosha, lartësia mesatare, diametri mesatar, etj).
Ngastrat pyjore nuk kanë asnjë ndryshim në konturet e tyre të jashtme, ndërsa nën-ngastrat kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme thuajse në masën mbi 80%, dhe kjo në sajë të ndryshimeve të theksuara që janë gjetur gjatë punës në terren.
Në total ekonomia ka 54 ngastra, numërtimi i tyre është ruajtur i njëjtë me atë të planit të mbarështrimit të mëparshëm. Ndërsa njësitë homogjene të krijuara brenda ngastrave të cilat janë nën-ngastrat janë 83. Në krahasim me planin e mëparshëm vihet re një ulje e ndjeshme e numrit të nën-ngastrave dhe kjo për shkak të ndryshimeve unike të vërejtura gjatë hartimit të këtij plani mbarështimi. Lista e të gjitha parcelave dhe n/parcelave me sipërfaqet përkatëse dhe përdorimin e tokës jepet në shtojcën 1.

IV. Përshkrimi i stacionit

IV.1 Klima

EP Sopot bën pjesë në zonën klimatike ne zonen klimaterike "mesdhetare malore", nenzona malore Juge-Lindje e cila karakterizohet nga dimra te ftohte por jo shume te ashper, ben pjese ne zonen fitoklimatike fagetum:

Ne pjesen malore mbizotëron një klime mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore arrin deri në 12.3 °C. Muaji më i ftohtë është janari dhe muaji më i nxehtë është gushti. Muaji më i lagësht është nëntori me reshje shiu mesatarisht 108 milimetra ndërsa sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin në 730-1000 milimetra.

-Temperaturat

Temperatura mesatare e ajrit lekundet nga kufijte 7-12 grade C, dhe ajo e muajve me te ftohte 2-4.5 grade C. Minimumet absolute zakonisht arrijne ne – 10 deri ne 13 gradec C.


Periudha me 7 grade C fillon mesatarisht nga mesi i muajit prill dhe mbaron nga fundi i tetorit ndersa ajo me temperature mesatare10 grade C fillon nga data 10-13 maj dhe mbaron nga dy javet e para te muajit tetor.

Ditet me akull variojne nga 60 -80 dite ne vit, megjidhese ditet me akull duke pasur parasysh ndryshimet klimatike global jane ne ulje.


Temperatura mesatare e muajit me te nxehte lekundet ndermjet 22-25 gradec C.

Ne tabelat e meposhteme jepen te dhenat per temperaturat me karakteristike per sejcilin muaj dhe stine, per stacionin e Pogradecit, keto te dhena jane te peraferta me ato te objektit ne fjale tabelen e meposhteme:


Temperaturat mesatare e maximumeve mujore



Maksimalet absolute te temperatures se ajrit



Maximumet absolute te temperature se ajrit



-Reshjet

Sasia vjetore e reshjeve lekundet rreth 700-800 mm ne vit, sasira keto te cilat jane me te paktat qe bihen ne vendin tone.


Kjo zone karakterizohet për sasira të pakta reshjesh, jo vetem në periudhen e vjeshtes (90 mm) por dhe ne periudhen e pranveres (prill-maj) ku bihen mesatarisht 100-150 mm. Pra sasite e reshjeve qe bihen gjatë periudhes se vegjetacionit jane te pakta.

Reshjet qe bihen ne kete zone ne pergjidhesi nuk kane karakter torrencial sic karakterizohen ne zonat e tjera te vendit tone.

Pamvarsisht nga reshjet mesatare vjetore ne pergjidhesi mjaft te ulta, edhe ne kete zone vihet re periudha te thata dhe te lageta. Periudha te thata ndodhin dhe ne muajt e dimrit me lageshti.

Sasite e reshjeve vjetore dhe siguria ne perqindje e reshjeve gjate gjysmes se ngrohte si dhe maksimalet e minimalet dhe raporti ndermjet tyre jepen ne tabela e meposhteme.

<u>Mesataret mujore dhe vjetore te reshjeve ne mmm</u>



Shtresa e pare e debores fillon zakonisht ne dekaden e pare te muajit dhjetor dhe vazhdon ne mesin e pare te muajit mars. Numuri i diteve sillet nga 50-60 dite, lartesia e shtreses se debores varion nga 30-40 cm.

Lageshtia relative mesatare per rreth eshte e larte ne dimer per shkak te aktivitetit ciklonear qe mbizoteron ne vendin tone si dhe per shkak te liqenit te Pogradecit qe sjell ajer te laget.

Por dhe gjate periudhes se veres lageshtia relative e ajrit sidomos ajo e ores 14 ne krahasim me zonat e tjera te vendit tone eshte me e madhe.

<u>-Ererat</u>

Persa i perket drejtimeve ne rethin predominojne ererat qc vijnc nga veriu e nga jugu te cilat kane shpejtesi mesatare vjetore 3-3.8m/sek. Me pak te vrulleshme jane ererat qe fryjne nga VL e L (0.9-1.7 m/sek), të dhënat për klimën në zonë janë marrë nga Climate Explorer (https://climexp.knmi.nl/data/ierod_pre_20.33E_40.05N_m.dat).

IV.2 Topografia dhe morfologjia

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e ngastrave te EP Sopot varion nga 1000 - 1800 m. Lartësia mesatare e përgjithshme e ekonomisë konsiderohet 1400 m mbi nivelin e detit.
Nëpërmjet programit të përpunimit të të dhënave Access database, rezultojne keto lartesi sipas funksioneve të dhëna:

Tab. Nr.6

Siperfaqja sipas lartesise mbi nivelin e detit dhe funksioneve kryesore

(perqindjet ne lidhje me totalin e siperfaqes sipas funksionit kryesor)

Ekonomia Pyjore : Sopot

Funksioni	0-200m			201-400m			401-600			601-800m			801-1000m			1001-1200m			1201-1400m			1401-1600m			1601-1800m			1801-2000m			>2000m			Total	
	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l	%	ha	l %
Prodhues	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	39.9		3.0	329.98		23.6	655.28		50.6	298.23		22.7	0		0.0	0		0.0	1313.19	
Mbrojtes	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	65.71		51.9	60.96		48.1	0		0.0	0		0.0	0		0.0	126.67	
TOTAL:	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	39.9		2.8	375.69		26.1	726.24		50.4	298.23		20.7	0		0.0	0		0.0	1439.85	

Ashtu sikurse mund të shihet edhe nga tabela, në katergorinë e lartësisë në lidhje me sipërfaqen dhe funksionin jepen si vijon:

- Nga 1001-1200 m, përfshihen 39.9 ha ose 2.8% e totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot.
- Nga 1200-1400 m, përfshihen 375.6 ha ose 26.1 % e totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot.
- Nga 1400-1600 m, përfshihen 726.04 ha ose 50.4% e totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot
- Ndërsa në kategorinë 1600-1800, përfshihen vetëm 298.2 ha ose 20.7 % e totalit të sipërfaqes pyjore në këtë ekonomi.

Morfologjia e terrenit, karakterizohet nga shpate të thyera, të gërryera nga rrjeti hidrik i cili aktivizohet gjatë periudhës me reshje. Drejtimi i shpatit mbi të cilën është vensur ekonomia ka një shtrirje thuajse uniforme në gjatësinë Veri – Jug dhe me kundrejtim kryesor atë dhe Jug Perëndimor, dhe perëndim.
Hartografisht, shpërndarja e lartësive në të gjithë ekonominë paraqitet në figurën nr. 4 më poshtë




Figura 4. Harta e lartësive mbi nivelin e detit të EP Sopot


Nëse i referohemi kundrejtimit kryesor të shpateve të EP Sopot, të dhëna të detajuara vijnë nga tabela në vijim:

Siperfaqja sipas funksioneve kryesore dhe kundrejtimeve

Kundrejtimi	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te funksionit	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : Sopot			
Prodhues			
Veri-Lindje	106.42	8.1	7.4
Lindje	252.84	19.3	17.6
Jug-Lindje	183.49	14.0	12.7
Jug	121.54	9.3	8.4
Jug-Peren	195.17	14.9	13.6
Perendim	171.63	13.1	11.9
Veri-Peren	242.81	18.5	16.9
Veri	39.29	3.0	2.7
Totali i funksionit :	1313.19	100.0	91.2
Mbrojtes			
Lindje	28.22	22.3	2.0
Perendim	22.22	17.5	1.5
Veri-Peren	76.23	60.2	5.3
Totali i funksionit :	126.67	100.0	8.8
TOTALI I EKONOMISE:	**1439.86**		**100.0**

Ashtu si më sipër theksuam, kundrejtimi kryesor i shpateve të ekonomisë është ai Jug-Perëndimor i ndjekur nga ai Perëndimor dhe veri-perëndimor të cilët dominojnë përkatësisht me afro 42.5 % të totalit të sipërfaqes pyjore të EP Sopot.

Më pas vjen kundfrejtimi Lindje me 252 Ha, ose me 19.3 % të totalit të sipërfaqes pyjore të ekonomisë. Më poshtë po ju paraqesim hartën e kundrejtimeve.


20°20'E
20°22'E
20°24'E
N
Harta e Kundërdrejtimit
EP Sopot, Bashkia Prrenjas
41°4'N
41°2'N
41°N
Legjendë
Ngastrat
Nenngastrat
Kufiri i Ekonomisë
Kundërdrejtimi
Verilindje
Lindje
Juglindje
Jug
Jugperendim
Perendim
Veriperendim
Veri
Scale: 1:15 000
0
0,42
0,85
1,7 Kilometers

Pjerësia e shpateve varion nga 0 deri 70%, por zotëron kategoria e pjerrësisë nga 11-40%, duke i konsideruar pyjet e EP Sopot si të vendosua në shpate relativisht të pjerrëta. Të dhëna më të detajuara mbi pjerrësinë dhe shpërndarja e saj në ekonomi jepet më poshtë:

Siperfaqja sipas pjerresise dhe funksioneve kryesore

Funksioni		Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te pjerresise	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : Sopot				
0 - 10%				
Prodhues		26.4	100.0	1.8
	Total :	26.4		1.8
11 - 40%				
Prodhues		950.34	100.0	66.0
	Total :	950.34		66.0
41 - 70%				
Prodhues		336.45	72.6	23.4
Mbrojtes		126.67	27.4	8.8
	Total :	463.12		32.2
TOTALI I EKONOMISE :		**1439.86**		

Ashtu si më sipër theksuam, pyjet e kësaj ekonomie janë vendosur në shpatet në kategorinë e pjerrësisë nga 11-40%, të cilët dominojnë në krahasim me kategoritë e tjera, përkatësisht me 66% të totalit të ekonomisë, ose e thënë ndryshe, 950.34 ha me pyje të kësaj ekonomie janë të vendosura në shpate më 41-70% pjerrësi ose 463.1 ha ose 32.2 % të sipërfaqes totale të ekonomisë pyjore, dhe 26.4 ha ose 1.8 % në pjerrësinë 0.-10%.

Hartografiksht, konceptimi i pjerrësisë në ekonomi jepët në figurën nr. 5, më poshtë.




Figura nr. 5 Harta e pjerrësive të EP Sopot

IV.3 Gjeologjia

Formacionet gjeologjike te EP Sopot i përkasin formacioneve Gëlqeror në 42.2% të territorit dhe Flyshe 41.7 % ose 1208.78 ha ndaj sipërfaqes së përgjithshme të ekonomisë dhe pjesa tjetër prej 16 % karakterizohet nga shkëmbinjë ultrabazike ose 231.08 ha ndaj sipërfaqes së përgjithshme të ekonomisë Sopot. Për të parë një shpërndarje më të detajuar të tipeve të litologjisë në EP Sopot, harta më poshtë si dhe treguesit nga rezultat e acces database.

Siperfaqja sipas gjeologjise dhe funksioneve kryesore

Funksioni	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te gjeologjise	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia Sopot			
Flyshe			
Prodhues	578.41	96.3	40.2
Mbrojtes	22.22	3.7	1.5
Total :	600.63		41.7
Gelqeror			
Prodhues	579.93	95.4	40.3
Mbrojtes	28.22	4.6	2.0
Total :	608.15		42.2
Ultrabazik			
Prodhues	154.85	67.0	10.8
Mbrojtes	76.23	33.0	5.3
Total :	231.08		16.0
TOTALI I EKONOMISE :	**1439.86**		




Figura Nr. 6. Harta litologjike e EP Sopot

IV.4 Tokat

Shtresa tokësore (dheu) është shumë e ndryshme në drejtim të cilësive morfologjike, kimike, fizike dhe vetitë mineralogjike, si edhe përmbajtjes së gurëve. Kombinimi i relievit, klimës, bimësisë dhe përbërjes së shkëmbit amnor krijon toka të veçanta me cilësi të veçanta, ku mikroorganizmat e gjalla luajnë një rol kryesor në proceset pedogjenetike, veçanërisht në qarkullimin e lëndës organike dhe energjisë. Në kontekstin e EP Sopot, **relievi është një faktor kyç për të kuptuar diversitetin**, pasi ndikon direkt tek klima dhe proceset fiziko-kimike dhe biologjike të tokë formimit, në zhvendosjen e elementëve ushqyes dhe produkteve dhe në lëvizjen e ujrave dhe regjimet ujore. Në këto kushte, **relievi është themelor për të vlerësuar kapacitetin e rritjes dhe ekuilibrin ujor të tokës**. Për shembull, në shpatet e pjerrëta infiltrohet më pak ujë se sa në tokat e sheshta. Në rastin e parë uji kalon në sipërfaqe duke shkaktuar erozion dhe varfërimin e elementëve ushqyes të tokës. Kjo është veçanërisht e dukshme kur toka është e zhveshur nga bimësia, e shqetësuar nga faktorë të ndryshëm siç janë mbishfrytëzimi në grumbujt pyjorë, si edhe shkelja nga kafshët në toka të pastrukturuara. **Prandaj, aktivitetet njerëzore në ekonominë pyjore kanë një ndikim aktiv në cilësinë dhe funksionalitetin e tokës.**

Duke iu referuar hartës pedologjike të Shqipërisë, dhe klasifikimit të FAO-ËB të tipeve të tokave, tokat dominues në EP Sopot jane: tokat e murrme pyjore dhe livadhore malore.
Tokat e murrme pyjore zënë pjesën kryesore të ekonomisë pyjore. Ato zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes dhe jane te vendosur kryesisht mbi shkembinj magmatikë dhe metamorfike (ultrabazikë, gëlqeror, flyshe), tokat e murrme shtrihen në 1439.86 Ha pyje te ekonomisë Sopot ose në 96 % të sipërfaqes totale të tyre. Ndërsa tokat livadhore malore kafe shtrihen në 78.9 Ha kullota të EP Sopot ose në 5 % të totalit të territorit me mbulesë pyjore. Tabela më poshtë jep të dhëna nga programi Access DB.

Siperfaqja sipas tipit te tokes dhe funksioneve kryesore

Funksioni	Siperfaqja (ha)	% ndaj totalit te tipit te tokes	% ndaj totalit te siperfaqes pyjore
Ekonomia : Sopot			
murr.pyjore			
Prodhues	1313.19	91.2	91.2
Mbrojtes	126.67	8.8	8.8
Total :	1439.86		100.0
TOTALI I EKONOMISE :	1439.86		

IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

EP Sopot, ka një rrjet të dendur hidroligjik me burime dhe përrnjë, por aktiv vetëm në pjesën e vitit me reshje. Megjithatë burimet në brendësi të territorit të ekonomisë jo vetëm nuk mungojnë por janë të larmishme, rrjeti hidrik nuk shkakton probleme me erozionin. Shpatet e përrenjve janë tashmë të veshura me bimësi, presioni i kullotjes ka rënë dhe erozioni në të gjithë ekonominë pyjore Sopot konsiderohet jo i pranishëm. Burimet qe ndodhen te shperndara ne ekonomi perdoren per shuarjen e zjarreve ne pyje. Gjate 10 vjecarit te fundit nuk ka patur permbytje nga reshjet, për të krijuar një ide mbi rrjetin hidrologjik që rrethon zonën, po paraqesim hatren e mëposhtme.




Figura nr. 6 Rrjeti hidrik i zones së studimit

IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore

Sikurse përshkruhet në pjesët e mësipërme, erozioni nuk perben problem per ekonominë pyjore, por mbrojtja e tokës duhet te përfaqësoje një interes thelbësor. Dihet se erozioni pakëson sasinë e humusit organik dhe kufizon vetitë fizike dhe mekanike te tokes, duke çuar në një rënie të përgjithshme të pjellorisë sësajdhe duke ndikuar ne rritjen vjetore te pyjeve dhe kullotave. Faktikisht, reshjet e befta të shiut, shpesh në sasi të mëdha dhe me intensitet të lartë, shtrirja e formacioneve të buta sedimentare lehtësisht të gërryeshme dhe mbikullotja dhe degradimi i pyjeve gjenerojnë erozion aktiv dhe të thellë. Nuk ka te dhena ne lidhje me sasine e elementëve ushqyes qe largohen nga erozioni në këtë ekonomi pyjore.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rolit vendimtar tëpjerrësisë në këtë fenomen. Shpatet me pjerrësi më pak se 5% janë më pak të rrezikuara nga erozioni, megjithatë për shpatet me pjerrësi 1-10% rreziku është i vogël për shfaqjen e dukurisë së erozionit por bëhet më i lartë kur pjerrësia është mbi 25%, EP Sopot nuk mund të konsiderohet me rrezik të lartë erozioni.

Megjithatë për sa më sipër theksuam rreziku erozionit në EP Sopot është momentalisht zero. Kjo për faktin nga përbërja gjeologjike si dhe mbulesa me vegjetacion pyjor luajnë një rol vendimtar në uljen e shpejtësisë së rrjedhës dhe si rrjedhojë dobësimin e forcave gërryese nga uji.

.

Erozioni

Funksioni	0% ha	I	%	1-10% ha	I	%	11-25% ha	I	%	26-50% ha	I	%	51-75% ha	I	%	76-100% ha	I	%	Total ha
Siperfaqesor																			
Prodhues	0		0.0	1032.49		89.1	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	1032.49
Mbrojtes	0		0.0	126.67		10.9	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	126.67
TOTAL:	0		0.0	1159.16		100.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	1159.16
Ne thellesi																			
Prodhues	0		0.0	113.11		53.5	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	113.11
Mbrojtes	0		0.0	98.45		46.5	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	98.45
TOTAL:	0		0.0	211.56		100.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	0		0.0	211.56

	Total
Total	
Prodhues	1313.19
Mbrojtes	126.67
TOTAL:	1439.85

IV.7 Rrëshqitjet e tokës

Formacionet pyjore si dhe konfiguracioni i terrenit shoqëruar edhe me litologjinë dhe shkëmbin amnor, bëjnë që në ekonominë pyjore Sopot, rrëshqitjet e tokës të mos eksistojnë ose të jenë në shkallën më të vogël të mundshme.

V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti

V.1 Brezat bio-klimatikë

Ekonomi pyjore Sopot bën pjesë ne zonen fitoklimatike te ahut (fagetum) nenzona e ftohte dhe ne brezin bioklimatik, brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare.

Ky brez shtrihet mbi brezin e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare deri në lartësinë 850-2000m, Zona në studim mbizotërohet nga vegjetacioni i ahut, një grupim bimor i cili përfaqëson pyje gjethegjëra të përhapura përgjithësisht në brezin para malor dhe malor. Ky shoqërim bimor gjendet më shpesh në toka të murrme pyjore. Speciet më karakteristike të këtij shoqërimi janë shparthi ahu, bredhi, panja e malit të cilët janë edifikatorë të fitocenozës dhe lloje dominante njëkohësisht, të cilët dallohen për shkallën e lartë të sasi-mbulesës e dominancës, kështu që edhe flora e tyre është më pak e pasur. Përbërja floristike ndryshon sipas tipit të pyllit, përbërjes së tokës, lartësisë, kundërdrejtimit, shkallës së ndriçimit etj. Por një numër i konsiderueshem speciesh janë të përbashkëta. Sipërfaqja në studim mbulohet në 1439.9 ha të saj nga llojet ahu, bredhi i bardhë, Pisha e zezë, shoqëruar ne pjesen e poshteme ne nen/zonen e ngrohte te ahut, me dëllinjën se kuqe Juniperus oxycedrus dhe me përfaqësim më të rrallë ato të shkozës Carpinus orientalis Mill, frashërit Fraxinus ornus L, panjës Acer campestre, dhe drizës Paliurus aculeatus etj. Shoqërimi shfaqet përgjithësisht i dëmtuar me pjesë të caktuara në stadin e filizërise. Llojet e tjera që takohen në hapësirat e hapura të zonës së studimit janë manaferra Rubus ulmifolius Schott, fiku i egër Ficus carica, trëndafili i egër Rosa canina L, driza Paliurus spina-christi Mil, murrizi Crataegus monogyna. Për nga përbërja floristike e katit të florës barishtore përfaqësohet nga llojet: Potentilla erecta, Lychnis coronaria L, Buglossoides purpurocaerulea (L.) I.M.Jhons., Clinopodium vulgare L, Brachypodium pinnatum (L.)P.B., Lathyrus niger (L.)Berhn L. Stachys germanica L, Dactylis glomerata L, të cilat janë specie karakteristike të aleancës se ahut me Quercion frainettocerris por të përhapura janë edhe llojet e Achillea millefolium L., Bellis perennis L, Ajuga reptans, Geranium robertianum.

Ekorajoni i pyjeve gjethe rënëse i lire është përcaktuar nga ËËF dhe Harta Dixhitale e Rajoneve Ekologjike Evropiane nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.

V.2 Pyjet dhe kullotat

Si më sipër theksuam, EP Sopot aktualisht përfaqësohet vetëm nga fondi pyjor dhe në të gjithë sipërfaqen e saj por ka sipërfaqe kullosore prej 78.9 ha kullota alpine Ballkanike, kullotë në brëndësi të pyllit. Periudha e kullotjes eshte vetem gjate veres. Per shkak te numurit te krereve te blegtorisë dhe perdorimit kolektiv te saj ka nje rendim te kullotes. Shfytezimi behet duke u dhene liri kopeve te dheneve te gjejne ushqim sipas deshires se tyre ne te gjithe siperfaqen dhe per gjithe sezionin kullosor.

Gjithsesi, në tabelën më poshtë do paraqesim format e përdorimit të tokës që ndeshen në EP Sopot.

Sip. totale (ha)	Pyje (ha)	Pyje (%)	Kullota (ha)	Kullota (%)	Sip.Bimësi Pyjore (ha)	Sip.Bimësi Pyjore (%)	Tjetër (ha)	Tjetër (%)
1571.1	1439.9	91.6	78.9	5.02	15.1	1	37.2	2.36

Tek kategoria "Tjetër" në tabelën më sipër, përfshihen kategoritë e përdorimit "Sipërfaqet joproduktive".

V.3 Tipet pyjore

Tipet e pyjeve në EP Sopot, të diferencuara sipas funksioneve përkatëse të tyre, jepen në tabelën më poshtë:

Tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes

Tipi i Grumbullit	Total		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore : Sopot										
Pyje bredhi te bardhe me ah	31.73	2.2	31.73	2.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me ah	1054.8	73.3	1004.4	69.8	50.44	3.5	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me bredh te bardhe	187.41	13.0	174.52	12.1	12.89	0.9	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me pishe te zeze	43.42	3.0	43.42	3.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me ah	88.44	6.1	25.1	1.7	63.34	4.4	0	0.0	0	0.0
Pyje me shpardh	34.05	2.4	34.05	2.4	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE:	**1439.86**	100.0	1313.2	91.2	126.67	8.8	0	0.0	0	0.0

"Pyje me ah" - Ashtu sikurse shikohet edhe nga tabela, tipi i pyllit "Pyje me ah" diferencohet nga tipet e tjera, duke u renditur i pari për nga sipërfaqja që zë, duke lënë të kuptohet se EP Sopot është e influencuar dhe bën pjesë në zonën ahut. Si tip bën pjesë në"Zonën fitoklimatike të ahut

Fagetum". Ai zë 1054.8 ha nga fondi i përgjithshëm i kësaj ekonomie ose 73.3 % të totalit të sipërfaqes pyjore të saj. Eshte dru me vlera mjaft te mira, shkon deri ne 30-40 m lartesi dhe diameter 1-1.5 m. Eshte bime monoike. Ne moshe te re ka nje rritje te ngadalte deri ne 10 cm ne vit nga mosha 30-40 vjecare ka nje rritje deri ne 80cm lartesi. Frutifikon ne moshet 70-80 vjecare me periodicitet te bollshem 4-6 vjecar. Druri ka ngjyre te bardhe te kuqerremte, me rreze palcore te dallueshme, i forte, i rende, i cashem, mesatarisht elastic. Ne vendin tone eshte lloji me i perhapur dhe me i rendesishem ne fondin pyjor te shqiperise. Ze nje vend te rendesishem ne industrine e perpunimit te drurit per vlerat e tija te padiskutushme.
Ne ekonomi ne pergjithësiesi takohet ne pjesen veri-perendimore me bimesi grathatelin kurse ne pjesen e poshteme me Fragaria vescen, Vacinum Mytifillus, Laburnum Alpinum.

"Pyje Pishë të zezë me ah", eshte tipi tjetër i cili renditet i treti për nga sipërfaqja e konsiderueshme që zë në ekonomi me rreth 88.4 ha ose 6.1 % të totalit të ekonomisë në zerin pyje. Eshte lloj shume i rendesishem i ekonomise, lloj qe frutifikon ne moshen 20-25 vjecare ne kushte te mira. Eshte lloj dritedashes ka kerkesa te pakta ndaj tokes dhe klimes, rreziston karshi thatesires dhe ngricave e ererave. Pisha eshte nje lloj qe ka perdorim te madh ne industri per vlerat qe ka druri i saja dhe perdorim te madh ka dhe per rreshiren.

"Pyje ahu me bredh të bardhë", eshte tipi tjetër i cili renditet i dyti për nga sipërfaqja e konsiderueshme që zë në ekonomi me rreth 187.41 ha ose 13 % të totalit të ekonomisë në zerin pyje. Ky tip grumbulli i përzier ku përqindjen më të madhe e ka lloji ah, bredhi i bardhë ka një tregues në zhvillimin dhe ripërtëritjen duke shikuar shpërndarjen e filizërisë.

Bredhi i bardhë (Abies alba Mill) Eshtë dru i kategorisë I. Trupi rritet i drejte cilindrik dhe arrinë deri 50 m lartësi, deri 2 m diametër. Rrënja është boshtore dhe më vonë merr një zhvillim të madh anësore. Lëvorja ngjyrë hiri me luspa. Kurora e drurëve është konike dendur. Dëgezat janë të përhime në të verdhë. Sythet janë në trajtë vezake. Gjethet janë halë vijëzake me majë, të buta deri 3cm të gjata, 2-3 mm të gjëra, në pjesën e sipërme me shkëlqim, në pjesen e poshtme kanë dy vija të bardha. Lulet janë njësëksore monoike. Lulet mashkullore janë në formë gathësh te gjatë me ngjyre si të verdhe, dalin ne faqen e poshtme të degeve. Lulet femrore kane formë cilindrike dalin në majen e degeve, çelin në marsprill. Fruti është një boçe me gjatësi 10-15 cm dhe trashësi 3-5 cm; Farat është 7-9 mm e madhe me tre kënde, piqen në periudhen shtator-tetor. Frutifikon çdo 2-3 vite. Fuqia mbirëse deri 50%. Shumëzimi bëhet me farë. Rritja është ngadalshme në 1-15 vitet e para pastaj ka rritje të madhe dhe jeton 150-200 vjet, ka raste dhe më shumë. Druri ka blanë të bardhë butë, çahet me lehtësi, myja nuk ka ngjyrë të veçantë, është i lehtë, *Kërkesat ekologjike dhe përdorimi*: Rritet në klimë mesdhetare kontinentale, pëlqen tokat e murrëme pyjore të thella, me përberje subargjilore të mesme, të freskëta, mjediset në hije dhe me pak lagështi atmosferike. Eshtë dru hijedashes, filizat e rinjë rritën dhe zhvillohen shumë vite ne hije, pasi aty gjejnë kushte dhe mbrojtje nga ngricat dhe rrezatimi diellor. Zhvillohet mirë i përzier me ah. Ka vlerë përdorimi si një element i rëndësishëm i biodiversitetit me pyjet që formon; si 11 dru për zbukurim në parqet urban, ka vlerë druri për përpunim. Duhet dhe mund të

përdoret më shumë duke e mbjellur. *Ai është lloj në rrezik zhdukje dhe është me statusin "lloj i mbrojtur"*

"Pyje me Shparth", ky tip grumbulli përfshihet në" nenzonen e ahut zona e dushqeve" renditet i VI për nga sipërfaqja rreth 34.05 ha ose 2.4 % të sipërfaqes së ekonomisë. ***Shparthi (Quercus frainetto Ten.)*** Druri i klases I, arrinë 30-40 m i lartë me trup të drejte, i ngjashem me atë të bungës. Levorja formon nje kore te holle ne forme luspash. Kurora e gjere, e pasur me gjethe. Bisqe te trasha, me push me lenticele, me sythe shume te medhenj, vezake, (sythet i ka me te medhenj se te cdo dushku tjeter). Gjethet bien vone ne vjeshte, te gjata rreth 15-18 cm, te gjera 6-12 cm, me gjinj te thelle e pothuaj paralele, perfundi me vesheza, perposh me push. Lulezon ne Prill-Maj dhe pjek frutat ne Tetor. Lendet i ka të trasha, pothuaj pa bisht qendrojne 2-8 se bashku. Gishtja (kupa) mbulon vetem 1/3 e gjatesisë se lendës. Rritja me e ngadalte se ajo e bunges, e qarrit dhe e rrenjes. Jeton me pak se bunga. Druja ka cilesi te mire, të ngjashme me te bunges por ka blane me te gjere, e pershtatëshme per mobilje, për derrasa, per vegla bujqesore, etj. Tek ne ndodhet i perhapur ne zonen e dafines dhe te geshtenjes
Ky tip, së bashku me tllojet e tjera shoqëruese përfshirë nenpylli si: mëlleza, frashëri, dëllinja e kuqe, shfaqen në formën e qeverimit cungishte në këtë ekonomi.

V.4 Tipet e kullotave

Gjatë inventarizmit të kryer, EP Sopot ka në konturin e saj sipërfaqe kullosore "Kullota apline ballkanike", sipërfaqe kullote brenda pyllit, afro 78.9 ha, periudha e kullotjes eshte vetem gjate veres. Per shkak te numurit te krereve te bagetise dhe perdorimit kolektiv te saj ka nje rendiment te kullotes. Shfytezimi behet duke u dhene liri kopeve te dheneve te gjejne ushqim sipas deshires se tyre ne te gjithe siperfaqen dhe per gjithe sezionin kullosor.Po te bejme analogji me pyllin kjo do te thote qe te shfrytezojme kudo dhe kurdohere ne pika te ndryshme te pyllit, duke marre parasysh mundesine e shfrytezimit te pyllit ciklin dhe renditjen ne hapesire te prerjeve. Ky shfrytezim i lire degradon kulloten, pasi bagetia vrapon vetem pas barit te mire duke lene pjese e tjera pa kullotur, *rekomandojme normalisht qe numuri i cikleve te jete 3 ne nje sezion nga 40 dite te secilit per te mundesuar ripertritjen e barit.*


V.5 Tipet e vegjetacionit potencial

Më parë se të fillojmë të shtjellojmë tipet e vegjetacionit potencial që gjenden në ekonominë pyjore Sopot, duhet të theksojmë se i gjithë vegjetacioni aktual, ***është në potencialet që ofron stacioni, pavarësisht gjendjes së tij.***
Gjithsesi në tabelën në vijim jepen të dhënat që vijnë nga programi i përpunimit të dhënave "Access DB", të cilat në fakt nuk përputhen me vegjetacion aktual që ka stacioni.

Tipet e vegjetacionit potencial sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes pyjore

Tipi i vegjetacionit	Total		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore : Sopot										
Formacion pyjor ahu - bredhi i bardhe	12.89	0.9	0	0.0	12.89	0.9	0	0.0	0	0.0
Formacion ahishtesh	1373.1	95.4	1279.1	88.8	93.93	6.5	0	0.0	0	0.0
Formacione pyjore te Pinus nigra Arnold,subsp.Pallasiana	19.85	1.4	0	0.0	19.85	1.4	0	0.0	0	0.0
Formacion druresh te shparthit	34.05	2.4	34.05	2.4	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE :	**1439.86**	100.0	1313.2	91.2	126.67	8.8	0	0.0	0	0.0

Ne Total:



Ashtu sic mund të shikohet nga të dhënat e tabelës më sipër, ***Formacioni Pyjor Ahishtesh (Fagus Sylvatica L)***, dominon me 95.4% totalin e ekonomisë ose me 1373.1 ha, fondin pyjor prej 1439.86 ha.

Të gjitha tipet e pyjeve që formojnë këtë tip të vegjetacioni, është në potencialin që ka stacioni. Në objektivat 10 vjeçarë të këtij plani, është planifikuar të ndërhyhet për ti shndërruar ato në grumbuj të cilët do të mund të shfrytëzojnë potencialet e stacionit. Thuajse 95% e këtij tipi vegjetacioni potencial, ndodhet aktualisht në formën e qeverimit Trungishte duke qënë specie kryesore nga pikpamja mbizotëruese dhe ekonomike.

Formacioni tjetër i vegjetacionit potencial që karakterizon këtë ekonomi pyjore është ai i "**Formacione pyjore të Pinus nigra Arnold.subsp.Pallasiana"**, gjithashtu gjenden në konturin e EP Sopot, në një sipërfaqe prej 19.85 ha, ose 1.4 % të fondit pyjor të saj. Është formacion natyral i zotëruar nga Pisha e zezë, i vendosur kryesisht në shpate me kundrejtim Jugor, Vegjeton normalisht dhe shfrytëzon potencialin e stacionit.

Tipet e pjera të vegjetacioneve të tjera të mbetura nga tabela më sipër, nuk do të përshkruhen në këtë pikë, për sipërfaqen e vogël dhe peshën që zënënë këtë EP.

V.6 Prania e vlerave të larta mbrojtëse

Nga verifikimet të kryera gjatë inventarizmit të grumbullit nëpërmjet sipërfaqeve provë, vlen të thksohet se mbareshtimi i qendrushem i pyjeve, mbrojtja e natyres, pejsazhet dhe elementet kulturale ne njesine e mbareshtimit te pyjeve dhe kullotave jane nje istrument per permiresimin e territorit me pasoja te rendesishme per ruajtjen e ketyre vlerave si dhe ndikimet pntenciale, social ekonomike si dhe identifikimi ketyre kryhet nepermjet vrojtimeve te ndryshme.
Vlerat qe duhen ruajtur konkretisht jane vleresuar parcela rezervat me pish te zeze, bredh i bardhe. Zonat me perqendrim te rendesishem te biodiversitetit, specieve endemike dhe te kercenuara, ku ka drure te rralle panje fletgjere, Frasheri i zi, melleza, ajdësi i alpeve si dhe një nga speciet e kercenuara aty eshte vendosur ariu i murrme, riqebulli.

V.7 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

Duke iu referuar të dhënave në përshkrimin parcelar, mund të përcaktohet statusi aktual i elementëve ekzistues të biodiversitetit dhe lloje të kërcënimeve. Kështu, **një rrezik specifik për biodiversitetin u vlerësua të jetë në 31% të sipërfaqes së përgjithshme të EP që përfaqëson një nivel jo te lartë**, megjithatë konsiderohet si rezik evident dhe është ai i kanosjes nga zjarri.

Në planifkimin e masave në objektivat 10 vjeçar të këtij plani, duke mbajtur parasysh këtë rrisk, janë planifikuar ndërhyrje të cilat parandalojnë zjarret, por edhe në rastet e rënies së tyre, vënia nën kontroll dhe dëmi i shkaktuar do të jetë më i vogël në sajë të ndërhyrjeve të propozuara.

V.8 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore

Me përjashtim të formacionit pyjor me pishë të zezë, në konturin e EP Sopot, nuk është evidentuar ndonjë zonë apo vend i cili mund të ofrojendonjë mundësi për të kryer aktivitete didaktikë dhe kërkimore. Grumbulli pyjor me pishë të zezë por edhe prania e Bredhit të bardhë i cili shfaqet në formën e species së shpërndare, duke qenë se është brenda arealit të tij dhe për më shumë akoma në gjendje natyrale në këtë ekonomi.

VI. Rrugët dhe infrastruktura

VI.1 Rrugët pyjore

Konfiguracioni i terreni i EP Sopot si dhe pasuritë natyrore që ajo ofron mundësojnë praninë e rrjetit rrugor por është i dëmtuar. Për më shuma akoma, shtrirja e ekonomisë në formë gjatësore përgjatë një shpati, e lehtëson punën për të patur rrjet rrugur në shërbim të saj.
Gjithashtu, njërol të veçantë në këtë drejtim, luajnë edhe prania e fshatrave në afërsi të cilët futen në ekonomi duke rritur në mënyrë të ndjeshme koeficientin e mbrritshmërisë për ekonominë pyjore Sopot.

Si rrjedhim shprehemi se ekonomia pyjore Sopot ka një koeficient mbritshmërie të kënaqshëm me rreth 38 ml/ha. Ky koeficient i mundëson ekonomisë shërbime shumë-funksionale dhe permanente, të tilla si nevojat për ndërhyrje silvoteknike apo edhe në rast emergjencash të tilla si zjarret, etj.

VI.2 Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës

EP Sopot, në sajë të pozicionimit të saj afër qendrave të banuara dhe me rrugëlidhje të kryqëzuara, po gjen përherë e më shumë mundësi për të zhvilluar veprimtari ekonomike që lidhem me agro-turizmin dhe hiking, të cilat gërshetohen me natyrën e bukur që ofrojnë pyjet dhe peisazhet e eknomisë.

Ka struktura të tjera të vecanta që mund të lidhen me përdorimet e tokës në këtë ekonomi, për vetë faktin që përdorimi i tokës i formës kullotë është prezentë, dhe strukturat që lidhen me të janë eksistente. Gjatë punës në terren, janë verejtur struktura eksperimentale që po studiojnë mundësinë për të vendosur në kulmet c kurrizit të ekonomisë turbina eolike. Nëse studimet paraprake e konfirmojnë një gjë të tillë atëherë aspektet kontraktuale do të sillnin fitime të konsiderueshme për bashkine përrenjas, të cilat do të mund të përfitohen përmes kontratave dhe dhënies me qira të territorit të kësaj EP.

VII. Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat

VII.1 Analizimi i të dhënave për pyjet

VII.1.1 Analizimi i tipeve pyjore

Ashtu si dhe më sipër theksuam në EP Sopot dallohen 6 tipe të pyjeve në EP Sopot. Një larmi e madhe e tyre shpjegohet me pozicionin gjeografik të ekonomisë.

Tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes

Tipi i Grumbullit	Total		Funksioni							
			Prodhues		Mbrojtes		Rekreacion		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore : Sopot										
Pyje bredhi te bardhe me ah	31.73	2.2	31.73	2.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me ah	1054.8	73.3	1004.4	69.8	50.44	3.5	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me bredh te bardhe	187.41	13.0	174.52	12.1	12.89	0.9	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me pishe te zeze	43.42	3.0	43.42	3.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me ah	88.44	6.1	25.1	1.7	63.34	4.4	0	0.0	0	0.0
Pyje me shpardh	34.05	2.4	34.05	2.4	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE:	**1439.86**	**100.0**	**1313.2**	**91.2**	**126.67**	**8.8**	**0**	**0.0**	**0**	**0.0**

Për të dhënë një panoramë më të qartë, në lidhje me prezencën e llojeve, kushtet stacionale dhe karakteristika të tjera të grumbullit për secilin tip, më poshtë po vijojmë analizimin e tyre.

Pyje me ah, ky tip grumbulli zë 1054.8 ha në fondin pyjor prej 1439.86 ha të EP Sopot ose 73.3 % të saj. Në këtë ekonomi përhapet në kundrejtimin veri-lindor dhe jugor. Ka zhvillim të mirë dhe zotëron potencialin që ofron stacioni i ekonomisë. Përben specien kryesore të fondit të ekonomisë pyjore Sopot.

Sa i takon moshës, ky grumbull takohet në ekonomi në 5 klasa moshe:

Atë të klasës së moshës së II (21-40 vjeç) III (41-60), IV (61-80), V (81-100), dhe në klasën e IX (161-180 vjeç).

Të dhëna më të detajuara në tabelat në vijim.

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Trungishte)

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									
Trung	Pyje me ah								
	21-40vjec	285.2	7.88	0.64	629	38.52	10988.3	3.23	922.18
	41-60vjec	206.9	8.98	0.47	563	58.35	12069.7	3.67	759.75
	61-80vjec	273.2	12.46	0.49	772	88.93	24293.2	3.69	1009.27
	81-100vjec	50.4	12.68	0.34	374	94.20	4751.5	2.40	120.94
	161-180vjec	226.2	18.02	0.31	305	141.27	31954.0	0.00	0.74
Totali i shtreses:		1054.8	11.58	0.48	564	79.69	84056.7	2.67	2812.88

Ashtu sikurse mund të shikohet edhe nga tabela më sipër, ky tip grumbulli përfaqësohet nga 5 klasa moshe, përkatësisht me sipërfaqe 1054.8 Grumbujt vegjetojnë nën një kurorëdendësi prej 0,8 deri në 0,9 dhe ofrojnë një volum mesatar prej 79.69 m^3/ ha, me një total të përgjithshëm të kësaj shtrese prej 84056.7 m^3. Përputhet 100% me potencialin që ofron stacioni duke patur një shtesë natyrore prej 11.58 m^3/ha. I gjithë grumbulli është në klasën e IV dhe V të prodhimit.

Pyje Bredhi të bardhë me ah, ky tip grumbulli pyjor shtrihet në një sipërfaqe prej afro 31.7 ha. Kryesohet nga lloji hijedashës bredhi i bardhe dhe ahu. Vegjeton duke shfrytëzuar potencialin e stacionit. Në objektivat e këtij plani mbarështimi është planifikuar që e gjitha ky tip grumbulli të mbetet nën suksesionin natyror, të ndiqet ecuria e grumbullit, të mbrohet nga kullotja dhe prerjet e paligjshme. Forma e qeverimit në 100% të këtij tipi grumbulli mbetet ajo Trungishte klasa e moshës ajo e IV me volum mesatar 73.44 m^3/ha dhe volum të përgjithshëm 2330.2 m^3.

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Trungishte)

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									
Trung	Pyje bredhi te bardhe me ah								
	61-80vjec	31.7	8.36	0.23	339	73.44	2330.2	1.96	62.05
Totali i shtreses:		31.7	8.36	0.23	339	73.44	2330.2	1.96	62.05

Pyje ahu me bredh të bardhë, i cili zë një sipërfaqae prej 187.4 ha ose afërsisht 13% të totalit të sipërfaqës të mbuluar me pyje prej 1439.86 ha. Lloji kryesor dominues i këtij tipi është ahu dhe vend-vende gjendet dhe bredhi i bardhe si specie e shpërndare.

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Trungishte)

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									
Trung	Pyje ahu me bredh te bardhe								
	41-60vjec	17.1	12.83	0.55	812	88.12	1502.4	4.87	83.02
	61-80vjec	144.6	14.49	0.58	767	100.03	14457.8	4.34	627.34
	141-160vjec	12.9	58.25	1.18	750	609.59	7857.6	1.58	20.38
	161-180vjec	12.8	29.95	0.55	362	304.02	3900.6	0.35	4.55
Totali i shtreses:		187.4	18.41	0.62	742	147.96	27728.4	3.92	735.29

Klasa e moshës në të cilën gjendet ky tip grumbulli është III, IV, VIII dhe e IX të cilat zënë përkatësisht 187.4 ha. Forma e qeverimit të këtij tipi grumbulli është "Trungishte". Ka një kurorëdendësi mesatare si shtresë prej 0.7-0.8. Stoku i volumit në këmbë llogaritet prej 29698 m^3 me një volum mesatar 147.9 m^3/ha. Rritje mesatare vjetore si total shtrese shkon në 3.92 m^3/ha/vit.

Karakterizohet nga një pyll shumë i dendur i përfaqësuer kryesisht nga ahu por me pjesëmarrje edhe të Bredhi të bardhe. Për të intensifikuar rritjen dhe për ta mbrojtur grumbullin nga zjarri janë planifikuar në objektivat e këtij plani mbarështimi, prerje sanitare përmirsime. Shfrytëzon

plotësisht potencialin dhe grumbulli po shkon drejt krijimi të një areali natyror nëpërmjet ripërtëritjes nën masiv, në rrugë natyrale me farë.

Pyje ahu me pishë të zezë. Grumbullin e zotëron ahu por përzihet edhe me pishë të zezë. Forma e qeverimit që karakterizon këtë tip grumbulli është ajo e trungishtes. Vegjeton mirë dhe shfrytëzon potencialin e stacionit, kurorëdendësia e grumbullit mesatarisht varion nga 0.6-0.8.

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Trungishte)

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi		rritja vij	
						m3/ha	Totm3	m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									
Trung	Pyje ahu me pishe te zeze								
	61-80vjec	43.4	14.10	0.49	573	104.43	4534.5	3.94	171.02
Totali i shtreses:		43.4	14.10	0.49	573	104.43	4534.5	3.94	171.02

Ashtu si dhe tipi tjetër i grumbullit, klasat e moshës së këtij është ajo e IV (61-80 vjec). Totali i sipërfaqes që zë në formën e përdorimit "pyje", është 43.4 ha ose afërsisht 3 % të totalit të sipërfaqes pyjore. Ka një volum të përgjithshëm prej 4534.5 m^3, me një volum mesatar prej 104.4 m^3/ha dhe Me rritje vijuese natyrale vjetore prej afro 3.94 m^3/ha/vit.

Për të intensifikuar rritjen e grumbullit dhe për ta mbrojtura atë nga rreziku i zjarrit, janë propozuar rrallime tip I e tip II, prerje rigjenruese pa prekur llojin halore pishe e zezë me intentistet ndërhyrje mesatar deri në të fortë..

Pyje pishë të zezë me ah Ky tip grumbulli zotëron një sipërfaqe prej 88.4 ha në EP Sopot. Forma e qeverimit Trungishte, Klasat e moshës në formën e qeverimit janë klasa e IV dhe të VIII Grumbulli nuk arrin të përfitojë potencialin e satacionit dhe si rrjedhim në objektivat e këtij plani mbarështimi nuk janë parashikuar ndërhyrje por janë lënë funksion mbrojtës Lloji dominant në këtë tip është pisha e zezë.

Në këtë formë qeverimi Trungishte garantohet një volum prej 13917.9 m^3/a, me një volum mesatar 157.37 m^3/ha, dhe rritje vijuese 0.99 m^3/ha.

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Trungishte)

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi		rritja vij	
						m3/ha	Totm3	m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									

Trung	Pyje pishe te zeze me ah						
	61-80vjec	25.1	8.29	0.29	235	62.51	1568.
	141-160vjec	63.3	21.23	0.50	219	194.86	12349.
Totali i shtreses:		88.4	17.56	0.44	295	157.37	13917.

Ky tip grumbulli në këtë formë qeverimi është në klasën e V të prodhimit. Grumbulli mbyll masivin me një kurorëdendësi mesatare prej 0.8.

Pyje me shparth. Ky tip grumbulli zë një sipërfaqe prej 34.1 ha ose 2.4 % të totalit të sipërfaqes me formë përdorimi pyll. Është i gjithi në formën e qeverimit "cungishte e përbërë pra kemi formën e qeverisjes cungo+tungishte ku 27 % e sipërfaqes zë lloji pishë e zeze ose 9.6 ha të sipërfaqes së ngastrës, klasa e moshes e III dhe klasë prodhimi e IV pastaj kemi lloje të nënpyllit si frashëri i zi, Mëlleza, Panja e malit".

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Cungishte)

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									
Cungishte thj.	Pyje me shpardh								
	31-40vjec	34.1	8.48	0.41	415	38.87	1323.6	2.59	88.20
Totali i shtreses:		34.1	8.48	0.41	415	38.87	1323.6	2.59	88.20
Totali i ekonomise :		34.1	8.48	0.41	415	38.87	1323.6	2.59	88.20

Tipi i pyjeve "Pyje me shparth", është në klasën e IV te moshës 31-40 vjec dhe ka një volum total prej 1323.6 m^3, dhe mesatarisht ofron 38.87 m^3/ha, me një rritje vjetore prej 2.59 m^3/ha. Mbyll masivin me një kurorëdendësi prej 0.6-0.8. Në objektivat e këtij plani mbarshtimi është propozuar të ndërhyet me prerje rigjeneruese, duke u kujdesur për llojin halor pishë e zezë.

VII.1.2 Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes

Në EP Sopot, ndodhen të tre format e qeverimit:

a. Trungishte
b. Cungishte

Në vijim në këtë pikë do të trajtojmë pikërisht se si shpërndahet dhe se çfarë korelacioni eksiston midis formës së qeverimit, sipërfaqes dhe volumit.

Trungishtet Pordhuese: Trungishtet në EP Sopot zënë 1279.1 ha, të totalit të sipër faqes me pyje. Llojet që përbëjnë këtë shtrese janë Pisha e zezë, Bredhi i Bardhë, Ahu, në pjesmarrje në % shume të vogël lloje shoqëruese kemi Bunga, mëlleza. Tabela më poshtë jep shpërndarjen e

volumit sipas llojeve dhe sipërfaqes. Në total, në këtë formë qeverimi kemi 107609.6 m^3, me një volum mesatar prej 84.12 m^3/ha.

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klasave te moshes (Trungisht prodhuese)

Lloji	Kl moshes	Sip ha		Volumi
		%ndr	%vol	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot				
	21-40vjec			
AH		0.0	276.5	10659.1
BRB		0.0	8.7	329.2
	41-60vjec			
AH		0.0	219.8	13244.8
BRB		0.0	4.1	327.4
	61-80vjec			
AH		0.0	408.7	37619.4
BRB		0.0	75.0	6925.6
BUN		0.0	1.2	77.7
MI		0.0	0.7	45.4
PIZ		0.0	32.4	2526.4
	161-180vjec			
AH		0.0	236.2	34989.8
BRB		0.0	1.8	547.1
PIZ		0.0	1.0	317.7
Totali i ekonomise :			**1279.1**	**107609.6**

Trungishtet mbrojtëse: Trungishtet me funksion mbrojtës në EP Sopot zënë 126.7 ha, të totalit të sipër faqes me pyje. Llojet që përbëjnë këtë shtrese janë Pisha e zezë, Bredhi i Bardhë, Ahu, në pjesmarrje në % shume të vogël lloje shoqëruese kemi Bunga, mëlleza Robulli. Tabela më poshtë jep shpërndarjen e volumit sipas llojeve dhe sipërfaqes. Në total, në këtë formë qeverimi kemi 24958.0 m^3, me një volum mesatar prej 196.98 m^3/ha. Fuknsioni i propozuar në këtë plan menaxhimi është për faktin nisur nga konfiguracioni i terrenit pjerrësia e larte kanë për qëllim të mbrohet infrastruktura dhe toka.

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klasave te moshes (Trungisht mbrojtese)

Lloji	Kl moshes	Sip ha %ndr	Sip ha %vol	Volumi Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot				
	81-100vjec			
AH		0.0	50.4	4751.5
	141-160vjec			
AH		0.0	29.1	7828.1
BRB		0.0	8.3	2659.4
BUN		0.0	1.8	381.3
MI		0.0	1.6	278.6
PIZ		0.0	31.9	7017.5
RO		0.0	3.6	2041.6
Totali i ekonomise :			126.7	24958.0

Cugishtet e përbërë: Kjo shtesë në këtë ekonomi pyjore zë një sipërfaqe prej 34.1 ha, dhe ka një volum të përgjthshëm prej 1323.6 m^3 me një mesatare prej 38.87 m^3/ha.

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klasave te moshes (Cungishte prodhuese)

Lloji	Kl moshes	Sip ha %ndr	Sip ha %vol	Volumi Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot				
	31-40vjec			
FRZ		0.0	2.5	96.0
MI		0.0	2.5	95.6
PAM		0.0	1.0	37.0
PIZ		0.0	9.1	352.6
SHP		0.0	19.1	742.4
Totali i ekonomise :			34.1	1323.6

Llojet kryesore të kësaj shtrese janë Shparthi, Pisha e zezë 27 % të sipërfaqes së ngastrës klasa e III e moshës trungishte, shoqëruar me llojet frashër i zi, mëlleze dhe panja e malit. Të dhëna mbi shpërndarjen e volumit sipas llojeve paraqitet ne tabelën më sipër.

Nga si më sipër komentuam, e përmbledhur si tuate shfaqet në tabelen në vijim, duke përfshirë totalin e shtresës së EP Sopot në raport me formën e qeverisjes për Trungishtet Pordhuese dhe mbrojtëse si dhe Cungishten e përbërë.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m^3/ha)	Volumi i përgjitshëm në këmbë (m^3)
Trungishte	1405.8	94.30	132567.6
Cungishte e përbërë	34.1	38.87	1323.6
Gjithsej	**1439.9**		**133891.2**

VII.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit

Për të patur një analizë të hollësishme dhe të detajuar, sërish këtë interpretim do e referojmë sipas formës së qeverimit, duke marrë në konsideratë klasat e moshës dhe klasat e prodhimit, duke parë korelacionin që eksiston midis tyre.

Për pyjet trungishte: Eksiston korelacioni si në tabelën më poshtë, midis klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë për pyjet me formë qeverimi trungishte ne EP Sopot:

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klases se prodhimit (Trungishte prodhuese)

Lloji	Kl.prodh	Sip ha	Volumi
Ekonomia Pyjore : Sopot			
AH		1141.3	96513.1
	1	48.0	1550.3
	2	35.1	1155.1
	3	63.0	3497.4
	4	313.0	21790.9
	5	682.2	68519.4
BRB		89.6	8129.2
	2	2.6	88.4
	3	33.4	2806.2
	4	53.6	5234.6
BUN		1.2	77.7
	3	1.2	77.7
MII		0.7	45.4
	5	0.7	45.4
PIZ		33.4	2844.1
	3	23.4	1535.8
	4	10.1	1308.3
Totali i ekonomise :		**1279.1**	**107609.6**

Ashtu sikundër shikohet, klasat e prodhimit të I,II, III, IV, V janë përfaqësuese të llojeve AH dhe shpërndahet në 1141.3 ha me një volum 96513.1 m^3, Pishë e zezë në klasat e prodhimit të III dhe IV dhe shpërndahet në 33.5 ha, me volum 2844.1 m^3, për bredhin e bardhë në klasën e II, III, IV të prodhimit me volum 8129.2 m^3 dhe sipërfaqe 89.6 ha, si dhe llojin Bungë në klasën e III të prodhimit dhe mëlleze në klasën e V-të të prodhimit me volum 123.1 m^3, kanë sipërfaqe shume të vogël në raport me sipërfaqen e përgjithshme, të cilat së bashku përfaqësojnë një volum të përgjithshëm prej 107609.6 m^3.

Ashtu sikundër shikohet, korelacioni midis klasave të moshës, klasave të prodhimit; sipërfaqes dhe vëllimit ka një menaxhim të resurseve të kësaj ekonomie, duke i siguruar asaj qëndrueshmërinë, vijimësinë dhe ciklin natyror. Nëse interpretohen të dhënat e mësipërme, del se volumi aktual është i përqendruar në një porpocion jo aq të drejtë midis klasave të moshës, dhe prodhimit.

Për pyjet trungishte mbrojtëse: Eksiston korelacioni si në tabelën më poshtë, midis klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë për pyjet me formë qeverimi trungishte me funskoion mbrojtës ne EP Sopot:

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klasave te prodhimit (Trungishte mbrojtese)

Lloji	Kl prodhim	Sip ha		Volumi
		%ndr	%vol	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot				
AH		0.0	79.6	12579.6
	4	0.0	22.2	2534.3
	5	0.0	57.3	10045.3
BRB		0.0	8.3	2659.4
	3	0.0	4.4	955.8
	4	0.0	3.9	1703.6
BUN		0.0	1.8	381.3
	4	0.0	1.8	381.3
MII		0.0	1.6	278.6
	4	0.0	0.9	137.0
	5	0.0	0.7	141.6
PIZ		0.0	31.9	7017.5
	3	0.0	21.6	5475.6
	4	0.0	10.2	1542.0
RO		0.0	3.6	2041.6
	3	0.0	3.6	2041.6
Totali i ekonomise :			**126.7**	**24958.0**

Të gjitha llojet në këtë shtresë përfaqësohen nga klasa III, IV dhe e V e Prodhimit, që korespondojnë përkatësisht për llojin ah, Bredh, Pishe e zezë, Bungë, Robull, Mëllezë Shparth. Ndëra sa i përkët klasës së prodhimit, e gjithë kjo shtresë si kundër shikohet është në klasën e V të prodhimit, I gjthë volumi është i

përqëndruar në këtë klasë prodhimi për ah dhe përfaqëson volum 12579.6 m^3, dhe volum të përgjithshëm për të gjitha llojet një sasi 24958.0 m^3.

Mbështeur në të dhënat e mësipërme grumbujt me këtë funksion kanë një dispoporcion midis klasave të prodhimit në rapot me llojet, por në objektivat e ketij plani menaxhimi qëllimi i ketyre tipeve të grumbujve pyjor është për mbrojtjen e tokës dhe rrjedhjes së ujrave për të realizuar një filtrim sa më të mirë në tokë, profili i ketyre grumbujve me profil të shkallëzuar dhe i përzier dhe me kate bën një mbrotje të tokës nga erozioni por edhe qëndryeshmëria dhe rezistenca në rastet e zjarreve në pyje, më vonë duke vëzhguar situatën e këtyre grumbujve struktura e pyjeve mund të aplikoj me prerje rigjeneruese selektive në keta grumbuj me intensitete të ulta.

Për pyjet Cungishte e Përbëre: Eksiston ky korelacion midis sipërfaqes, volumit dhe klasave të moshës e atyre të prodhimitnë këtë shtresë:

Shperndarja e siperfaqes dhe vellimit sipas klasave te prodhimit (Cungishte prodhuese)

Lloji	Kl prodh.	Sip ha		Volumi
		%ndr	%vol	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot				
FRZ		0.0	2.5	98.0
	4	0.0	2.5	98.0
MII		0.0	2.5	95.6
	5	0.0	2.5	95.6
PAM		0.0	1.0	37.0
	4	0.0	1.0	37.0
PIZ		0.0	9.1	352.6
	4	0.0	9.1	352.6
SHP		0.0	19.1	742.4
	5	0.0	19.1	742.4
Totali i ekonomise :			34.1	1323.6

Të gjitha llojet në këtë shtresë përfaqësohen nga klasa IV dhe e V e moshës, që korespondojnë përkatësisht me 41-50 vjec për llojin Shparth, dhe llojin Pishë e zezë 41 – 60 vjeç. Ndëra sa i përkët klasës së prodhimit, e gjithë kjo shtresë si kundër shikohet është në klasën e IV të prodhimit. I gjthë volumi është i përqëndruar në këtë klasë prodhimi IV për Llojin Pishë e zezë dhe Klasa e V-të për llojin Shparth dhe përfaqëson volum për të dy llojet kryesore një sasi prej

1095 m^3, ndërsa llojet melleze, frashër dhe panja e malit kanë një volum të përgjithshëm për të tre llojet prej 1323.6 m^3.

Nga analiza rezulton që volumi është i përqendruar veëtm në dy klasa moshe, duke bërë që grumbulli të ketë probleme të vijimësisë dhe mbarështimit të tij të qëndrueshëm. Në objektivat 10 vjeçare të këtij plani, janë propozuar masa që do të synojnë të riparojnë këtë shtrirje të volumit në harmoni me klasat e moshës, me synimi për të garantuar vijimësinë dhe mbarështimin e qëndrueshëm të grumbujve pyjorë të kësaj ekonomie.

VII.2 Analizimi i të dhënave për kullotat

VII.2.1 Gjendja e kullotave


Sipërfaqja e përgjithshme e kullotave prej 78.9 ha në EP Sopot është ndarë sipas tipeve dhe shkallës sëmbulesës barishtore. Tabelat dhe grafikët më poshtë evidentojnë gjendjen mesatarisht të varfër të tokave kullosore, pasi më së shumti janë të përziera me shkurre dhe për shkak se 57% e sipërfaqes kullosore ka një mbulim me vegjetacion më pak se 80%.


Tipi i kullotës	Sipërfaqja e tokës kullosore (ha)
Kullotë	45.9
Kullotë me drurë	1.8
Kullotë me shkurre	27.1
Livadh	4.1

Rëndësia e specieve Graminore dhe Leguminoze jepet në grafikët e mëposhtëm. Speciet graminore kryesore janë: *Dactylis glomerata, Poa annua, Avena fatua.* Speciet leguminozë mbizotërohen nga: *Trifolium scabrum, Trifolium repens, Trifolium pratense, Trifolium campestre, Vicia grandiflora, Medicago minima.*Specie të tjera barishtore përgjatë kullotave janë të ndryshme si *Bellis perennis, Plantago sp., Micromeria juliana, etj.*

Shkalla e mbulimit me bimësi barishtore (%)	Sipërfaqja e tokës kullosore (ha)
< 20	2.1
60 deri 70	8.5
70 deri 80	19.7
80 deri 90	36.8
90 deri 99	11.8
100%	73.4


Rëndësia e specieve graminore dhe leguminoze jepen në grafikët e mëposhtëm. Speciet graminore kryesore janë: *Dactylis glomerata, Poa annua, Avena fatua.* Speciet leguminoze dominohen nga: *Trifolium scabrum, Trifolium repens, Trifolium pratense, Trifolium campestre, Vicia grandiflora, Medicago minima*. Specie të tjera barishtore janë të ndryshme si *Bellis perennis, Plantago sp., Micromeria juliana, etj.*





Sikurse përshkruhet në seksionet e mësipërme, erozioni paraqet një kufizim serioz për kullotjen. Një kufizim tjetër është prania e gurëve, siç evidentohet më poshtë.

Shkalla e mbulimit me gurë	Sipërfaqja e tokës kullosore (ha)
E ulët < 30%	50.1
E moderuar 31-60%	22.1
E lartë> 60%	6.7



Lidhur me presionin mbi sipërfaqen kullosore dhe mbulimin e kufizuar me vegjetacion, përparësi është funksioni prodhues.

VII.2.2 Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore

Saktësimet mbi sipërfaqen kullosore në parcela dhe n/parcela, vendndodhjen e tyre, duke iu referuar qytetit/fshatit kryesor dhe përdorimin e tyre (kryesisht të përbashkët) jepen në tabelën vijuese.

Bashkia	Kodi Id	Ekonomia Pyjore	Sip_ha	Kategoria e Përdorimit	Forma e Përdorimit	Emri lokal
Prrenjas	EL60 00 016b	EP Sopot	6.12	Kullotë	Përbashkët	Liqeni i Cakes
Prrenjas	EL60 00 023b	EP Sopot	17.42	Kullotë	Përbashkët	Faqe e gurit të zi
Prrenjas	EL60 00 023c	EP Sopot	5.12	Kullotë	Përbashkët	Faqe e gurit të zi
Prrenjas	EL60 00 026b	EP Sopot	9.74	Kullotë	Përbashkët	Faqe e gurit të pëllumbit
Prrenjas	EL60 00 028b	EP Sopot	4.17	Kullotë	Përbashkët	Gjovazhda
Prrenjas	EL60 00 029b	EP Sopot	5.06	Kullotë	Përbashkët	Faqe e Gaferrit
Prrenjas	EL60 00 030b	EP Sopot	0.54	Kullotë	Përbashkët	Gropa Kuqe
Prrenjas	EL60 00 031b	EP Sopot	0.68	Kullotë	Përbashkët	Pylli thatë
Prrenjas	EL60 00 032b	EP Sopot	1.27	Kullotë	Përbashkët	Faqja malit plak
Prrenjas	EL60 00 033b	EP Sopot	0.51	Kullotë	Përbashkët	Faqja malit plak

Prrenjas	EL60 00 034b	EP Sopot	2.48	Kullotë	Përbashkët	Shkalla Gurit Bardhë
Prrenjas	EL60 00 035b	EP Sopot	1.13	Kullotë	Përbashkët	Faqja Ujit Ftohtë
Prrenjas	EL60 00 037b	EP Sopot	0.96	Kullotë	Përbashkët	Faqe e Zhavorrit
Prrenjas	EL60 00 038b	EP Sopot	1.66	Kullotë	Përbashkët	Stanet Leges
Prrenjas	EL60 00 042b	EP Sopot	0.69	Kullotë	Përbashkët	Pylli i Dashit
Prrenjas	EL60 00 049b	EP Sopot	1.80	Kullotë	Përbashkët	Breg Plep
Prrenjas	EL60 00 051b	EP Sopot	4.76	Kullotë	Përbashkët	Lukovë
Prrenjas	EL60 00 051c	EP Sopot	4.99	Kullotë	Përbashkët	Lukovë
Prrenjas	EL60 00 051d	EP Sopot	3.07	Kullotë	Përbashkët	Lukovë
Prrenjas	EL60 00 057b	EP Sopot	3.17	Kullotë	Përbashkët	Gropa e Gjashtës
Prrenjas	EL60 00 058b	EP Sopot	1.46	Kullotë	Përbashkët	Rrasa
Prrenjas	EL60 00 060b	EP Sopot	2.07	Kullotë	Përbashkët	Qafa e Malit

VII.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike

Ekonomia Pyjore Sopot	Altituda mbi nivelin e detit ne (m)	Pjerrësia në %	Kundrejtimi
EL60 00 016b	1250	0-10 %	Verior
EL60 00 023b	1390	11-40 %	Lindor
EL60 00 023c	1550	41-70 %	Veri-lindor
EL60 00 026b	1395	0-10 %	Veri-lindor
EL60 00 028b	1545	0-10 %	Veri-Perëndmior
EL60 00 029b	1879	41-70%	Veri-lindor
EL60 00 030b	1577	0-10 %	Perëndimor
EL60 00 031b	1540	0-10 %	Lindor
EL60 00 032b	1540	0-10 %	Veri-lindor
EL60 00 033b	1575	0-10 %	Jugor
EL60 00 034b	1565	0-10 %	Jugor
EL60 00 035b	1590	11-40 %	Jugor
EL60 00 037b	1610	0-10 %	Veri-lindor
EL60 00 038b	1615	0-10 %	Jugor
EL60 00 042b	1690	11-40 %	Jugor
EL60 00 049b	1405	0-10 %	Jug-Lindor
EL60 00 051b	1755	11-40 %	Jug-Perëndimor
EL60 00 051c	1687	0-10 %	Jug
EL60 00 051d	1560	11-40 %	Jug
EL60 00 057b	1495	11-40 %	Jug-Perëndimor
EL60 00 058b	1450	41-70%	Perëndim
EL60 00 060b	1485	0-10 %	Jug-Perëndimor

Në objektivat e planit të mbarshtimit janë parashikuar ndërhyje duke përmisruar kullotat, ngastra 31b e cila ka lere ekzistuese por e demtuar ndër vite është parashikuar merimetimi i saj dhe pastrim dhe heqje barërash në disa ngastra.

VII.2.4 Mbëritshmëria

Sipërfaqet kullosore ndodhen kryesisht në pjesën qendrore të EP Sopot në altitudat më të mëdha. Duhet të risillet edhe njëherë ndërmend që rrjeti rrugor është në gjendje të degraduar. Megjithatë, kullotat janë lehtësisht të mbërritshme, të paktën nëpër shtigjet këmbësore dhe për ato që ndodhen në afërsi mund të mbërrihen me automjete.

VII.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota

Duke iu referuar të dhënave të siguruara nga Bashkia dhe si rezultat i anketimit në fshatra, duket që djegia e kullotave nuk është një praktikë që zbatohet në EP Sopot. Nuk janë raportuar shenja të djegies nga zjarri të sipërfaqeve të mëdha gjatë inventarizimit në terren.

VIII. Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave

VIII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje

VIII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve

Inventarizimi i EP Sopot u krye përgjatë muajve Nëntor-Prill 2024. Ai u bazua në matjet e sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme te vendosura sipas nje rrjeti te baraslarguar sistematik për shkak se ka avantazhe jo vetëm në aspektin e saktësisë, por gjithashtu në vlerësimin e ndryshimit të të dhënave në pyje nëpërmjet krahasimit midis inventarizimeve të njëpasnjëshëm.

Pas ndërtimit të hartës përkatëse, përcaktimit të kordinatave dhe bartjes së tyre në GPS, u kryen vizita në 344 sipërfaqe provë nga 420 sipërfaqe provë që ka në total gjithë ekonomia. 7 sipërfaqe provë nuk janë vizituar për shkak të terrenit dhe kushteve të tij shumë të vështira, duke i konsideruar ato "Të pambërritshme", nga ku vrojtimet janë kryer nga distanca duke kryer njëkohësisht edhe vlerësimet përkatëse.

Përdorimi i tokës	Nr. i sipërfaqeve provë
Pyll	386
Kullotë	18
Sipërfaqe jo pyjore	9
E pambërritshme	7
Gjithsej	**420**

Inventarizimi i pyjeve u krye në ndërthurje me ortofotot me rezolucion të lartë si një mjet për ndërtimin e rrjetit dhe shpërndarjes së sipërfaqeve provë. Përveç kësaj, vendndodhjet e sipërfaqeve provë u përcaktuan gjithashtu edhe në hartat topografike, të cilat së bashku me ortofotot u përdorën nga ekipet e terrenit për tëkompletuar inventarizimin.

Tipet e hartave të cilat u përdoren në terren nga grupet e inventarizimit listohen më poshtë në figurat nr. 8 dhe 9.




Figura nr. 8. Hartë topografike e përdorur në terren.




Fig. 9. Harta e sipërfaqeve provë e përdorur në terren

Metodologjia e përdorur për ngritjen e rrjetit të sipërfaqeve provë ishte e njëjtë me atë të specifikuar në Udhëzuesin e PMPK të vitit 2019. Matjet u kryen në tre rrathë bashkëqendrorë në sipërfaqet provë, me sipërfaqe 25 m^2, 200 m^2 dhe 400 m^2, në mënyrë që të përfshiheshin të gjitha kategoritë diametrike të drurëve (1.3 m nga toka) në grumbujt pyjorë. Në sipërfaqen provë 25 m^2 u mblodhën të dhëna për ripërtëritjen natyrore dhe u matën drurët, diametri bazimetrik i të cilëve përfshihet në kategorinë nga 2 cm deri 7.5 cm. Sipërfaqet provë me këtë madhësi, u përdorën gjithashtu edhe për inventarizimin e kullotave dhe në vlerësimin e prodhimeve pyjore jodrusore. Në sipërfaqen e dytë provë (200 m^2) u matën drurët me diametër bazimetrik nga 7.51 cm deri 27.5 cm dhe në sipërfaqen e tretë provë (400 m^2) u matën vetëm drurët me diametër më të madh se 27.5 cm. Për të vlerësuar saktësinë e inventarizimit të pyjeve bazuar në volumin e përllogaritur për secilën sipërfaqe provë, ne vlerësuam parametrat e mëposhtëm:

- Shmangia standard e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_x = \pm\sqrt{S_x^2} \qquad S_x^2 = \frac{\sum_{i=1}^{n} x_i^2 - \frac{(\sum_{i=1}^{n} x_i)^2}{n}}{n-1}$$

- Koefiçienti i variacionit të volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_{x\%} = \frac{S_x}{\bar{x}} \cdot 100$$

- Gabimi standard në metër kub dhe përqindje;

$$S_{\bar{x}} = \frac{S_x}{\sqrt{n}}$$

Bazuar në këto ekuacione ne vlerësuam saktësinë e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë dhe gjetëm që gabimi standard në llogaritjen e volumit ishte 3.1 %. Ky gabim është jodomethënës, që do të thotë se të dhënat e volumit tësiguruara nga inventarizimi në terren janëbrenda kufirit të gabimit (± 20 %).

Saktësia e lartëqë rezulton nga rezultatet e llogaritura, lidhet me volumin e përqendruar vetëm në formën e qeverimit "Trungishte dhe Cungishte".

VIII.1.2 Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë

Nga inventarizimi i sipërfaqeve provë në terren, pasi të dhënat u bartën në programin e përpunimit të të dhënave MS Access DB, të miratuar nga Këshilli Shkencor i ish Instituti i Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave në vitin 2000, rezultoi se EP Sopot ka një volum të përgjithshëm në këmbë prej 133891.2 m^3. Ashtu si më sipër kemi theksuar, volumi i përket vetëm formave të qeverimit Trungishte dhe Cungishte.
Të dhënat për shpërndarjen e volumit jepen në tabelën më poshtë.

F. qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volmesatar (m3/ha)	Vol. Total nëkëmbë(m3)	Rritjames. vjetore (m3/ha/vit)	Rritjamesvjet tot shtrese(m3/ha /vit)
Trungishte	1405.8	93.30	132567.6	2.75	3868.49
Cungishte	34.1	38.87	1323.6	2.59	88.20
Gjithsej	**1439.9**	**0**	**133891.2**		

Të dhënat që vijnë nga përpunimi i të dhënave në programin MS Access DB për format e qeverimit të gjendura në EP Sopot jepen si në vijim:

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Trungishte)

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									
Trung	**Pyje bredhi te bardhe me ah**								
	61-80vjec	31.7	8.36	0.23	339	73.44	2330.2	1.96	62.05
Totali i shtreses:		31.7	8.36	0.23	339	73.44	2330.2	1.96	62.05
Trung	**Pyje me ah**								
	21-40vjec	285.2	7.88	0.64	629	38.52	10988.3	3.23	922.18
	41-60vjec	206.9	8.96	0.47	583	58.35	12069.7	3.67	759.75
	61-80vjec	273.2	12.46	0.49	772	88.93	24293.2	3.69	1009.27
	81-100vjec	50.4	12.66	0.34	374	94.20	4751.5	2.40	120.94
	161-180vjec	226.2	18.02	0.31	305	141.27	31954.0	0.00	0.74
Totali i shtreses:		1054.8	11.58	0.48	564	79.69	84056.7	2.67	2812.88
Trung	**Pyje ahu me bredh te bardhe**								
	41-60vjec	17.1	12.83	0.55	812	88.12	1502.4	4.87	83.02
	61-80vjec	144.6	14.49	0.58	787	100.03	14467.8	4.34	627.34
	141-160vjec	12.9	58.25	1.18	750	609.59	7857.6	1.58	20.38
	161-180vjec	12.8	29.95	0.55	362	304.02	3900.6	0.35	4.55
Totali i shtreses:		187.4	18.41	0.62	742	147.96	27728.4	3.92	735.29
Trung	**Pyje ahu me pishe te zeze**								
	61-80vjec	43.4	14.10	0.49	573	104.43	4534.5	3.94	171.02
Totali i shtreses:		43.4	14.10	0.49	573	104.43	4534.5	3.94	171.02
Trung	**Pyje pishe te zeze me ah**								
	61-80vjec	25.1	8.29	0.29	235	62.51	1568.9	2.22	55.71

	Kl moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vij m3/ha	Totm3
	141-160vjec	63.3	21.23	0.50	319	194.98	12349.0	0.50	31.54
Totali i shtreses:		88.4	17.56	0.44	295	157.37	13917.9	0.99	87.25
Totali i ekonomise:		1405.8	12.87	0.49	566	94.30	132567.6	2.75	3868.49

Grumbujt e tipit "Pyje me ah me bredh të bardhë", ne klasen e moshës III dhe të IV , rezultojnë me rritjen më të madhë vjetore, me rreth 4.87 m^3/ha/vit, të ndjekura pyje me në klasën e moshës IV (61-80 vjeç) me 3.92 m^3/ha/vit, e kështu me radhe si në tabelën e mësipërme.

Ndërsa pyjet me formë qeverimi Cungishte, mbajnë një volum të përgjithshëm në këmbë prej 1323.6 m^3, me një mesatare të përgjithshme prej 38.8 m^3/ha, dhe me një rritje mesatare vjetore prej 2.59 m^3/ha/vit.

Analiza tipit te grumbullit nga llogaritjet per n/ngastrat (Cungishte)

	Ki moshes	Sip ha	m2/ha	Td	Nr dr/ha	Volumi m3/ha	Totm3	rritja vji m3/ha	Totm3
Ekonomia Pyjore : Sopot									
Cungishte thj.	Pyje me shpardh								
	31-40vjec	34.1	8.48	0.41	415	38.87	1323.6	2.59	88.20
Totali i shtreses:		34.1	8.48	0.41	415	38.87	1323.6	2.59	88.20
Totali i ekonomise :		34.1	8.48	0.41	415	38.87	1323.6	2.59	88.20

Këto të dhëna të rritjes vjetore për shtresën e pyjeve në formën e qeverimit "trungishte", tregojnë se planifikimi i ndërhyrjeve në këto grumbuj është i drejtë dhe se do të çojë në intensifikimin e rritjes së grumbullit.

VIII.1.3 Struktura vertikale

Bazuar në të dhënat e regjistruara nga ekipet e terrenit ne vlerësuam shpërndarjen e strukturës vertikale sipas parcelave pyjore (shih tabelën e mëposhtme). Vërejtëm që në 97.7 % të sipërfaqes pyjore janë 1 kat dhe 1550.9 ha dhe grumbujt pyjorë me strukturë vertikale me 2 kat në 2.3 % të sipërfaqes.

Struktura vertikale	Siperfaqja(ha)	%
Njëkatëshe	**1405.8**	**97.6**
Dykatëshe	**34.1**	**2.4**
Shumëkatëshe	**0**	**0**
Gjithsej	**1439.9**	**100**

Kjo tregon presionin e ushtruar mbi grumbujt e kësaj ekonomie pyjore si në aspektin e kullotjes apo edhe te ndërhyrjeve të tjera me natyrë humane, duke mos i dhënë shkak asnjë lloji, pavarësisht përshtatshmërisë, të mos shkëputet e për të krijuar kat, sipërfaqja prej 34.1 ha e cila ka diferencë në klasa moshe dhe lartësie si pisha e zezë dhe shparth pra kemi një diferencim në strukturën vertikale duke krijuar profil me kate.
Të dhëna të hollësishme për katet për të gjitha formate qeverimit jepet ne tabelen në vijim.

Struktura vertikale e grumbullit

	Struktura	Ha	%
Ekonomia Pyjore : Sopot			
Cungishte thj. **Prodhues**			
Pyje me shpardh		**34.05**	**100**
	Dy kate	34.05	100
	Totali i shtreses :	**34.05**	
Trung **Prodhues**			
Pyje bredhi te bardhe me ah		**31.73**	**2**
	Nje kat	31.73	100
Pyje me ah		**1004.37**	**79**
	Nje kat	1004.37	100
Pyje ahu me bredh te bardhe		**174.52**	**14**
	Nje kat	174.52	100
Pyje ahu me pishe te zeze		**43.42**	**3**
	Nje kat	43.42	100
Pyje pishe te zeze me ah		**25.1**	**2**
	Nje kat	25.1	100
	Totali i shtreses :	**1279.14**	
Trung **Mbrojtes**			
Pyje me ah		**50.44**	**40**
	Nje kat	50.44	100
Pyje ahu me bredh te bardhe		**12.89**	**10**
	Nje kat	12.89	100
Pyje pishe te zeze me ah		**63.34**	**50**
	Nje kat	63.34	100
Struktura	**Ha** **%**		
	Totali i shtreses :	**126.67**	
	TOTALI I EKONOMISE :	**1439.86**	

VIII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë

Mbështetur në kategorizimin e manualit për vlerësimin e cilësisë së lëndës në këmbë sipas tabelës së mëposhtme, EP Sopot rezulton me një cilësi lendë të ulët.
Kjo tregon që edhe vlerësimi i ekspertëve në terren ka qenë i drejtë në lidhje me këtë tregues.

Klasa e cilesise	Kriteret e percaktimit
3	**Lenda e punimit ze me pak se 60% te volumit per haloret dhe 30% per fletoret.** *(dru zjarri (trung me cilesi te dobet dhe nuk perdoret per qellim industrial) (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte:*

	halore < 10%; fletore < 10%). Ne kete rast lenda e punimit ze 15% te volumit kurse drute e zjarrit 85% te volumit).
2	**Lenda e punimit ze 61 - 80 % te volumit per haloret dhe 30 - 50 % per fletoret.** *(trungu ka nje gjatesi nga 2 deri ne 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore >10- 60% (83% lende punimi+17% dru zjarri); fletore > 10-50% (64% lende punimi + 36% dru zjarri).*
1	**Lenda e punimit ze > 80 % te volumit per haloret dhe > 50 % per fletoret.** *(Eshte i cilesise se mire dhe ka nje gjatesi minimale prej 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore > 60% (98% lende punimi + 2 % dru zjarri; fletore > 50% (83% lende punimi + 17% dru zjarri).*

Bazuar në raportin e volumit të lëndëssë punimit ndaj volumit të përgjithshëm, duke iu referuar tabelës së mësipërme ne bëmë vlerësimin e përqindjes së secilit asortimenteve për secilin ngaster dhe me pas llogaritem volumin e asortimenteve sipas fletoreve dhe halorëve.

Theksohet se kategorizimi në lëndë punimi dhe dru zjarri diferencohet vetëm në pyjet me formë qeverimi "Trungishte", ndërsa ajo "Cungishte" është 100 % në kategorinë dru zjarri.

	Fletore		Halore	
Asortimentet	**Volumi(m3)**	**%**	**Volumi(m3)**	**%**
L.trashe	20759	20	3867	19
L.mesme	25105	23	6933	35
L.Holle	51099	42	7402	38
Dr.Zjarri	17043	15	1683	8
Totali	**114006**	**100**	**19885**	**100**

Vlerësimi për fletorët është kryer vetëm për llojin ah i cili ndodhet në formën e qeverimit trungishte. Ndërsa halorët që ndodhen në EP Sopot, të cilët përfaqësohen nga pisha e zezë, bredhi i bardhë, Robulli, të cilat nuk shquhen për cilësi të lëndës drusore.

Si rezultat në rang ekonomie mesatarisht rezultojnë që lënda e punimit të jetë mesatarisht në raport me drutë e zjarrit, duke e konsideruar që cilësia e lëndës drusore në këmbë të mos jetë e mirë, dhe duke e kategorizuar në klasën e II, sipas kritereve teknike te përcaktuara në manual.

VIII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF)

Pyjet në EP Sopot luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit. Për llogaritjen e biomasës mbitokësore ne përdorëm të dhënat e volumit të siguruara nga përpunimi i të dhënave dhe për t'i konvertuar në peshë të thatë përdorëm të dhënat e dendësisë nga Udhëzuesi i Panelit për Ndryshimet Klimatike (Panel for Climate Change) për speciet kryesore për secilin regjim qeverisje:

- Pishen e zezë, Bredhin e bardhe, ahun për pyjet trungishte
- Shparthin, melleza, për pyjet cungishte

Përmbajtja e karbonit në peshën e thatë të biomasës u konsiderua 0.5. Konvertimi nga C në CO_2 u bë duke u bazuar në peshën molekulare ($CO_2/C = 44/12 = 3.667$).
Për llogaritjen e biomasës mbitokësore përdorëm ekuacionin e mëposhtëm:

$B_{mbt} = Vt_{total} \times D_d \times C_{ratio} \times BEF$

ku:

V_{total} – volumi i përgjithshëm për secilin regjim qeverisje

D_d – dendësia e peshës së thatë

C_{ratio} – përmbajtja e karbonit në biomasën e thatë (0.5)

BEF_Faktori i ekspansionit të biomasës

Qeverisja	Sip. (ha)	Vol. (m^3)	Dendësia (Kg/m^3)	Peshe e thatë (ton)	BEF	Biomasëmbitokësore (ton)	Peshë e C (ton)	Pesha e CO_2 (në ton)
Trungishte	1405.8	132567.6	800	53027	1.4	74237	37118	136111
Cungishte	34.1	1323.6	720	476	1.3	619	309	1133
Gjithsej	**1439.9**	**134932.7**		**53503**		**74856**	**37427**	**137244**

Duke qenë se për formën e qeverimit shkurre nuk ka volum të llogaritshëm, pavarësisht se ato ndokojnë në sekuestrimin e karbonit, ne nuk i kemi marrë në konsideratë.

Sikurse shikohet nga tabela në total ekonomie përthithet një sasi e CO_2, në ekuivalencë me 137244 ton.

VIII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit

Ekonomia pyjore Sopot, kontribuon në sekuestrimin e karbonit ne sipërfaqen pyjore prej 1439.9 Ha. Në total ekonomie, nga llogaritjet e mësipërme mbështetur në Udhëzuesin e Panelit për Ndryshimet Klimatike (Panel for Climate Change), rezulton se EP Sopot përthith një sasi diokid karboni në ekuivalencë me **137 244 ton.**

Kjo sasi është e madhe, sasia e përthithur është relativisht e kënaqshme, duke mbajtur këtu parasysh edhe gjendjen të mirë që paraqesin formacionet pyjore të saj, kushtet e stacionit bonitetin.

VIII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë. Ne grumbujt pyjore te kesaj ekonomie **nuk ka shenja të ndikimeve masive të patogjenëve, të cilët zvogëlojnë rritjen apo çojnë deri në zhdukjen në nivel të grumbujve pyjorë.**

Gjithashtu theksohet që **nuk ka raste të vëzhgimeve të tharjes së drurëve për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përsëritjes së thatësirave, megjithëse grumbujt pyjorë do të ekspozohen veçanërisht në të ardhmen**, duke marrë në konsideratë kushtet specifike të EP Sopot, të karakterizuara nga njendryshueshmeri e altitudës, kundrejtimit dhe klimës. Prandaj mund të thuhet që dëmet kryesore janë shkaktuar nga burime të tjera: mbikullotja dhe veprimet me natyrë humane.

VIII.2.1 Drurët e tharë

Nuk janë konstatuar drurë të tharë dhe as probleme me tharje drurësh në EP Sopot.

VIII.2.2 Dëmtime të tjera

Gjatë inventarizimit në terren të vetmet dëmtime që janë vërejtur janë ato të rëniës së gurëve nga shpatet e ekonomisë të nxitur kryesisht nga punimet në infrastrukturën rrugore që kalojnë nëpër ekonomi. Të tjera dëmtime nuk ka.

VIII.3 Prerjet e paligjshme

Prerjet e paligjshme jane prezente ne disa ngastra. **Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje per te plotesuar nevojat e saj per dru zjarri ose per gardhe, hunj etj presin nje pjese te materialit drusor ne keto ngastrat pyjore. Në këtë mënyrë ata synojnë të presin drurët me dimensionet më të mëdha.

Në këto rrethana, ndërhyrjet e bashkërenduara më mirë ndërmjet stafit te shërbimit pyjor bashkiak dhe banorëve janë një faktor kyç për të zvogëluar shkatërrimin e shkaktuar nga këto prerje informale. Si përparësi, fshatarët duhet të instruktohen të rrallojnë pyllin në formën e një ndërhyrje silvikulturore të përshtatshme, duke hequr drurët e thatë, të nënshtruarit dhe të shtrembërit. Presioni mbi burimet pyjore duhet, gjithashtu, të përqëndrohet në përdorimin e materialit drusor që rezulton nga prerjet silvikulturore.

Prandaj është thelbësore që zbatimi i këtij plani mbarështrimi të pasohet nga një bashkërendim më i mirë ndërmjet aktorëve në bashki dhe nga një strategji specifike e zhvilluar për kontrollin e aktiviteteve të prerjeve në pyjeve.

VIII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave

VIII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Kullotat zënë një sipërfaqe prej 78.9 ha në EP Sopot. Ato shtrihen në vazhdimësi të sipërfaqeve pyjore dhe kanë të njëjtat kushte gjeomorfologjike si pyjet. Të gjitha kullotat janë verore, për shkak të lartësisë së madhe mbi nivelin e detit. Terreni i këtyre sipërfaqeve ka një pjerrësi nga e ulet, mesatare deri të madhe.

Në drejtim të prodhimtarisë, kullotat janërelativisht të pasura, për shkak të pranisë së ulët të gurëve dhe një përbërje të mirë të specieve graminore dhe leguminoze.

Mungesa e rregullimit dhe racionalizimit në lidhje me blegtorinë çon në dëmtime serioze: mbikullotje; kullotje të pakontrolluar në tokat pyjore ku konsumohet gjethi dhe pengohet ripërtëritja. Uji për bagëtitë është një problem domethënës për territorin e EP Sopot, pasi ka një rrjet hidrografik relativisht jo të dendur përroskash dhe përrenjsh. Megjithatë, infrastruktura dhe pajisjet për furnizimin me ujë janë të rralla dhe në gjendje relativisht të degraduar mirëmbajtjeje.

VIII.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit

Pavarësisht ndryshimeve midis kullotave verore dhe dimërore, **kullotat përdoren kryesisht gjatë periudhës së verës dhe vjeshtës, duke qenë se altituda e tyre zakonisht është mbi 1000 m.**

Pothuajse të gjithë përdoruesit janë banorë të fshatrave në afërsi të tokave kullosore në referencë të të drejtave të tyre të njohura zyrtarisht. Përdorimi i kullotave bëhet kryesisht në mënyrë të përbashkët, nga grup familjesh që ndodhen në afërsi të sipërfaqeve kullosore.

VIII.4.3 Numri aktual i blegtorisë

Zonat rurale për-rreth ekonomisë pyjore Sopot, mbarështojnë të imta kryesisht të dhirta, kjo në përputhje edhe me tipologjinë e terrenit që karakterizon këtë zonë. Në të shkuarën, para 8-10 vitesh numri i të imtave arrinte deri në 5600 krerë në të gjithë konturin e ekonomisë, por aktualisht janë vetëm 460 krerë të imta, të cilat edhe këto janë të vendosura jshtë konturit të ekonomisë.

Krahasuar me 10 vite me parë mund të themi që presioni i kullotjes në këtë ekonomi ka rënë ndjeshëm dhe kjo përbën një arsye të fortë për të planifikuar masa të cilat synojnë rivitalizimin e kësaj ekonomie.

VIII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve

Parimi i përdorur për ndarjen e kullotave midis përdoruesve është "çdo fshat brenda kufijve të tij", duke qenë se përdorimi dhe ndarja e tokave kullosore në EP Sopot bëhet nga fshatrat në afërsi të kësaj ekonomie, pjesë e Njësisë administrative stravaj. Së fundmi, periudha e saktë e vitit dhe mënyra e përdorimit të kullotave përcaktohen përmes vendimeve të marra nga komisionet e secilit fshat.

Duke qenë se cilësia e sipërfaqeve kullosore është mesatarisht e mirë, nga studimet e mëparshme supozohet që **kapaciteti mbajtës mesatar për 1 ha llogaritet të jetë 0.5 gjedhë, 3 dhi dhe 5 dele që mund të kullotin pa i shkaktuar dëme serioze pyllit apo ekosistemit.**

VIII.4.5 Infrastruktura aktuale

Infrastruktura kullosore është e pakët. Prania e koritave prej druri apo çezmave të ndërtuara afër burimeve që shërbejnë si rezerva ditore për pirjen normale, përveç përrenjve sezonalë, nuk duhen neglizhuar. Infrastruktura tjetër si zyrat, rrjeti rrugor, gardhimet, sinjalistika, shenjat treguese të ndryshme për informim gjatë sezonit të kullotjes mungojnë pothuajse plotësisht. Ekzistojnë disa leraku bagëtitë mund të pinë ujë, si edhe përrenjtë sezonalë, të parashikohen lerat jashtë funksionit duke bërë merimetimin e tyre, për të përmirsuar kullotën.

VIII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë

Si rezultat i seksioneve të mëparshme, edhe pse rezerva ushqimore është më e madhe se sa kapaciteti kullosor, që do të thotë një mbikullotje e përgjithshme domethënëse në pyjet dhe kullotat e EP Sopot. Ky është një shpjegim i qënësishëm i rritjes së presionit blegtoral mbi burimet pyjore dhe mbi ripërtëritjen e tyre, pasi çobenjtë kërkojnë për furnizimme bazë ushqimore shtesë për bagëtitë që e sigurojnë nga gjethi nëpërmjet krasitjes së degëve në mënyrë të pa kontrolluar. Në zonat më të ndjeshme, masa parësore që duhet marrë është ndalimi i kullotjes nëpërmjet një kontrolli më të mirë të bagëtive ose edhe duke i rrethuar me gardhe, në mënyrë që vegjetacioni i degraduar dhe mbulesa pyjore të mund të ripërtërihet brenda 5 viteve.

Në territorin e ekonomisë pyjore ka shenja të mbikullotjes, madje edhe të degradimit të tokës në kullota, gjithashtu dhe në sipërfaqet e pyllëzuara, të cilat së bashku me prerjet dhe tokat e varfëra janë baza e degradimit të pyjeve. Zhveshja e tokës (heqja e mbulesës barishtore dhe pyjore) ka çuar në erodimin e sipërfaqes së saj. Për këto zona rekomandohet ndërtimi i pritave malore me mur guri të thatë në përroska ose në pjesët fundore të sipërfaqeve të eroduara, pasi do te këtë efekt pozitiv në ndalimin e erozionit, ruajtjen e substancave organike dhe përmirësimin e pjellorisë së tokës.

IX. Objektivat e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave

IX.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë

Konkluzionet kryesore të analizuara në seksionin e mëparshëm II.4 duhet të risillen edhe njëherë:

- Mbarështrimi i mëparshëm i pyjeve dhe kullotave, mbi të gjitha që prej vitit 2001, ka rezultuar **në një pakësim serioz të burimeve pyjore. Struktura edhe madhesia e kesaj ekonomie ka ndryshuar shume** prandaj nevojitet nje rivleresim i gjendjes se burimeve pyjore dhe kullosore ekzistuese.
- **Kullotja e pakontrolluar dhe e pabashkërenduar** ka pasur një ndikim negativ në rritjen e pyjeve dhe në disa pjesë, të ripërtëritjes sëtyre.
- **Mungesa e investimeve ne trajtimin silvikulturor** te burimeve pyjore dhe kullosore ka bere qe rritja e tyre te jete e vogel dhe ato te jene te kercenuara nga zjarret.

Si rrjedhim i drejtpërdrejtë, objektivi i përgjithshëm për planifikimin afatgjatë për EP Sopot **përqëndrohet në tre përparësi madhore, të cilat janë parakushte vendimtare për të arritur një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional:**

1. **Rritja e fondit pyjor, në drejtim të sasisë (volumi mesatar për hektar) dhe cilësisë (lënda drusore e prodhuar në pyjet trungishte). Ky PMPK duhet të shënojë një pikë kthese dhe një ndarje të qartë nga tendencat e mbishfrytëzimit të së kaluarës.** Qëllimi i ndjekur është gjithashtu përmirësimi i prodhimtarisë së pyjeve, si edhe i vlerës së përgjithshme të burimeve pyjore (produkteve drusore, sekuestrimit të karbonit, shtimit të biodiversitetit, mbrojtjes së tokës dhe pjellorisë së saj, përmirësimi i shëndetit dhe vitalitetit të ekosistemit).
2. **Konsiderimi i funksionit mbrojtës ndaj tokës si faktor kryesor që duhet të zbatohet para çdo lloj ndërhyrje në pyje.**
3. **Zbatimi i praktikave të kullotjes rracionale në përputhje me nevojën e grumbujve pyjorë për t'u ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme.**

Si një kusht përfundimtar për sukses, arritja e këtyre objektivave kërkon domosdoshmërisht një kontroll dhe një bashkërendim më të mirëmidis stafit të pyjeve të bashkisë dhe palëve të interesuara lokale. Prandaj do të jetë e një rëndësie shumë të madhe t'i kushtohet vëmendja kryesore që, **procesi i zbatimit do të përfshijë të gjitha palët e interesuara, nga komunitetet lokale tek drejtuesit e pyjeve të bashkisë dhe përfaqësuesit e bashkisë, duke ndërvepruar ngushtësisht dhe respektuar rolet e ndërsjella. Kjo qartësisht përfshin një kontroll të rreptë mbi prerjet e paligjshme.**

IX.2 Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave

Sikurse është shtjelluar në seksionet I.2 dhe II.2, ky PMPK u punua duke iu përmbajtur ngushtësisht rregullores dhe kuadrit politik kombëtar për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, ndër të cilët: Reforma administrative dhe Ligji Nr. 115/2014; Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet"; Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

IX.3 Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal

Ky PMPK u hartua në përputhshmëri të plotë me planet rajonale dhe bashkiake dhe qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional. Ky plan mbarështrimi u zhvillua sipas parimit të

transferimit të kompetencave dhe rritjessë ndërgjegjësimit midis aktorëve, pas një sërë takimesh me banore, barinj, perfaqësues te stafit te pyjeve te Bashkise Përrenjas.
Si rrjedhim te dhenat e grumbulluara u integruanper te siguruar nje mbareshtrim te qendrueshem ne perputhje me kerkesat e popullsise lokale dhe pritshmerite e tyre. **Qëllimi i përgjithshëm ishte përcaktimi i masave dhe ndërhyrjeve, duke ekuilibruar burimet pyjore dhe kullosore me pritshmëritë e komunitetit lokal.** Raporti i procesit të pjesëmarrjes ofron më shumë hollësi rreth metodologjisë dhe rezultateve.
Në këtë kuadër, mundësitë dhe sfidat e identifikuara gjatë takimeve me palët e interesuara lokale përmblidhen si më poshtë:

Mundësitë	Sfidat
Agro-turizmi *(orientimi i bizneseve lokale, prodhimi i një harte eko-pyjore, përdorimi i tokave djerrë)*	**Prerje jo të rregullta dhe mbishfrytëzim** *(mbrojtja e pyjeve pa kufizuar nevojat e banorëve; pyjet e mbetur të pazhvilluar – shkurre – pas mbishfrytëzimit të tyre; mbrojtja veçanërisht e pyjeve brigjeve të liqeneve dhe lumenjve)*
Bimët mjekësore *(Kultivimi dhe mbledhja e BM si një mundësi për rritjen e të ardhurave të familjeve rurale)*	**Menaxhimi i kullotave***(kërkohet një planifikim më i mirë dhe ndërtimi i lerave)*
Ripërtëritja e pyjeve të rrugishte dhe llojet halor *(Përmes pastrimeve, rrallimeve, etj.)*	**Zjarret***(rekomandohet marrja e masave parandaluese ndaj zjarreve dhe ngritja e grupeve të shuarjes së zjarrit)*
E drejta e përdorimit bazuar tek tradita*(ligji i ri për pyjet pritet të rregullojë me një VKM të drejtën e përdorimit të pyjeve për banorët me qëndrim të përhershëm në fshat)*	**Njohja dhe sigurimi i të drejtës së përdorimit***(në varësi të fshatrave, pyjet zakonisht përdoren në bazë lagje ose familje)*
Mbrojtja e pyjeve nga komunitetet/ Promovimi i praktikave të mira*(të mbrojtjes së pyjeve nga vet komunitetet lokale)*	**Vëmendja ndaj pyjeve dhe kullotave***(pyjet dhe kullotat nuk janë përparësi për pushtetin vendor)*
	Lëvizjet demografike *(migrimi dhe emigrimi i moshave të reja)* **Gjenerimi i të ardhurave nga pyjet***(pyjet përdoren vetëm për mbijetesë)* **Mbështetja financiare***(investimet në pyje mungojnë prej vitesh)*

Pritshmëritë më specifike të popullsisë lokale jepen ne tabelen e meposhtme. Këto kanë një rëndësi parësore dhe duhet të merren me konsideratë në mënyrë të kujdesshme gjatë periudhës së zbatimit të këtij PMPK, me një qëllim të qartë për përmirësimin e bashkërendimit dhe ndërveprimeve midis të gjitha palëve të interesuara.

IX.4 Objektivat kryesore të PMPK

Qëllimi kryesor i këtij PMPK është të sigurojë një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Sopot, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike, duke promovuar bashkërendimin e ngushtë ndërmjet stafit të pyjeve, popullsisë lokale dhe përfaqësuesve lokalë. Kjo përfundimisht do të lejojë **optimizimin e**

përfitimeve socio-ekonomike të burimeve për palët e interesuara lokale sot dhe në të ardhmen.

Në përputhje të plotë me objektivat e përgjithshme të përmendura në pjesën IX.1, qëllimet kryesore janë:

- Arritja e qëndrueshmërisë dhe shumëfunksionalitetit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e lëndës drusore të prodhuar, të mirëmbahet mbrojtja ndaj erozionit dhe rreziqeve natyrore, të ruhet biodiversiteti, të sigurohen të ardhura dhe burime sipas nevojave lokale, tëmbahet ekosistemi vital dhe në gjendje tëmirë shëndetësore.
- Përmirësimi i rritjes natyrore të grumbujve pyjorë përmes ndërhyrjeve silvikulturore, duke synuar njëkohësisht balancim më të mirë midis klasave të moshës dhe rritje të volumit te materialit drusor dhe sekuestrimit të karbonit.
- Lejimi i ripërtëritjes së pyjeve me praktika të përshtatura me ato të kullotjes.
- Rimëkëmbja e mbulesës së degraduar të vegjetacionit nëpërmjet pyllëzimeve.
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i funksionalitetit të rrjetit rrugor.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i kapaciteteve të banorëve për ndërhyrje të përshtatshme në pyje në përputhje me nevojat e tyre.
- Zbatimi i masave aktuale nëpërmjet veprimeve interaktive dhe të bashkërenduara që lidhen me palët e interesuara lokale dhe zhvillojnëndjenjën e përgjegjshmërisë dhe kontrollit ndaj mbikullotjes dhe prerjeve të paligjshme.

IX.5 Objektivat specifikë për ekonominë pyjore

Objektivi kryesor i hartimit tëkëtij plani mbarështimi, ishte njohja me gjendjen aktuale të grumbujve pyjore dhe te siperfaqeve te tjera ne ekonomine pyjore Sopot, dhe propozimi i masave për të rregulluar apo përmirësuar situatë n e vërejtur.
Njohja e situatës reale të grumbujve pyjorë dhe planifikimi i masave për të siguruar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre konsiderohet si një tjetër detyrë.
Në kuadër të përgatitjes së planit të mbarështrimit, përparësitë e planifikimit u harmonizuan dhe u ndërthurën me ato të prodhimit të lëndës drusore dhe krijimit të rezervave të larmishme të biodiversitetit dhe rimëkëmbjes së sipërfaqeve të degraduara në mënyrë sa më natyrale.
Ky plan do të sigurojë një ekuilibër midis vlerave natyrore – si biodiversiteti – dhe aspekteve ekonomike në mënyrë që të plotësojë nevojat e komuniteteve dhe të përmirësojë jetesën e tyre.
Procesi pjesëmarrës dhe të drejtat gjinore kanë qenë shtyllat kryesore gjatë hartimit të këtij PMPK.

IX.5.1 Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës

Lidhur me përdorimin e tokës ne parashikojmë që në periudhën 10 vjeçare të zbatimit të këtij PMPK, sipërfaqet me bimësi pyjore, tëruhen dhe te permirsohet gjendja e tyre ne menyre qe te kryejne funksionin mbrojtes te tokes. Ne zone nuk ka siperfaqe te djegura apo te demtuara rende prandaj propozojme vetem kryerjen e trajtimeve silvikulturore per permirësimin e gjendjes se grumbujve pyjore ne territorin e kesaj ekonomie pyjore.

Më poshtë paraqiten të dhënat në rang ekonomie për objektivat e planifikuar gjatë periudhës 10 vjeçare në të cilën ky plan do jetë në fuqi.

Funksionet kryesore dhe specifike te propozuar

Funksioni	ha	%
Ekonomia pyjore : Sopot		
Mbrojt+Prodhues	35.11	2.4
Pr.drusore-Dru zjarri	12.89	36.7
Pr.drusore-Lende punimi	12.89	36.7
Mbrojtje-Toka	22.22	63.3
Prodhues	1391.56	93.6
Pr.drusore-Dru zjarri	287.25	20.6
Pr.drusore-Lende punimi	592.13	42.6
Pr.drusore-Lende ndertimi	215.15	15.5
Pr.te dyta-Bar	2.07	0.1
Mbrojtes	94.06	6.3
Mbrojtje-Toka	71.71	76.2
Totali i ekonomise:	1487.37	

Sikurse shikohet nga tabla e rezultateve për ketë qëllim, **fuknksioni prodhues** është ai që do të dominojë grumbujt e kësaj ekonomie pyjore dhe në krahasim me funksionet e tjera dhe në korelacion me sipërfaqen ky funksion do të jetë i aplikueshëm në 1391.56 ha ose në 93.6% të sipërafqes se përgjithshme me pyje. Ky funksion do të bartë ne vetvete nënfuksionet e veçanta të cilat do të synojnë :

a. Prodhime drusore – dru zjarri, të aplikueshme në 287.25 ha ose në 20.6 % të sipërfaqes me funksionin kryesor atë prodhues
b. Prodhime drusore-Lëndë punimi, i aplikueshëm për 592.13 ha ose në 42.6% të sipërfaqes së përgjithshme të shpallur me funksion prodhues.
c. Prodhime drusore – Lëndë ndërtimi është një funksion tjetër specifik i propuzuar për t'u aplikuar në 215.15 ha ose ne 15.5% të totalit të sipërfaqes të shpallur me funksion prodhues.

Pas funksionit prodhues, në vend të dytë për nga sipërfaqaj që ai është propozuar për t'u aplikuar është funksioni **Mbrojtje + Prodhues,** i cili do të aplikohet në 35.11 Ha ose në 2.4% të

sipërfaqes së përgjithshme pyjore në këtë ekonomi. Ky tip funksioni gërsheton prodhmin dhe mbrojtjen në të njëjtën kohë, duke shfrytëzuar racionalisht, por njëkohësisht edhe duke mbrojtur sipërfaqen racionalisht. Funksione të veçanta në këtë tip listohen:

a. Prodhime drusore - dru zjarri, i cili do të jetë funksion i veçantë për funksionin Mbrojtës + Prodhues dhe do të aplikohet në 12.89 ha, ose në 36.7% të sipërfaqes të shpallur me këtë funksion.
b. Prodhme drusore - lëndë punimi, i cili do të jetë i aplikueshëm në 12.89 ha ose 36.7% të sipërfaqes së shpallur me funksionin Mbr+Prodh.
c. Mrojtje e tokës – është propozuar që të kryejë këtë funksion në 22.2 ha ose në 63.3% të siperfaqes së shpallur me funksionin Mbr+Prodh.

